BENJAMIN DISRAELI

NALTËSIMI I ISKANDERIT

Novelë kushtuar Gjergj Kastriotit – SKËNDERBEUT



Përkthyer me një analizë letrare dhe historike nga Mal BERISHA



Busti i Skënderbeut në Londër, vepër e skulptorit Kreshnik Xhiku, vendosur më 28 nëntor 2012

BENJAMIN DISRAELI

NALTËSIMI I ISKANDERIT

Novelë kushtuar Gjergj Kastriotit – SKËNDERBEUT

Përkthyer dhe botuar, bashkë me një analizë letrare dhe historike nga Mal BERISHA





Botuar anglisht në Londër në vitin 1833 dhe shqip në Prishtinë në Maj 2018

ANALIZË E VEPRËS "NALTËSIMI I ISKANDERIT"

nga

MAL BERISHA

Shkrimtari dhe politikani i shquar britanik Benjamin Disraeli botoi në vitin 1833 librin e tij, **"*The Rise of Iskander*,"**[1] një vepër letrare që i kushtohet heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu.

Benjamin Disraeli

Njohja dhe vlerësimi i kësaj vepre letrare me përmbajtje historike nuk do të ishte i plotë pa njohjen e autorit, pasi këtu qëndron edhe rëndësia më e madhe e saj. Benjamin Disraeli, Earli i Beaconsfield-it, (21 Dhjetor 1804 - 19 Prill 1881) ka qenë një shkrimtar i njohur anglez, autor i më shumë se njëzet librave dhe shumë traktateve e letrave politike si dhe një politikan konservator i shquar britanik. Ai shërbeu dy herë si Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe (shkurt – dhjetor 1868 dhe 1874–1880), dhe i vetmi pasardhës i një familjeje hebraike, ndonëse i shndërruar në të krishterë, i ngjitur deri në atë post të lartë, në tërë historinë e atij vendi.[2]

[1] "*The Rise of Iskander*" - Kessinger Publishing, LLC (September 10, 2010)
[2] Jerman, B. R. *The Young Disraeli.* Princeton, New Jersey, Princeton University Press, 1960.

Benjamin Disraeli shkrimtar

Benjaminin Disraeli i hyri jetës publike si një njeri me prirje prej shkrimtari. Ai u ballafaqua me lexuesin e gjuhës angleze si një shkrimtar i kohës së tij me të tëra tiparet që letërsia e kohës së atëhershme shfaqte. A ishte ai një prej shkrimtarëve të mëdhenj të kohës së tij, apo jo? Kjo është një pyetje e cila nuk ka marrë dot një përgjigje të plotë. Kjo për faktin se emri i tij nuk mbetet i madh thjesht dhe vetëm për veprën e tij letrare. Ai shquhet edhe për veprat e tij si eseist, politikan, polemist dhe burrë shteti. Në shumë raste duket sikur vlerësimin për veprën e tij letrare e ka ndihmuar politika, por për shkak të qëndrimeve të tij shumë të forta konservatore edhe mund ta ketë dëmtuar atë. Pra kemi të bëjmë me një dyzim të harmonizuar të figurës së tij.

Përveç veprës "*Naltësimi i Iskanderit*", botuar në vitin 1833, ai ka shkruar edhe shumë të tjera. Ndër to janë *Vivian Grey* (1826-27), *Udhëtimi i Kapitenit Popanilla* (1828), *Duka i Ri*, (1831), *Contarini Fleming* (1832), *Përrallat e Çudirave të Alroyt* (1833), *Një vit në Hartlebury* (1834), *Martesa e tmerrshme* (1834), *Ixion në Qiell* (1834), *Epiku Revolucionar* (1834), *Henrieta Temple* (1837), *Venetia ose e bija e poetit* (1837), *Tragjedia e Kontit Alarkos,* (1839), *Coningsby ose Gjenerata e Re* (1844), *Sybil ose dy kombet* (1845), *Alroi* (1846), *Lothair* (1870), *Tancred*, (1871) *Endymion* (1880), *Falconet*, (1880). Në bibliografinë e tij zenë vend edhe thëniet të cilat janë aq të forta sa shpesh herë janë përdorur në polemikat politike jo vetëm në Parlamentin Britanik por edhe më gjerë.[3]

Disraeli filloi të shkruante që kur e ndjeu se brenda tij vlonte pasioni i një individi me qëllime të larta dhe aftësi të veçanta. Ai i zhvilloi ato aftësi si gjatë kohës së udhëtimeve ekzotike, ashtu edhe më vonë gjatë përfshirjes së tij në jetën politike britanike. Thënja e tij "*kur dua të lexoj një roman më mirë e shkruaj vetë një tjetër"* zbulon natyrën e tij krijuese dhe kërkuese. [4]

Në historinë e botës, Disraeli nuk është i vetmi politikan, i cili e filloi jetën si shkrimtar dhe arriti të bëhej burrështetas i suksesshëm. Ai e përdori famën e tij si shkrimtar në të mirë të emrit të tij si politikan. Politikanë tw shquar, të cilët e kanë filluar jetën publike njësoj si ai janë disa. Ata në fakt e kanë pasuruar nga ana humane jetën politike. Edhe në vetë Britaninë e Disraelit, disa dekada pas vdekjes së tij, vjen një politikan shumë i shquar nga fusha e letrave, i njohur në tërë botën. Ky është Uinston Çurçill,[5] i cili jo vetëm që shquhet si shkrimtar por në vitin 1953 arrin të marrë çmimin Nobel në letërsi. Po ashtu, Bülent Exhevit i Turqisë[6], Xhimi Karter[7] i ShBA – së, Vaslav

[3] Titujt e këtyre librave janë përkthyer thjesht për ilustrim të kësaj parathënje.

[4] "Disraeli", Biografi, e shkruar dhe botuar në vitin 1966 nga Baroni Robert Uilliam Blake, historian i njohur anglez.

[5] Uinston Çurçill , (1874 – 1965) ka shërbyer si Kryeministër i Britanisë së Madhe nga viti 1940 deri në vitin 1945 dhe nga viti 1951 deri në vitin 1955. Karrjera e tij letrare është shumë e gjatë dhe fillon me "Historinë e Forcës Këmbësore të Malakalandit" (1898), deri tek "Duka i Marlborough", botuar midis viteve 1933 dhe 1938. Ai botoi libra historikë në shumë volume ndër to "Kriza Botërore" (1923-1929), "Agimi i Çlirimit" (1945), "Historia e Popujve anglisht – folës" në katër volume, (1956 – 58), etj. Ai është fitues e çmimit Nobel për letërsi në vitin 1953, për mjeshtërinë në përshkrimet historike dhe biografike si dhe oratorinë brilante në mbrotje të vlerave njerëzore.

[6] Në Turqi një politikan dhe burrë shtetas i njohur bëhet katër herë Kryeministër, shkrimtari dhe poeti i njohur Bülent Exhevit i cili ishte jo vetëm një politikan por edhe poet dhe shkrimtar dhe përkthyes i talentuar. Edhe ky fites çmimit Nobël në letërsi, por pak i njohur jashtë vendit të tij. Ai mbahet mend për guximin që ka treguar në pushtimin e Qipros së Veriut në vitin 1974

[7] Xhimi Karter para se të merrej me politikë shkruante poezi. Ai ka shkruar për tema të thjeshta njerëzore si për vendlindjen, ku i këndon fëmijërisë së tij, gjuetisë, peshkimit të troftave, fqinjit të tij me ngjyrë, nënës. Madje disa vjersha i ka shkruar edhe kur shërbente në Shtëpinë e Bardhë.

Havel[8] i Çekosllavakisë, Michael D. Higgins[9] i Irlandës, për të përmendur vetëm disa, vihen në krye të shteteve të tyre pasi kanë bërë emër si shkrimtar.

Benjamin Disraeli pra është një shkrimtar dhe politikan i rrallë i cili përveç karrjerës së tij politike renditet midis njerëzve më të shquar edhe për faktin se nga një njeri i elitës intelektuale kthehet në një drejtues shteti që le pas një trashëgimi e cila i ka vlejtur vendit të tij. Midis veprave që e cilësojnë atë si një njeri elitar është edhe novela "Naltësimi i Iskanderit" me subjekt të marrë nga jeta e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.

Hebre apo i krishterë anglikan?

Benjamin Disraelit u lind në një familje hebraike e cila kishte shkuar nga Italia në Angli. Mbiemri i tij në Itali ishte D'Israeli, por me vendosjen e tyre në Angli, parashtesa *'D'* iu ngjit mbiemrit pa apostrof. Ndonëse ata ishin një familje praktikante e rregullt e judaizmit, ndodhi që babai i tij Isaku të përfshihej në një grindje me drejtuesit e sinagogës së Bevis Marks në Londër. Prandaj në vitin 1817 ai vendosi t'i pagëzonte fëmijët e tij si të krishterë. Ndoshta ky ishte një moment spontan por që, ashtu siç thonë anglezët, 'çdo gjë ndodh për një arësye'. Edhe në këtë rast kjo "ndodhi" pikërisht që t'i ndihmonte djalit aq shumë në karrierën e tij të ardhshme politike. Ndoshta si hebre ai do të kishte arritur në postin e deputetit, Earlit dhe Kryeministrit të Anglisë tepër vonë në mos hiç fare? Historia e Parlamentit britanik[10] na mëson se deri në vitin 1858 hebrejve nuk iu lejohej të konkuronin për t'u zgjedhur në atë tempull të demokracisë. Fakti që ai vetëm dymbëdhjetë vjetët e para të jetës ishte edukuar si hebre, ndërsa pjesën tjetër si ndjekës i kishës anglikane, i dha atij shansin të ngjiste shkallët më të larta të politikës britanike. Në fakt kjo ngjitje e tij është e shpjeguar në një ndër thëniet e tij shumë kuptimplote:

> *"Sekreti i suksesit në jetën e njeriut qendron tek aftësia e tij për të mos e lëshuar rastin kur i vjen tek dora.*[11]

Lidhur me ndikimin e hebraizmit dhe të kishës në jetën e Disraelit, një ndër biografët e tij të shumtë, Adam Kirsch[12] thotë se ai ishte shkrimtar dhe politikan, por për ta njohur mw mirw duhet të mos harrojmë se ai kishte lindur hebre. Në librin e tij "*Hebraizmi në vetë Disraelin*" Kirsch shkruan:

> *"Arësyeja me bindëse se përse Disraeli u bë aq i suksesshëm, qëndron tek të qenurit e tij me origjinë hebraike. Ky fakt duhej të ishte njw pengesw shumw serioze por në realitet ndodhi e kundërta pasi i dha shtysën kryesore për realizimin e ambicjeve të tij."*

---

[8] Vaslav Havel, Presidenti i Çekosllavakisë dhe pastaj vetëm i Çekisë, para se të udhëhiqte vendin e tij ishte shkrimtar, dramaturg dhe poet. Ai u persekutua për shkrimet e tij anti – komuniste por që pas vitesh në burg dhe disidencë ai u "shpërblye" duke u kthyer në simbolin e njeriut demokrat dhe përparimtar.

[9] Një tjetër politikan i cili merr drejtimin e shtetit të tij pasi bën emër si poet dhe shkrimtar është Michael D. Higgins, Presidenti i sotëm i Irlandës i cili përpara se të merrej me politikë ishte poet dhe spiker radiofonik. Ai madje është i përkthyer edhe në gjuhën shqipe nga poeti, gazetari dhe përkthyesi Ndrek Gjini.

[10] History of Jews in England

[11] Nga libri me thenjët e zgjedhura të Benjamin Disraelit

[12] Benjamin Disraeli, shkruar nga Adam Kirsch, faqe 228.

Benjamin Disraeli - Politikan

Disraeli ka luajtur një rol kyç në kthimin e Partisë Konservatore angleze në një parti moderne, duke i dhënë ato përcaktime politike të cilat respektohen edhe sot e kësaj dite.[13] Ai mbahet mend si politikani britanik me influencën më të madhe në çështjet botërore të kohës së tij, për betejat politike më spektakolare me kundërshtarin e tij laburist, Gladstone dhe për konservatorizmin e tij unitarist "*të një-kombit*" ose asaj që njihet me emrin "*Demokracia Tory*".[14] Ai e bëri Partinë Konservatore të identifikohej me lavdinë dhe fuqinë e Perandorisë Britanike.[15] Disraeli ishte kryeministri më i dashur i Mbretëreshës Viktoria dhe për këtë arësye ai mori prej Saj tërë titujt kalorsiakë.[16] Ai ishte edhe një polemist i pamëshirshëm ndaj kundërshtarëve. Për shembull, ai e përcaktoi kundërshtarin e tij më të madh, Gladstone, të cilin e thërrsnin GOM[17] me thënien: "I vetmi gabim i Perëndisë". Në librin me thënie të Disraelit renditen tetëdhjetë e dy, i ndjekur nga polemisti tjetër i madh anglez, Çurçill, vetëm me dyzet të tilla. Disa prej tyre janë:

"Dituria e të mençurit dhe përvoja e të moshuarit përjetësohen në thëniet e tyre"
"Ushqeje mëndjen me ide të mëdha!"
"Heronj bëhen vetëm ata që besojnë në vepra heroike."
"Mos e harro qëllimin që ke nëse dëshiron ta arrish suksesin!"
"Mos u anko, as mos spiego!"
"Zelli është mëma e fatbardhësisë."

Disraeli, pas katër humbjesh në zgjedhje e fitoi mandatin e parë në Parlamentin Britanik në vitin 1837. Më pas ai punoi si Kançelar i Shtetit në qeveritë konservatore të viteve 1852, 1858 – 1859 dhe 1866 – 1868. Megjithëse ai ishte anëtar i Parlamentit Britanik, duhej të vinte viti 1858, kur pengesa ndaj hebrejve për t'u përfshirë në politikë do të hiqej në Britaninë e Madhe, që ai të gëzonte të drejtën për t'u bërë Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar. Kjo ndodhi në vitin 1868 por nuk qëndroi gjatë në atë detyrë. Në moshën shtatëdhjetë vjeçare, në vitin 1874, pas pesë vjetësh në opozitë ai bëhet kryeministër për herë të dytë. Disraeli arriti të merrte kontrollin britanik mbi Kanalin e Suezit dhe përfaqësoi interesat britanike në Kongresin e Berlinit, në vitin 1878. Ky kongres u thirr si reagim ndaj Traktatit të Shën Stefanit i cili qe nënshkruar midis Turqisë dhe Rusisë në përfundim të Luftës Ruso-Turke, në kishën me të njejtin emër në Stamboll. Ky traktat i jepte Rusisë shumë ndikim ndaj vendeve sllave. Disraeli luajti një rol të rëndësishëm në zbehjen e këtij ndikimi rus në Europë. Por qëndrimi i tij nuk shkonte dhe aq në favor të popujve të pushtuar nga Perandoria Osmane. Në qëndrimin e tij pragmatik, nuk ndihmoi as njohja që kishte për Europën Juglindore që nga rinia e

[13] Cesarini, David. *Disraeli: The Novel Politician*. Neë Haven and London: Yale University Press, 2016.
[14] Daglas Hurd, ish Sekretar i Jashtëm i Britanisë së Madhe në qeverinë e Kryeministres Margaret Theaçer, biograf i Disraelit i cili thotë: "Benjamin Disraeli ishte parlamentari më i talentuar britanik dhe një orator që nuk krahasohej me askend tjetër.
[15] Blake, Robert. *Disraeli*. London: Eyre & Spottisëode Publishers, 1967.
[16] Robert Blake, DISRAELI, botuar në vitin 1966, është një prej biografive më të mira të botuara në njëqint vjetët e fundit.
[17] GOM, në anglisht do të thotë Grand Old Man, në shqip Plaku i Madh të cilin Desraeli e quan "Gabimin e Vetëm të Zotit." (GVZ)

tij. Studiuesit thonë se ai ishte shumë i ndikuar edhe nga idetë imperiale pasi ishte edhe nxitësi kryesor i shpalljes së Mbretëreshës Viktoria, Perandore e Indisë, në vitin 1876.

Konteksti letrar dhe historik i "Naltësimit të Iskanderit"

Novela "**Naltësimi i Iskanderit**" është pikësëpari një vepër letrare. Natyra e saj është thellësisht romantike dhe nuk kishte sesi të ishte ndryshe pasi në kohën e botimit, Europa ishte në kulmin e lulëzimit të romantizmit si rrymë letrare. Kjo shfaqej edhe në muzikë, në pikturë dhe në jetën intelektuale, në ndjenjat e njeriut, imagjinatën dhe mjeshtrinë artistike të autorëve. Nëse gjejmë elementë helenë në vepër, mendoj se kjo nuk vjen nga ndonjë prirje e autorit për t'i devijuar të vërtetës por më shumë për arësye se periudha e romantizmit është ajo gjatë së cilës interesi dhe simpatia për kulturën e lashtë greke dhe atë romake u rrit shumë. Kjo ishte edhe një pararendje ndaj neoklasiçizmit e frymëzuar veçanërisht nga arkeologu, helenisti dhe historiani gjerman, Joakim Winkckelmann[18].

Ishte pikërisht Anglia vendi ku lindi një rrymë e veçantë letrare dhe kulturore që njihet si Helenizmi Viktorian (kjo përkon me mbretërimin e Mbretëreshës Viktoria). Në atë kohë studimi, njohja dhe zotërimi i kulturës klasike greke shihej si e vetmja mënyrë për t'u afirmuar në botën intelektuale dhe elitare angleze. Është koha kur fisniku Thomas Bruce, i njohur më mirë me emrin Lordi Elgin, Ambasador i Britanisë së Madhe në Perandorinë Osmane, me lejen e autoriteteve mori thuajse gjysmën e skulpturave që gjëndeshin në rrënojat e ndërtesave antike greke dhe e mbushi me to Muzeumin Britanik.[19] Ai kishte një pasion të jashtëzakonshëm për artin antik grek prandaj e zhvendosi Parthenon-in nga Athina në Londër. Një faktor tjetër që ka ndikuar tek Disraeli në shkrimin e kësaj vepre është edhe fakti që në kulturën viktoriane, helenizmi ose klasiçizmi grek ka të bëjë me mitizimin e një fenomeni apo të një figure historike, apo edhe vetë shndërrimin e tyre nga plani i të vërtetës historike në një plan të përjetësisë universale mitologjike. Këtë e vërteton edhe konstatimi i tij për qytetet e mëdha përfshirë këtu edhe Athinën:

> *"Një qytet i madh, pamjet e të cilit nguliten në kujtesën e njeriut mbart tiparet e ideve madhështore të realizuara: Roma përfaqëson pushtuesin, mbi kullat e Jeruzalemit rrinë pezull fetë, ndërsa Athina mishëron vetitë e larta të artit të botës antike."*

Ky është pra Naltësimi! Naltësimi nga realiteti tek historia dhe që këtej tek miti. Naltësimi që vjen nga helenizimi viktorian i kulturës angleze ku bie në "rrjetë" edhe Heroi ynë Kombëtar, Skënderbeu, i kthyer në një personazh të cilin Disraeli e bën të veprojë në terrenin epirot, shqiptar por në një rast edhe në atë helen.

Po si u njoh Disraeli me veprën e Skënderbeut?

Kur ishte i ri, ai bëri një udhëtim të gjatë në Mesdhe, nga qershori i vitit 1830 deri në tetorin e vitit 1831, që nga Spanja, Malta, Shqipëria, Greqia dhe Lindja e Mesme.

---

[18] Johann Joachim Winckelmann (1717 – 1768) ka qenë një historian arti dhe arkeolog, gjerman. Ai është një ndër themeluesit e helenizmit dhe i pari që bëri dallimin midis artit grek, greko – romak dhe atij thjesht romak

[19] British Museum, London.

Ky udhëtim la kujtime të pashlyera në tërë jetën e tij të mëvonëshme. Nga Korfuzi ai udhëtoi në Artë dhe në Janinë.[20]

Arësyeja e udhëtimit të Disraelit ishte të dërgonte një letër të Sir Frederick Adam, guvernatori i Ishujve Jonian, tek Veziri i Madh.[21] Ai u mrekullua në veçanti nga bota shqiptare e atyshme dhe kostumet e tyre. Që nga Janina ai i shkroi letra familjes dhe të jatit të cilat janë studjuar dhe botuar me vëmendje të posaçme nga dr. Robert Elsie.[22] Ndër tjera Disraeli i shkruante babait të tij:

> *"I shtrenjti im baba! I shkrova Ralfit nga Malta ndërsa juve nga Korfuzi…Të përmënda në letër se kishte një mundësi që t'i bëja vizitë Vezirit të Madh në vend-ndodhjen e tij në Janinë, kryeqyteti i Shqipërisë.*
>
> Pastaj vazhdon:
>
> *"Mëngjesin tjetër bëmë një vizitë tek guvernatori Kalo Bej, i cili njëherë e një kohë kishte qenë më i pasuri i vendit ndërsa tani ai është njëri prej fisnikëve më të fuqishëm shqiptarë."*
>
> Dhe më tej:
>
> *"Kostumet shqiptare, janë pambarimisht të larmishme në kombinacionet e tyre."* [23]

Edhe pse ka ruajtur një pjesë të madhe të elementëve të së vërtetës historike, ai për arësye artistike e ka shtrirë terrenin e veprimeve të heroit të tij, Iskanderit edhe jashtë trojeve të Epirit. Kështu në fillim të veprës ai na shfaqet në një skenë antike të Akropolit në Athinë, i veshur me kostum *shqiptar*. Pastaj në Krujë, Petrelë, Kallishtë, etj. Kjo vepër letrare e Disraelit është shumë e rëndësishme për shumë arësye.

- Së pari dhe mbi të gjitha atë e ka shkruar një njeri shumë i madh: Benjamin Disraeli, trashëgimia e të cilit është e gdhendur në veprën letrare dhe në jetën politike të një vendi që i ka dhënë botës aq shume: Britania e Madhe.
- Së dyti libri është shkruar në një kontekst historik kur shqiptarët sapo fillonin ri-zgjimin e tyre kombëtar, ku figura e Skënderbeut ishte pishtari që do t'ju ndriçonte rrugën dhe do t'i frymëzonte. Të kemi parasysh se vetëm tre vjet pas botimit të këtij libri, Jeronim De Rada, që nga Shën Mitër Korona botonte Këngët e Milosaos duke shënuar kështu fillimin e Rilindjes tonë Kombëtare (1836).

Personazhet e Librit

Figurat Historike: Në këtë novelë lëvizin si *personazhe historike* figurat e tre njerëzve më të shquar të kohës së vet, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu i Shqipërisë, Janosh Huniadi i Hungarisë dhe Princi Mahomed i II – të, Sulltani i ardhshëm Fatih, pushtuesi i

[20] *Disraeli's Grand Tour: Benjamin Disraeli and the Holy Land, 1830-1831*. London: Faber & Faber, 2013.
[21] Sultana, Donald. *Benjamin Disraeli in Spain, Malta, and Albania 1830-32: A Monograph*. London: Tamesis Book Limited, 1976.
[22] Dr. Robert Elsie, (1950 – 2017) studiues i shquar i letërsisë dhe Historisë së Shqipërisë, ka botuar letrat e Benjamin Disraelit në uebsitin e tij, www.elsie.de
[23] Letër e shkruar nga Disraeli më datën 25 tetor 1830 e cila gjëndet në titullin: *Home Letters written by the Earl of Beaconsfield in 1830 and 1831*, (Letra të shkruara prej *Earlit të Beaconsfield në vitet 1830 dhe 1831)*, publikuar nga Ralph Disraeli, Londër, John Murray 1885, shtypur rishtas në New York, Kraus Reprint 1970), faqe 75-95.

Kostandinopojës në vitin 1453. Ekzistenca historike e këtyre figurave e bën librin intersant dhe i shton vlerat njohëse të ndërthurura me krijimin artistik.[24]

Personazhet Artistike: Iduna, vajza e Janosh Huniadit, Nikeas, një emër anonim grek, Princ i Athinës të cilët gjënden thuajse në çdo faqe të librit. Në sfond historik përmendet Sulltan Murati II, pengmarrësi i djemëve të Gjon Kastriotit dhe adoptuesi i më të voglit të tyre, Gjergjit apo Skënderbeut, si dhe personazhe të tjera plotësuese. Në skenë janë Krye-eunuku i Princit Mahomed, Kaflis, Eremiti, Prifti Kozma, etj.[25]

a) Titulli i librit

Titullimi i librit me një emër thuajse të njejtë me atë të Skënderbeut, por me një ndryshim - *Iskander*, të cilin e përdor edhe Bajroni, të kujton menjëherë se ai është heroi ynë kombëtar.

b) Emërtimi shqiptar i vendeve në libër

Fusha e veprimeve është e tëra në Ballkan dhe përkon me emra të vërtetë gjeografikë. Për ta bërë veprën më shqiptare aty gjënden emra vendesh në Shqipëri si vetë *Shqipëria, Epiri, Kruja, Petrela, Kallishta*. Këto tregojnë plotësisht se veprimet kryhen në territorin i cili ka qenë përjetësisht shqiptar nga një hero po ashtu shqiptar – Skënderbeu edhe pse i quajtur Iskander.

c) Rekuizita

Rekuizita e veprës është kostumi kombëtar shqiptar i heroit të librit, Iskenderit, pra Skënderbeut tonë që në paraqitjen e tij të parë në libër pranë Tempullit të Minervës në Athinë.

d) E vërteta historike

- **Fakte historike**: Në libër del qartë marrja peng e të katër të bijëve të Princit Gjon Kastrioti, i cili nuk përmendet me emër në vepër por thuhet Princi i Epirit,

[24] Hıristiyan Tarihçiliğinin bir Yansıması olarak Richard Knolles'un The Generall Historie of the Turkes Adlı Eseri, Oxford 1603

[25] "The Rise of Iskander" marrë nga botimi elektronik i kryer nga Unversiteti Adelajde, Australi: eBooks@Adelaide The University of Adelaide Library, University of Adelaide, South Australia 5005.

helmimi i tre prej tyre nga Sulltan Murati II dhe adoptimi i më të voglit nga ana e këtij të fundit për shkak të dhuntive të tij të jashtëzakonëshme dhe më pas emërtimi i tij Skënderbeg, në respekt të Aleksandrit të Madh me origjinë ilire. Të gjitha këto dalin qartë në libër.[26]

- Dërgimi i Iskanderit në ndihmë të ushtrisë turke në luftë kundër Vladislavit të Polonisë dhe Vojvodës Huniadi të Transilvanisë; takimi i tij me Huniadin dhe marrëveshja që ata bëjnë për të mbrojtur krishtërimin; marrja e fermanit nga mëkëmbësi i sulltanit dhe përdorimi si dokument para guvernatorit turk të Krujës për lëshimin e qytetit pa luftë; kalimi i Skënderbeut nëpër kalatë e tjera ku në vepër përmendet qartë me emër Kalaja e Petrelës madje në një distancë udhëtimi një ditor me kuaj nga Kruja, janë fakte që përkojnë plotësisht me të vërtetën.
- Kthimi i Skënderbeut në Krujë, çlirimi i qytetit, triumfi mbi turqit, mposhtja e forcave të Sulltan Muratit II dhe të birit të Sulltan Mahomedit– Fatih po ashtu janë të evidentuara nga historia e mesjetës dhe janë të tëra fakte të njohura.

Janë këta elementë që e bëjnë veprën e Benjamin Disraelit shumë të dashur për lexuesin shqiptar pasi ai e kthen një histori kaq legjendare në një romancë me përbërës artistikë, duke sjellë shumë të dhëna dhe njohje historike me veprën e tij. Ajo që meriton të vlerësohet tek ky libër është se Disraeli në atë kohë, pra në vitin 1833 dinte aq shumë për historinë e heroit tonë kombëtar dhe vendosi ta shkruaj dhe ta botojë bashkë me veprat e tij të radhës, në një triologji, në një formë artistike në vend të një përshkrimi të thjeshtë historik.

Vetë trajtimi i heroit tonë kombëtar, i cili luan edhe sot një rol të madh në formimin e ndjenjës patriotike dhe atdhetare tek ne shqiptarët, ka një vlerë shumë të madhe dhe duhet parë si një element shumë pozitiv i veprës. Po ashtu fakti që kjo vepër është botuar me dhjetra herë që nga dalja në dritë për herë të parë tregon për vlerën e saj të padiskutueshme artistike. Për më tepër ajo sot gjëndet thuajse në çdo bibliotekë britanike madje edhe në ato dixhitale. Ndër to edhe në Universitetin Adelajde të Australisë, prej nga është marrë teksti në anglisht i këtij libri.

Është i rëndësishëm fakti që të gjitha edicionet botuese të librit janë shoqëruar me shkrime plot simpati për heroin tonë kombëtar dhe e kanë cilësuar atë si shqiptar. Në pasazhe të caktuara të librit ai lufton për çlirmin e vendit të tij ku përmendet Shqipëria, Epiri por edhe Greqia.

Çdo kritik i kësaj vepre e ka lidhur heroin me vendin e tij të lindjes, Shqipërinë dhe dramën e tij të tmerrshme të humbjes nga sulltan Murati të tre vëllezërve. Po ashtu, meqë libri është ka dalë në dritë disa vjet pasi Bajroni kishte botuar poemën Child Harold-it, ky i bëri të njohur shqiptarët në botën e asaj kohe dhe veçanërisht në atë anglisht-folëse. Kjo është arsyeja se përse kritikët e lidhin edhe me shumë këtë vepër dhe autorin e saj me popullin tonë.

Pra, parë në një këndvështrimi pozitiv, duhet thënë se kjo vepër ka luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin e shumë fakteve historike të kohës, kur Shqipëria u vu nën rrezikun e zhdukjes nga harta e Europës për shkak të pushtimeve osmane. Po ashtu në këtë vepër evidentohet qartë mbrojtja që asaj i bëri Skënderbeu, i cili nuk e harroi atdheun e vet. Po ashtu libri ka një natyrë shumë edukative patriotike pasi në vazhdimësi përmend ndjenjat atdhetare, thirrjen e brendshme që Skënderbeu kishte

[26] Hıristiyan Tarihçiliğinin bir Yansıması olarak Richard Knolles'un The Generall Historie of the Turkes Adlı Eseri, Oxford 1603

për atdheun, detyra më fisnike që ai i kishte vënë vetes në jetë, përplasja me fatin e vet pë të mbrojtur dheun e të parëve.

Që në fillim ai thotë se ka ardhur koha të ndeshem me fatin tim, fatin, i cili do t'i jepte fund lumturisë së garantuar me privilegjet e pafundme që i kishte ofruar sulltani dhe zgjedhja që ai kishte bërë në vend të tyre; ajo e sakrificës për atdheun.[27] Në libër dominon ajo divizë e cila do të formësohej shekuj më vonë nga poeti hungarez Shandor Përtef: "Për dashurinë jap jetën por për lirinë e jap dashurinë."

Nuk e di nëse ka ndonjë përkthim tjetër në gjuhën shqipe i cili do sillte një vepër kaq të bukur nga ana artistike, kaq të pasur nga ana gjuhësore, kaq interesante nga ana kompozicionale, kaq me fantazi në ndërtimin e subjektit, kaq korrekt në planin historik dhe të figurave që ajo mbart, por edhe paksa të devijuar nga ana etno - gjeografike. Megjithatë, studimi që profesor Refik Kadia[28] i ka bërë veprës ka sjellë për audiencën shqiptare mjaft informacion të vlefshëm. Pra nga e tërë kjo galeri kaq e pasur figurash, ngjarjesh, vendesh, autori ka bërë një shmangie e cila shfaqet në format e mëposhtme:

- E ka përmendur shumë herë Greqinë, duke e futur Princin grek Nikeas si personazh dytësor dhe duke e filluar vetë librin në ambjentet e Athinës ndërsa Kështjellën e Kallishtës në një zotërim të një greku siç ishte ky princ.

Një nga arësyet mund të jetë dëshira për të krijuar një vepër artistike e cila ka brenda saj figura të vërteta historike (Skënderbeu, Huniadi, Mahomedi) të kombinuara me figura fiktive si Princi Nikeas, Iduna, Kaflisi, Karam Beu, Musa etj. Kështu Disraeli duhej të krijonte një vepër me një galeri të kombinuar figurash dhe me një ndërthurje të fakteve historike me shpikjet e tij letrare. Intriga e dashurisë së Nikeas ndaj Idunës, pengmarrja e saj nga turqit dhe mbajtja në burg në Adrianopojw, lirimi i saj nga Skënderbeu i maskuar si një doktor armen, mbrojtja që Skënderbeu i bën çiftit pas lirimit nga banda e ndjekësve turq, pengmarrja e dytë e Idunës nga vetë Princi grek, takimi i Huniadit, Skënderbeut, Mahomedit, Idunës dhe Princit në Kallishtë janë të gjitha krijime letrare. Pra duhet të mos harrojmë se subjekti në libër në disa pika nuk ka asgjë të përbashkët me të vërtetën dhe mbetet thjesht një imagjinatë artistike edhe pse shumë interesante dhe tërheqëse.

Po aq pak lidhje me të vërtetën ka edhe fakti që libri deri në një farë mase është helenizuar. Ky element natyrisht që nuk ka aspak efekt tek lexuesi shqiptar, ose edhe ai i huaj i cili e njeh Historinë e Shqipërisë, apo atë të Perandorisë Osmane, të Hungarisë dhe Polonisë, të Greqisë dhe Ballkanit të asaj kohe. Por për ata të cilëve iu mungojnë këto njohuri edhe mund të kenë efektin e përzjerjes së fakteve, vendeve, figurave dhe ngjarjeve që ka sjellë autori dhe mund të ndikojë tek ta. Aq më tepër që, edhe sot e kwsaj dite ka autorë të ndryshëm jashtë dhe brenda Shqipërisë të cilët e venë në dyshim identitetin shqiptar të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Përkthimi në shqip i këtij libri dhe botimi i tij bashkëngjitur me këtë studim të kësaj vepre është një përpjekje për ta "pastruar" atë nga këto pasaktësira, duke ruajtur natyrisht, vlerat e tij të padiskutueshme.

Kjo frymë e helenizimit të fakteve historike të sjellura në një formë letrare është vënë re edhe nga autorë të huaj, kritikë të veprës. Ata duke lavdëruar vlerat artistike të librit kanë dhënë mendimin e tyre në lidhje me këtë "shmangie" nga e vërteta historike.

---

[27] Hıristiyan Tarihçiliğinin bir Yansıması olarak Richard Knolles'un The Generall Historie of the Turkes Adlı Eseri, Oxford 1603, faqe 3

[28] "Një libër i rrallë për Skënderbeun", artikull i shkruar nga Refik Kadia dhe botur në gazetën MAPO 22 shkurt 2017.

Një gjë të tillë ka bërë edhe studjuesi polak *Dr. Andrzej Diniejko*[29], i Universitetit të Varshavës në Poloni, lektor i lartë i letërsisë dhe kulturës angleze. Ai në studimin e tij për këtë vepër thotë:

> *"Është lehtësisht e kuptueshme se subjekti i këtij libri është bazuar në jetën e prijësit të krishterë shqiptar Skënderbeg (Iskanderi) i cili drejtoi me sukses rezistencën kundër zgjedhës otomane nga viti 1440 e më pas. Shqipëria dhe ikona e saj kombëtare Skënderbeg u popullarizuan në fillim në letërsinë angleze prej Lord Bajronit në poemën e tij të famshme "Peligrinazhi i Child Haroldit" (1812-1818). Bajroni vajti në Shqipëri në vitin 1809 dhe iku me një përshtypje të jashtëzakonëshme të cilën e përjetësoi në vargjet:*
>
> O Shqipëri, ku lindi Iskanderi –
> Këngë e rinis', fanar i t'urtëvet! –
> Dhe Iskanderi tjetër, që i dërrmoi
> Përherë armiqt' me Kordhn' e tij kreshnike:
> Shqipëri, lejomë te kthej syt'e mi
> Mbi ty, o nënë e rreptë burrash t'egër"[30]

"Disraeli," vazhdon *Dr. Andrzej Diniejko*, "i cili e nderonte pafundësisht Bajronin madje edhe u përpoq ta prezantonte vetveten si një *"trashëgimtar i tij moral, politik dhe letrar*",[31] ndoqi rrugën e tij drejt Lindjes në vitet 1830-1833. Shqipëria ishte në atë kohë pjesë e Perandorisë Osmane që nga fundi i shekullit të pesëmbëdhjetë" dhe vazhdon:

> *"Ndërkohë që ishte në turin e madh Lindor, Disraeli vizitoi Janinën, në atë kohë kryeqytet i Shqipërisë Jugore nën sundimin Otoman."*

Autori polak thotë se Skënderbeu, në librin e Disraelit, si figurë historike shqiptare, kryengritës dhe hero i këtij populli, rastësisht na del me një emër musliman të quajtur Iskander kur emri i tij i vertetë ishte Gjergj Kastrioti – Skënderbeg. Ai na del në libër si një grek etnik pasi kjo ishte një temë frymëzuese për shumë shkrimtarë të asaj kohe. Disraeli njësoj si Bajroni e mësoi historinë e Skënderbeut ndoshta më mirë se nga kushdo tjetër, nga libri i Eduard Gibonit, *Rënia dhe Rrënimi i Perandorsë Romake*[32] (1776 – 1789) dhe rishkruar në formën e një romance nga Valter Skoti. Në librin e Disraelit, Iskanderi është një trim i cili ndërmerr një rezistencë të suksesshme të krishterë kundër muslimanëve otomanë duke i kthyer kombit të vet, Epirit, lavdinë e mëparshme."

Dr. Andrzej Diniejko vazhdon me një letër të Disraelit shkruar me datën 18 nëntor 1830 që ia dërgon mikut të tij Benjamin Austen," në të cilën ai e përshkruan Janinën si më poshtë:

> *"Për një javë isha dëshmitar i një skene që përmbante gjithçka që ka një Natë Arabe – Procesione, veshje, kortezhe kalorësish me karvane me deve,*

[29] Dr. Andrzej Diniejko (1947) është një lektor i letërisisë dhe kulturës angleze në Universitetin e Varshavës.
[30] Child Harold, shkruar nga G.G.Bajron, përkthyer në shqip nga Skënder Luarasi.
[31] Elfenbeim, Andrew. *Byron and the Victorians*. Cambridge: Cambridge University Press, 1995.
[32] Eduard Gibon "*Decline and Fall of the Roman Empire* "(1776-1789) e gjurmon qytetërimin perëndimor që nga pika kulmore e Perandorisë Romake deri në rënjën e asaj Bizantine. Libri është botuar në vitin 1776 në gjashtë vëllime.

shiheshin çdo ditë. Çdo mëngjes ne bënim vizita, merrnim pjesë në aktivitete, shijonim ëmbëlsira, çdo natë kërcimtaret dhe këngëtarët dërgoheshin tek vend-qëndrimi ynë si dhe i disa pashallarëve."

Siç u tha më lart, novela fillon në Akropolin midis rrënojave të Tempullit të Minervës ku Skëndebeu i ri i *veshur në kostum kombëtar shqiptar* (të cilin e gjen tek çdo shqiptar, thotë Disraeli) takon Nikean shokun e tij më të ri që është Princi i Athinës. Ai ka ardhur aty për t'i lënë lamtumirën atij pasi ka vendosur që të largohet nga ushtria turke dhe t'i bashkohet forcave të krishtera që janë vënë nën komandën e Huniadit. Skënderbeu ka vendosur të luftojë për pavarësinë e Epirit të rënë nën sundimin turk të asaj kohe. Në kapitullin e dytë Disraeli tregon historinë personale të Skënderbeut.

Ky është pasazhi i librit të cilit i referohet studjuesi polak:

"Iskanderi ishte djali më i vogël i Princit të Epirit. Në fillimet e pushtimeve turke, babai i tij bashkë me princat e tjerë epirotë më kot i kishin bërë rezistencë përparimit të ushtrive të Sulltan Muratit të Dytë drejt Europës. Princi i Epirit e kishte arritur paqen me koston më të lartë të mundshme. Sulltani i kishte marrë peng katër djemtë duke i premtuar se do të kujdesej për ta deri sa të arrinin të gjitha rangjet, madje t'ju respektonte edhe besimin fetar. Megjithatë, me vdekjen e Princit të Epirit, Murati nuk mund ta lëshonte rastin për t'i shtuar perandorisë së tij principatën e pasur të cilën e kishte lakmuar aq shumë. Një forcë turke marshoi menjëherë drejt Epirit dhe e pushtoi kryeqytetin e tij, Krujën, ndërsa fëmijët e sundimtarit të vdekur u denuan edhe ata me vdekje. Pamja prej burri, talenti dhe vlerat që shfaqi më i vogli i katër djemve bëri që ai të mos pësonte fatin e tre vëllezërve të tij, të cilët i helmuan. Iskanderi u shkollua në Adrianopojë, u edukua me fenë muhamedane, dhe pasi ai, në një moshë shumë të re ua kaloi në bëmat e tij heroike tërë luftëtarëve të tjerë muslimanë, arriti të bëhej i preferuari i parë i Sulltanit dhe u ngrit me shpejtësi në rangun më të lartë në shërbim të tij.[33]

Rrëfimi i Disraelit i shkon brinjazi, por është konsistent me historinë. Ai i referohet fazës së parë të fushatës së gjatë të Janosh Huniadit (1406 – 1456) një vojvodë hungarez i Transilvanisë. Ai me mbështetjen e Mbretit polak Vladislav, hyjnë brenda kufijve të Ballkanit dhe i mposhtin ushtritë turke. Kjo i inkurajoi edhe popujt e tjerë të Ballkanit të ngriheshin kundër turqve. Është kjo periudha kur Skënderbeu i përzuri otomanët nga Shqipëria dhe e mbajti shpirtin e revoltës për rreth njëzet e pesë vjet nw luftëra të pandërprera.

Vepra e Disraelit është shumë e qëlluar, e bukur në formë dhe e mbushur me fakte historike edhe pse në të është futur një linjë tjetër nëpërmjet të personazhit të Nikeas. Nganjëherë autori e alternon subjektin duke e paraqitur Skënderbeun, i cili vepron në një terren tërësisht të njohur shqiptar dhe e tërheq lexuesin drejt një përzierje etnike të heroit dhe një shtrirje më të gjërë gjeografike të vendit për të cilin ai lufton.

Le ta ilustrojmë me pasazhin e mëposhtëm:

"Despotët e Bosnjës, Serbisë, Bullgarisë dhe princat grekë të Etolisë, banorët e Maqedonisë, Epirit, Athinës, Foçias, Boetias dhe në të vërtetë tërë rajonet e ngushticës së Korinthit ishin kthyer në haraçpagues të Muratit. Pjesa tjetër e

[33] "The Rise of Iskander" marrë nga botimi elektronik i kryer nga Unversiteti Adelajde, Australi: eBooks@Adelaide The University of Adelaide Library, University of Adelaide, South Australia 5005.Kapitulli 2 faqe 6.

Europës mbrohej pa u marrë në zotërim prej tij vetëm falë përpjekjeve të hungarezëve dhe polakëve, të cilët në një aleancë të fortë ishin bashkuar nën sundimin e Vladislavit. Ky i fundit i nxitur prej gojtarisë fetare të Kardinalit të Shën Angelos, i dërguari i Papës, dhe keqardhjes për lotët dhe lutjet e despotit të Serbisë, në kohën kur fillon historia jonë, kishte lënë Budën në krye të një ushtrie të jashtëzakonëshme, kishte kaluar Danubin dhe i ishte bashkuar mëkëmbësit të tij trim, të famshmit Janosh Huniadi. Huniadi, në atë kohë Vojvodë i Transilvanisë i mposhti turqit duke bërë kërdinë mbi ta, çliroi tërë Bullgarinë dhe i shtyu pushtuesit deri tek këmbët e Malit Hemus, i njohur në kohët moderne si Ballkani i famshëm. Këtu gjenerali turk, Karam Beu, i priti të krishterët të cilët, në atë kohë gjetën ndihmën e Skënderbeut. Ky i fundit mori urdhër, të vendosej në krye të një trupe jeniçerësh dhe haraçpaguesish epirotë, të cilët e kishin shoqëruar atë në Greqi."[34]

Më pas libri tregon aventurën "romantike" të Skënderbeut i cili pasi ikën nga ushtria otomane, iu bashkohet forcave të krishtera. Dhe këtu shfaqet talenti i Disraelit si shkrimtar dhe jo si historian. Lady Iduna e bija e Huniadit kapet peng nga Turqit dhe mbahet në Sarajet e Adrianopojës. Ajo sëmuret keqas dhe Princi i kurorës otomane, Mahomed, i biri i sulltan Muratit vendos një shpërblim prej njëqint qesesh floriri për atë që e shëron nga ajo "sëmundje" e çuditshme.

Skënderbeu sapo e ka çliruar vendin e tij. Ai gjëndet në Krujë pasi ka kapur tërë territoret e Epirit thuajse në një muaj, ka marrë pa luftë Petrelën dhe ka përzënë tw tëra forcat otomane që mos t'i gjëndeshin nëpër këmbë në betejat të cilat e dinte mirë se do t'i kishte me turqit. Pas një muaji ai kthehet në Krujë dhe hap postën me letra të cilat i kishin ardhur deri në atë kohë. Ai mezi priste lajme nga Huniadi. Pranë tij është edhe miku i tij më i ri grek Nikeas, i cili ka ardhur në Krujë që të gëzojë fitoren e Skënderbeut mbi turqit osmanë.

Skënderbeu në një moment stepet kur lexon lajmin se vajza e Huniadit, Lady Iduna është marrë peng nga turqit dhe gjëndej e zënë robinë në Adrianopojë. Kjo e bën atë të ndryshojë planet e momentit bazuar në respektin që ushqente ndaj prijësit hungarez dhe një aleance të krishterë që ata kishin bërë. Por në të njejtën kohë ai habitet kur miku i tij grek Nikeas i lutet që të bëjë çfarë të mundet që të shpëtohet ajo vajzë për të cilin Nikeas na paskërkish pasë ushqyer një dashuri të pafundme, por të parrëfyer ndonjëherë mikut të vet, Skënderbeut.

Nga ana e tij, Skënderbeu në takimin e parë me Idunën kishte shkëmbyer dialogun e mëposhtëm dhe kjo nuk kishte ikur pa lënë një shënje emocionale të cilën ai nuk ia ushqente vetes duke ditur detyrat që kishte përpara për çlirimin e vendit të tij:

"Ky është një betim solemn," tha Iskanderi, "edhe më i shenjtë sesa po të ishte shkruar në kodikët e Krishtërimit. Lady Iduna, lutjet tuaja!"
"Ato shkrime bëhen përherë për atletët e Krishtit," u përgjigj vajza e Huniadit. Pastaj u ngrit dhe pelerina e gjatë në të cilën ajo ishte mbështjellur mori një formë të shtrirë dhe madhështore.*"*

[34] Po aty, kapitulli 2, faqe 6

> *"Iskander fisnik, kjo tespihe vjen nga Sepulchra e Shenjtw,"* i tha atij Iduna, *"mbaje për hatrin dhe kujtimin e mbrojtësit tonë të bekuar i cili e dha jetën për të larë mëkatet tona."*
> Iskanderi e mori tespihen, preku si pa dashje dorën delikate të vajzës, puthi me buzë të gjitha rruazat dhe i vari rreth qafës.*"*[35]

Disraeli, në vijim të filozofisë së tij naltësuese të figurave sipas principeve të neoklasiçizmit, zbulon këtu disa prej cilësive më të larta të Skënderbeut. Me të marrë këtë lajm ai vihet përpara mëdyshjes:

Ose të mbronte vajzën dhe nderin e mikut, një virtyt shqiptar që mbizotëron, por edhe përgjegjësise, patriotizmit dhe ndjenjës së dashurisë për vendin e tij. Pra në një situatë të tillë ai duhet të marrë vendimin që të nxjerrë Idunën nga burgimi por të mos vejë në pikëpyetje lirinë e vendit të tij të sapo çliruar nga turqit.

Ai merr masa të menjëherëshme, thërret ushtrinë e tij besnike dhe prijësit shqiptarë (në libër epirotë) dhe iu ndan detyrat sesi ta administrojnë vendin deri në kthimin e tij. Ai e kishte çliruar Epirin dhe ky çlirim kishte ardhur si një triumf. Por ky largim, për të çliruar vajzën e Hunidait, Idunën, mund të shkaktonte rrënimin e tërë arritjes së tij madhështore.

> "*Princ i guximshëm!* Po të lëshoj në dorë besnikërinë time," i tha Huniadi Iskanderit, duke lëvizur përpara drejt tij dhe duke i marrë dorën. Më pas vazhdoi:
> *"Dhe derisa Iskanderi dhe Huniadi të kenë jetë, ata kurrë nuk do të pushojnë së luftuari bashkë deri sa të arrijnë qëllimet e tyre të larta dhe të shenjta."*[36]

Disraeli nuk përjashton faktin se Skënderbeu mund të kishte patur një shkwndi ndjenje simpatie për Idunën që në çastin kur e kishte parë në shatorren e të jatit. Por nga ana tjetër nuk është thjesht dashuria ose shumë më pak, një prekje sado elektrizuese të ketë qenë, ajo që e bën atë të marrë përsipër një nga rreziqet më të mëdha të jetës së tij duke hyrë në pallatin e vetë Sulltan Muratit në Adrianopojën, të cilën shumë pak kohë më parë e kishte braktisur. Disraeli e paraqet Skënderbeun si një mjeshtër të organizimit të nxjerrjes së vajzës së Huniadit nga burgimi duke prekur tre linja *naltësimi* për të:

E para, detyrimi për mikun e madh Huniad,

E dyta, ndjesia e vet personale ose ndonjë dobësi qw nuk ia ushqente vetes.

E treta por ja më pak e rëndësishme - hatri i mikut të tij Princit Nikeas i cili shfaqet në një mënyrë thuajse delirante i shqetësuar për fatin e asaj që ai e paraqet si njeriun e tij të zemrës.

> *"Më trego, më trego për gjithçka! Kjo vonesë po ma bren trurin, Iskander. Ju nuk e dini se çfarë do të thotë emri i asaj vajze për mua. Ajo është i vetmi njeri i qënies time, vetë bekimi dhe mbase farmaku i jetës time. Tregomë i dashur mik! Këtë ta kërkoj me ngulm. Ku është Iduna?"* [37]

I përgjërohet miku i tij, Nikeas, Skënderbeut.

---

[35] Po aty, kapitulli 4, faqe 14
[36] Po aty, kapitulli 4, faqe 14
[37] Po aty faqe 20.

Nxjerrja e Idunës nga burgimi është një sajesë e bukur letrare e vendosur në një plan obskur të një bote shërbëtorësh të korruptuar injorantë, qeveritarësh që notojnë në qejfe dhe ëndrra me haraçet e popujve të pushtuar dhe gjakun që ata derdhin anë e mbanë si të ishte diçka krejt e pavlerë. Aftësitë e Skënderbeut këtu janë të jashtëzakonëshme. Intelegjenca, njohja e gjuhëve, njohja e mentalitetit të oborrtarëve të korruptuar të sulltanit, eunukëve, pasardhësit të tij Sulltan Mahomedit - Fatih të ardhshëm dhe dobësinë e tij për gratë, të gjitha i shfrytëzon me mjeshtri për të nxjerrë Idunën nga burgimi dhe ia del ta bëjë këtë.

Pas tërë asaj sage të gjatë Skënderbeu kthehet në Krujë bashkë me Huniadin dhe festojnë së bashku. Huniadi dhe Skënderbeu ndjehen të tradhëtuar nga Princi grek Nikeas, edhe pse tanimë ai kishte rënë në betejë. Në atë kulm gëzimi për fitoren ndaj turqëve dhe shpëtimin e Idunës, Huniadi i ofron dorën e saj Skënderbeut. Ndërsa njëri nga udhëheqësit I thotë Iskanderit:

> "Është ndjenja e ekzistencës tënde kombëtare dhe përkatësia jote e shenjtë fetare që e solli këtë ditë. Krejt çfarë na duhet të bëjmë tani, është t'i ruajmë këto vlera. Në të vërtetë nuk shoh mënyrë tjetër për t'i ruajtur ato dhe këtë vend të bekuar veçse duke ju rivendour ju në fronin e stërgjyshërve tuaj.

Prandaj unë brohoras:
Zot, ruaje Iskanderin, Mbretin e Epirit!"
Dhe të gjithë njerëzit brohoritën me një zë:
"Zot, ruaje Mbretin tonë!
Zot, ruaje Iskanderin, Mbretin e Epirit!" [38]

Në fakt nuk do të kishte mbyllje më të bukur sesa ajo e dr. Diniejkos kur thotë:

> *"Naltësimi i Iskandert" është një përrallë e dashurisë, luftës dhe patriotizmit në të cilën një hero është portretizuar si zot, Kryqi e mposht Gjysmëhënën, në të gjitha rastet."*[39]

Konkluzion

Kjo vepër ka një rëndësi të veçantw pasi shënon një trajtim letrar të temës së Skënderbeut në prozën angleze. Në 550 vjetorin e vitit ë Skënderbeut, nxjerrja në dritë në gjuhën shqipe e kësaj vepre plotëson dijet tona për heroin tonë, dhe tregon sesa shumë e kanë admiruar të huajt atë, madje edhe figura të tilla të shquara të njerëzimit si kjo e Benjamin Disraelit.

Mal Berisha
Prishtinë, 2 Mars 2018

[38] Finale e veprës "The Rise of Iskander" marrë nga botimi elektronik i kryer nga Unversiteti Adelajde, Australi: eBooks@Adelaide The University of Adelaide Library, University of Adelaide, South Australia 5005. Kapitulli 22 faqe 66.
[39] Dr. Andrzej Diniejko (lindur në vitin 1947) është një lektor i lartë i letërisisë dhe kulturës angleze në Universitetin e Varshavës.

NALTËSIMI I ISKANDERIT

Kapitulli 1

Iskanderi në Athinë

Dielli sapo u fsheh pas maleve matanë fushës pjellore të Athinës. Vendit seç i ra një hije ngjyrë manushaqe. Një puhi e lehtë përkëdhelte gjethet e ullinjëve që harliseshin gjithandej nën fërfërimën e ngrohtë të asaj mbasditje ndërsa majat e flamujve të skuadrave ushtarake turke dukeshin mes tyre deri tek spiranca në Limanin e Pireut. Nga një portë e qytetit gratë dilnin në varg dhe ecnin drejt shatërvanit ndërsa nga një derë tjetër një grup kalorësish të veshur me rroba e pajime të shtrenjta u liruan nga shërbimi ditor dhe i lëshuan me rrëmbim shtizat drejt qiellit vezullues në rroka-trokun e tyre plot gjallëri. Cicërimat e këndshme të zogjëve, zhuzhurima e gjinkallave, notat e dridhura të këngës së bilbilit, kërcimi hopa – tropa i karkalecave dhe era e përzier e luleve që shpërndahej nga ledhatimi i puhisë së lehtë, mbushnin ajrin e freskët si me tinguj muzikorë të natyrës së përzier me endjen dehëse të atij mjedisi.

Një njeri i vetmuar qëndronte mbi një beden të Akropolit, midis rrënojave të Tempullit të Minervës duke soditur atë skenë magjepsëse. Rreth tij ngriheshin monumentet e pashoqe të artit antik, kolonat e pavdekshme, simetria e të cilave sfidon çdo vepër moderne. Statujat e qeta Caryatides që mbajnë madhërishëm peshën e rëndë të hijeshisë, skalitjet e holla dhe të sakta të linjave aq fine të cohave të statujave dukej sikur frymonin njësh me jetën heroike të lënë pas. Me sa duket ky i *huaj*, edhe pse në dukje i veshur me rroba muslimane, nuk ishte i pandjeshëm ndaj gjenisë së krijuesve të atij vendi ku po qëndronte. E prapëseprapë, forma me të cilën shfaqej ai vetë ishte e papajtueshme me gjëra të tilla dhe nuk i përshtatej mjedisit të kohës së Perikliut dhe Fidias. Që në fillim të jetës, madje edhe më heret, fuqia e muskulit prej të cilës kishin dalë këto vepra madhështore, gati sa nuk e kishte tejkaluar simetrinë pothuajse ideale të natyrës. Dhe tani, po aty, balli i gjërë i këtij të *huaji,* profili i rregullt, forma ovale e fytyrës, buzët e skalitura si me dorë, shfaqnin të njejtën pamje që kishte frymëzuar skulptorin e asaj rrethine të ndërtuar me gjysmë perëndi.

Veshja e këtij të *huaji*, megjithëse ishte shumë e bukur, prapë se prapë nuk kishte asgjë klasike. Ai kishte mbështjellur rreth kokës një shall të kuq me xhufka, në majat e të cilave xixëllonin diamantet zbukuruese. Jeleku i gjelbërt kadife, që i shkonte shik pas trupit, ishte qendisur plot me fije floriri dhe margaritarësh. Sipër, ai kishte veshur një xhaketë të lehtë kadifeje all të *kuqe*, njësoj të qëndisur dhe me ndarje elegante nga shirita të *zinj.* Po ashtu një *fustanellë* e gjatë i shkonte aq shume pas trupit, - një rrobë të cilën e gjen të veshur nga çdo *shqiptar.* Ai kishte mbathur sandalle, ndërsa pjesa e poshtme e këmbëve kishte shpatëza mbrojtëse, kallçinë në formë mburoje të veshura me kadife të gjelbërt, të qëndisur shumë bukur. Nga një rryp i gjërë prej lëkure në të kuqe të ndezur, ngjeshur pas brezit, shfaqeshin dorezat e disa thikave. Anash dukej një kordhë shumë e madhe e futur në një këllef të praruar me argjend. Ky i *huaj* e kishte tretur vështrimin larg drejt horizontit që i shfaqej përpara, i zhytur i tëri në përsiatje të thella abstrakte.

"Sa vend i bukur!" ofshau ai, "Ky është arti i vendit tim. Ky vend i trishtë është vendi im. Një vend i zymtë dhe i çuditshëm, pa gëzim dhe pa shpresë. Tek e fundit, unë

jam luftëtar dhe kjo armë, edhe pse është stërvitur të luftojë kundër këtij vendi, në orën e rëndë të betejës, nuk do të harrojë gjakun që vlon në dejet e mia. Themistokliu e mbrojti Greqinë, por vdiq si një satrap, ndërsa unë e di se çfarë bëj. Le t'i ndërrojmë vendet sepse unë dua të vdes si patriot."

Në këtë moment në një manastir aty pranë u dëgjua të këndohej Hymni kushtuar Virginës. I *huaji* u nis sapo dëgjoi melodinë e shenjtë, nxori nga gjoksi një kryq të vogël, të artë, që e mbante mbi zemër, e puthi me nderim dhe i zbriti shkallët e kështjellës me hap të shpejtë deri sa mbërriti atje poshtë në qytet.

Ai eci i vetëm në rrugët e ngushta gjarpëruese të Athinës deri sa në fund u ndesh me një pallat prej mermeri. Në ndërtimin e tij arkitekti sigurisht nuk i kishte marrë parasyshë modelet që e rrethonin, të cilat koha i kishte ruajtur aq bukur. Edhe pse shija klasike mund të ishte cënuar nga këto gjëra të kohës, prapëseprapë ato paraqisnin të gjitha së bashku një pamje madhështore.

Një gjysmë dyzine rojesh, mburojat dhe helmetat e të cilëve çuditërisht bënin kontrast, ishin rreshtuar përpara hyrjes ku gjëndeshin dy topa në dy anët e portës. Të pranishmit e pritën me nderime ushtarake të *huajin* ndërkohë që ai kaloi aty pranë. Ai eci me hapa të rëndë dhe hyri brenda një salle katërkëndëshe, me pasazhe anash, e rrethuar prej një numri të konsiderueshëm shtyllash të holla, të ulëta, të bëra nga mjeshtra barbarë me mermer të ngjyrave të ndryshme. Në mes të kopështit ngrihej një shatërvan prej nga pluskonin ujërat për tu shpëndarë nëpër kanalet artificiale të cilat e çonin ujin nëpër bahçetë me portokalla dhe limona. Në anën tjetër të shatërvanit gjëndej një kolltuk luksoz, në të cilin ishte ulur dhe vështronte i perqëndruar mbi ndriçuesin e stolisur, i qetë dhe pa fjalë, Princi i ri i Athinës.

Sapo i *huaji* u afrua, Princi me një qeshje të lehtë në fytyrë, iu drejtua:

"Uau, a ti qenke? Keni arritur pikërisht në kohën e duhur për të më kujtuar se ne duhet të bëjmë diçka më shumë sesa të lexojmë Persæn. Me pak fjalë neve na duhet të veprojmë."

"I dashuri im Nikeas," iu përgjigj i *huaji*, "Unë kam ardhur vetëm për të thënë lamtumirë!"

"Lamtumirë!?" bërtiti Princi me një ton habie dhe keqardhje dhe u ngrit menjëherë nga kolltuku. "Pse, kështu, çfarë do të thotë kjo?"

"Është krejt e vërtetë;" tha i *huaji* dhe bëri me shenjë nga njëra prej rrugëve që të çonte tatëpjetë. "Kanë ndodhur ngjarje të tilla të cilat kanë bërë që tëra planet dhe shpresat e mia të prishen duke më vënë në një pozitë sa të vështirë aq edhe pikëlluese. Huniadi, papritmas ka kaluar Danubin me forca të mëdha dhe ka fshirë gjithçka që ka gjetur përpara. Ndërsa unë kam marrë urdhër të drejtohem menjëherë drejt *Shqipërisë* dhe të vendosem në krye të kampit të epirotëve."

"Me të vërtetë?" tha Nikeas, duke marrë një pamje prej të habituri. "Nuk isha i përgatitur të dëgjoja këtë lajm. Është diçka krejt e papritur! Po Murati, a është vetë në fushatë?"

"Jo, Karam Beu është në komandë. Unë e kam justifikuar vonesën për tu paraqitur tek Sulltani duke nxjerrë si pretekst vështirësitë që hasa për të arritur marrëveshjen dhe duke zgjuar shpresën se mund të mbledhim edhe më shumë haraçe."

"Kur do të vijë dita që atë haraç të mos e paguajmë më?" shtoi Nikeas duke buzëqeshur.

"Mjerisht i dashur mik," u përgjigj komandanti turk, "situata ime tani ka ardhë në një pikë kritike. Deri më sot shërbimet e mia për Muslimanët kanë mbetur vetëm në kuadër të veprimeve luftarake kundër kombeve të fesë së tyre. Tani, papritmas jam thirrur të luftoj kundër besimit tim të fshehtë dhe aleatit tim më të mirë, të cilin ende e njoh si atdheun tim të vërtetë. Levizja, siç më duket mua, duhet bërë tani: O tani, o

kurrë! Unë nuk mund t'ja fal vetvetes të mos veproj në këto momente pasi edhe në rrethana më pak të favorëshme se këto, do duhej vepruar. Jo më tani!"

"Nëse ju jeni i pikëlluar" tha Nikeas, "unë duhet të jem i dëshpëruar. Ka qenë natyra jote gjakftohtë që më ka mbajtur gjithë kohën me shpresën se një ditë qëllimet tona do të realizoheshin përkundër rreziqeve që mbartin ato."

"Edhe Eskili"?" tha i *huaji* duke qeshur.

"Edhe Eskili, sigurisht," u përgjigj Nikeas; "por unë kam arritur në një pikë kur edhe Eskilin e shoh si të padobishëm. Mua vetë po më hanë duart që të bëj diçka."

"Mund të jetë më afër sesa e parashikonim ne," u përgjigj i *huaji*. "Zoti iu jep formë të gjitha gjërave. Ai nuk do të braktisë një kauzë fisnike sepse e di se qëllimet e mia janë po aq të pastra sa ç'janë të vështira rrethnat e mia. Unë kam disa ide që më vlojnë në kokë por që duhen qartësuar më mirë. Megjithatë nuk do t'i diskutojmë tani. Më duhet të iki i dashur Princ. Flladi i mbrëmjes më bën mirë. Po Huniadin a e ke parë ti ndonjëherë?"

"Unë kam marrë mësime në Oborrin e Transilvanisë," u përgjigj Nikeas duke mos e vështruar në sy dhe me një ndjenjë disi si të bezdisur. "Ai është një kalorës i famshëm, mburoja kryesore e krishtërimit."

Komandanti *turk* ofshau. "Kur të takohemi përsëri," tha ai "uroj të takohemi me pritje më të mëdha dhe shpirt më shpresëdhënës. Tani për tani, më duhet vërtetë të them: Lamtumirë!"

Princi iu kthye me një gjest miratimi të pikëlluar duke i vënë dorën mbi gjoks aty ku rreh zemra.

"Është një ndarje e trishtueshme," pëshpëriti ai, "po të kemi parasyshë kohërat e lumtura që kemi kaluar dhe idealet tona fisnike."

"Ju jeni ende tepër i ri për tu grindur me fatin," u përgjigj i *huaji,* "ndërsa për veten time, unë ende nuk i kam qëruar hesapet me fatin tim."

Megjithatë, për tani për tani, lamtumirë, i dashur Nikeas!"

"Lamtumirë," u përgjigj Princi i Athinës,

"Lamtumirë i dashur Iskander!"

Kapitulli 2
Retrospektivë - Pengmarrja e Iskanderit dhe vrasja e vëllezërve Kastrioti.

Iskanderi ishte djali më i vogël i Princit të Epirit. Në fillimet e pushtimeve turke, babai i tij bashkë me princat e tjerë epirotë më kot i kishin bërë rezistencë përparimit të ushtrive të Sulltan Muratit të Dytë drejt Europës. Princi i Epirit e kishte arritur paqen me koston më të lartë të mundshme. Sulltani i kishte marrë peng katër djemtë duke i premtuar se do të kujdesej për ta deri sa të arrinin të gjitha rangjet, madje t'ju respektonte edhe besimin fetar. Megjithatë, me vdekjen e Princit të Epirit, Murati nuk mund ta lëshonte rastin për t'i shtuar perandorisë së tij principatën e pasur të cilën e kishte lakmuar aq shumë. Një forcë turke marshoi menjëherë drejt Epirit dhe e pushtoi kryeqytetin e tij, Krujën, ndërsa fëmijët e sundimtarit të vdekur u denuan edhe ata me vdekje. Pamja prej burri, talenti dhe vlerat që shfaqi më i vogli i katër djemve bëri që ai të mos pësonte fatin e tre vëllezërve të tij, të cilët i helmuan. Iskanderi u shkollua në Adrianopojë, u edukua me fenë muhamedane, dhe pasi ai, në një moshë shumë të re ua kaloi në bëmat e tij heroike tërë luftëtarëve të tjerë muslimanë, arriti të bëhej i preferuari i parë i Sulltanit dhe u ngrit me shpejtësi në rangun më të lartë në shërbim të tij

Në këtë periudhë, përparimi i papërmbajtshëm i ushtrive turke u bë çështje shumë shqetësuese në mbarë botën e krishterë.

Konstandinopoja, në atë kohë kryeqyteti i Perandorisë Greke, ishte rrethuar më shumë se një herë prej paraardhësve të Muratit por ishte mbrojtur vetëm falë rastësive fatlume ose kushteve poshtëruese që iu ishin imponuar mbrojtësve të saj.

Despotët e Bosnjës, Serbisë, Bullgarisë dhe princat grekë të Etolisë, banorët e Maqedonisë, Epirit, Athinës, Foçias, Boetias dhe në të vërtetë tërë rajonet e ngushticës së Korinthit ishin kthyer në haraçpagues të Muratit. Pjesa tjetër e Europës mbrohej pa u marrë në zotërim prej tij vetëm falë përpjekjeve të hungarezëve dhe polakëve, të cilët në një aleancë të fortë ishin bashkuar nën sundimin e Vladislavit. Ky i fundit i nxitur prej gojtarisë fetare të Kardinalit të Shën Angelos, i dërguari i Papës, dhe keqardhjes për lotët dhe lutjet e despotit të Serbisë, në kohën kur fillon historia jonë, kishte lënë Budën në krye të një ushtrie të jashtëzakonëshme, kishte kaluar Danubin dhe i ishte bashkuar mëkëmbësit të tij trim, të famshmit Janosh Huniadi. Huniadi, në atë kohë Vojvodë i Transilvanisë i mposhti turqit duke bërë kërdinë mbi ta, çliroi tërë Bullgarinë dhe i shtyu pushtuesit deri tek këmbët e Malit Hemus, i njohur në kohët moderne si Ballkani i famshëm. Këtu gjenerali turk, Karam Beu, i priti të krishterët të cilët, në atë kohë gjetën ndihmën e Skënderbeut. Ky i fundit mori urdhër, të vendosej në krye të një trupe jeniçerësh dhe haraçpaguesish epirotë, të cilët e kishin shoqëruar atë në Greqi.

Sikur Iskanderi të ishte ndikuar prej ambicjeve të rëndomta, edhe dëshirat e tij më të çmendura do të ishin plotësuar falë karrierës**,** të cilën Murati ia kishte paracaktuar me kohë. Sulltani turk e mendonte atë si Princin e Greqisë, donte t'i jepte të bijën për grua dhe t'i dorëzonte komandën kryesore të ushtrisë. Ai i dha bujarisht rangun më të lartë dhe pasuri të pakufishme. A vinte kjo si një ndjesë për atë që kishte bërë ndaj vëllezërve të tij apo afeksion për një luftëtar trim, kjo është një gjë e diskutueshme. Por një gjë dihej se vlerat e pakrahasueshme të Iskanderit dhe aftësitë e jashtëzakonëshme të shfaqura në luftë kishin bërë që ai të vendoste nën sundimin e Sulltanit njërën prej provincave më të bukura të Azisë. Mendohej nga të gjithë se Iskanderi duhet të ketë ushtruar ndikim mbi Muratin në një shkallë aq të lartë sa asnjë oborrtar tjetër nuk kishtë arritur ndonjëherë.

E megjithëkëtë, zemra e Iskanderit i tha jo këtyre favoreve mikluese. Edukimi i tij turk nuk mundi asnjeherë të çrrënjoste kujtesën dhe ndërgjegjen e tij kombëtare. Dhe megjithëse ai u rrit në një mjedis me fe muslimane, në karrieren e tij të herëshme ai kishte ruajtur besimin e baballarëve të vet të krishterë. Ai shihte tek Murati vrasësin e njerëzve të tij më të dashur dhe shtypësin e vendit të vet. Maturia e veçantë dhe gjykimi i ftohtë, veti të zhvilluara që shumë heret në karakterin e tij, bënë që ai të mos jepte asnjë shenjë të këtyre ndjenjave të fshehta që i vlonin në shpirt. Iskanderi, prej kohësh e kishte tjerrur në mëndje planin madhor që e priste për çlirimit e vendit të tij.

I dërguar ne Greqi për tu marrë me haraçet dhe marrëveshjet me Princat grekë, Iskanderi u takua me Nikeas - in dhe shpejt njohja e tyre u kthye në miqësi. Nikeas ishte i ri, pa përvojë. Natyra nuk e kishte krijuar për të ndërmarrë veprime të rrezikshme. Princi i ri i Athinës e kalonte kohën duke u shulla në anë të shatërvanit duke ëndërruar për mrekullitë e ditëve që do të vinin, i rrethuar prej eunukëve, priftërinjëve, dhe oborrtarëve të tij. Ai e adhuronte Leonidhën dhe donte të matej me Themistokliun; i ishte përkushtuar me pasion letërsisë antike të vendit të tij dhe kishte përftuar një shije të lartë, e rrallë për kohën e tij. Preferonte Demostenin, prej Lysas tek Chrysostom dhe Gregorin si dhe korin e teatrit grek deri tek hymni i kishës greke. Energjia e qëndrueshme dhe thjeshtësia fisnike e karakterit të Iskanderit dukej se i kujtonte Princit të ri heronjtë klasikë prej të cilëve frymëzohej shumë herë. Entusiazmi dhe ëndërrat e Nikeas dhe të gjitha dobësitë që shfaqte ndaj lakmive njerëzore dhe peripecive emocionale ndaj të cilave dorëzohen burrat e ndjeshëm, e çonte tek një simpati e thellë ndaj përvojave më të mira dhe mendjes së hollë të shokut të tij.

Iskanderi për herë të parë në jetë po i besonte shumë nga sekretet e zemrës së tij, dikujt, Nikeas pra. Princi i ri, u ndez nga rrëfimi frymëzues që dëgjoi. Secili prej tyre shpesh fliste me tjetrin për fatin e vendeve të tyre.

Të ekzaltuar prej gjërave të njëjta që i bashkonin**,** ata guxuan të flisnin edhe për ndikimin që mund të kishin në çlirimin e vendeve të tyre, kur Iskanderi të vihej në komandë.

Ishte një ndarje e dhimbshme. Të dy ndjenin se në këta muajt e fundit në shoqërinë e tyre kishin ndodhur shumë gjëra të bukura. Ndarja e miqëve, të cilët kanë shumë veti të përbashkëta është përhere e dhimbshme. Dhe midis miqve kjo dashamirësi jeton edhe nëse ata nuk shihen më kurrë.

Iskanderi hypi në anije i pikëlluar por i qetë. Nikeas u kthye tek pallati hijerëndë dhe i vrazhdë, u grind nga nervozizmi me oborrtarët e tij, dhe kur mbeti vetëm, u shkreh në vajë.

Kapitulli i 3
Iskanderi në Malet Ballkanike Hemus midis Karam Beut dhe Janosh Huniadit.

Kaluan tre javë qëkurse Iskanderi dhe Nikeas u ndanë nga njëri tjetri. I pari, në krye të dhjetë mijë burrave, nëpër një rrugë plot me pengesa, hyri nëpërmjet grykës së Malit Hemus dhe arriti tek kampi turk i cili ishte vendosur në fushim mbi një pllajë të gjërë e të lartë, e rrethuar nga tëra anët prej kodrash të fortifikuara që mbroheshin shumë mirë prej jeniçerëve. Epirotët ndaluan dhe filluan menjëherë të ngrihnin çadrat, ndërsa komandanti i tyre, i shoqëruar prej disa oficerëve, u nis menjëherë në drejtim të shatorres së Karam Beut.

Arritja e Iskanderit u prit me gëzim të madh prej ushtarëve turq. Ndërkohë që ai kaloi mes për mes fushës së mbuluar me çadra, dëgjonte brohoritjet e luftëtarëve që dëshmonin se sa të gatshëm ishin ata të luftonin nën komandën e një prijësi aq të suksesshëm sa ç'ishte ai vetë. Një truprojë nderi e urdhëruar prej Karam Beut, paraprinte për të njoftuar ardhjen e Iskanderit. Sapo hyri në shatorre, Princi Epirot shkëmbeu me mirësjellje përshëndetjet e rastit me gjeneralin turk. Pas përshëndetjeve zyrtare, Karam Beu bëri një gjest me dorë që shatorrja të zbrazej. Kjo ndodhi sa çil e mbyll sytë. Aty mbeti vetëm Musa, sekretari përgjithshëm dhe njeriu më i afërt i komandantit turk.

"Iskander! Ju keni arrdhur në kohën e duhur për të parë me sytë tuaj shpartallimin e qenëvë të krishterë," nxitoi të thoshte Karam Beu. "Të ngazëllyer prej suksesit që arritën të mallkuarit kanë marrë shumë zemër. Dy herë provuam të kalonim mes për mes maleve dhe dy herët u detyruam të zmbrapseshim duke pësuar humbje të mëdha. Vendkalimet ishin të gjitha të bllokuara me drurë dhe gurë shumë të mëdhenj. Ata qenër e kanë humbur krejt shpirtin dhe po bien për ditë në mjerim, vuajtje, uri dhe të ftohtë. Zbuluesit tanë na njoftojnë se ata po tregojnë shenja të lodhjes dhe tërheqjes. Neve na duhet të shpejtojmë, të zbresim nga malet me furi dhe t'i asgjësojmë."

"A është edhe vetë Huniadi me ta?" pyeti Iskanderi.

"Ai këtu është," u përgjigj Karami, "është vetë ai qen bir qeni! Eja Iskander! Koka e tij mund të jetë një dhuratë fantastike për Padishahun në këtë muaji Ramazani. Është një kokë që vlen sa tre bishta, do të thoja," e mbylli ai këtë deklaratë dhe qeshi me histeri.

Sekretari i përgjithshëm, Musa, për t'i shkuar pas qejfit komandantit të tij, ia futi një qeshje të shtirur për këtë shaka ndërsa Iskanderi vetëm sa e çoi pak buzën në gaz.

"Nëse ata tërhiqen, ne patjetër duhet t'i sulmojmë," vërejti Iskanderi, pa u menduar gjatë. "Unë kam një parandjenjë se do të takohem shpejt me Huniadin."

"Në pastë bërë emër Allahu" kërceu Karam Beu. "Unë nuk dyshoj për këtë. Huniadin ua kemi ruajtur juve, Iskander! Neve na duhet t'i mbajmë kokat lart. Jeni Ju që i keni luajtur kartat kohëve të fundit?"

"Sa më pak fjalë!" iu kthye Iskanderi me një ton gati urdhërues. "Sa më pak nga këto, mirë!?"

"Nuk ishin asgjë më shumë sesa disa lëvdatave të rastit për vlerat dhe maturinë tuaj."

"Do bëjmë më të mirën, do bëjmë më të mirën. A do ta marrë Isa Beu Etolian, si mendoni ju?" e pyeti atë Iskanderi.

"Unë nuk kam ndonje dyshim për këtë. Padishahu ynë i madh nuk do t'i harrojë fëmijët e tij dhe Isa Beu është një nga prijësit më të guximshëm**"**.

"A keni dëgjuar se ai do të vijë këtu?" Pyeti Karam Beu.

"Pse a paskeni dëgjuar ju?" u përgjigj Iskanderi.

“Thashetheme, thashetheme” u përgjigj Karam Beu. “Ai është në Adrianopojë, apo jo?”

“Edhe mund të jetë.” “Siç e dini edhe ju, unë po vij nga Athina.”

“E vërtetë, e vërtetë. Ne do t’i mundim, Iskander, do t’i mundim!”

“Unë për veten time ndjehem i qetë,” u përgjigj Princi, dhe u ngrit të shkonte e të pushonte. “Tani më duhet të jem me ushtarët e mi. Na duhet t‘i dimë saktësisht lëvizjet e të krishterëve përpara se të vendosim për veprimet që do të ndërmarrim. Unë kam prirjen që gjërave tu dal përpara. Sa larg mund të jenë ata?”

“Aq larg sa nuk ka vend për të vendosur ndonjë repart tonin midis tyre dhe maleve.” u përgjigj Karam Beu.

“Në rregull. “Fitorja është në anën e atyre që vërtetë besojnë tek ajo”.

“Deri nesër në agim do të dimë më shumë.”

Kapitulli 4
Iskanderi në shatorren e Janosh Huniadit.

Iskanderi u kthye tek trimat e tij. Nata po binte. Zjarret dhe dritat ndriçonin anë e mbanë nga çdo drejtim. Ajri ishte i pastër por shumë i ftohtë. Ai hyri në tendën e tij dhe pasi u mbështoll me peliçen prej lëkure zibeline, e mbrehu vraçin dhe duke mos pranuar shoqërues, kalëroi në një distancë të shkurtër deri sa doli nga rrrethina e kampit. Pastaj e ktheu kalin në drejtim të njërit prej shtigjeve më të ngushta të malit dhe duke galopuar me shpejtësinë më të madhe të mundshme nuk ndaloi deri sa arriti në një pikë të lartë vrojtuese. Rruga kalonte nëpër një rrëpirë të thyer. Masivet e gurëve të rrokullisur e penguan seriozisht ecjen e tij, por kali i tij i Anadollit prapëseprapë e mbante atë brenda valës kohore të guximit. Brenda tre orëve ai kishte arritur majën e Malit Hemus. Një hënë e plotë ndriçonte fushat e gjëra të Bullgarisë dhe dukej sikur luante me dritë hijet e saj që formoheshin në tokë. Në këmbët e vargmaleve, zjarret që flakëronin tregonin se çfarë kishte atje tek kampi i të krishterëve.

Iskanderi vazhdoi poshtë me një shpejtësi tejet të guximshme. Vraçi i tij ishte prej rrace të pastër ndërsa ai çast ishte momenti më i artë i jetës së tij. Pak para mesnatës ai arriti tek portat e armikut dhe menjëherë u ndesh me një roje.

"Kush është aty?" thirri roja.

"Një mik i të krishterëve," iu përgjigj Iskanderi.

"Bota?" tha roja, duke shqiptuar fjalën e parë të parullës.

"Nuk e kam atë" u përgjigj, jo dhe aq qetësisht. "Jam vetëm, por kujdes se nuk jam i pa-armatosur. Nuk e njoh 'Botën'. Vij prej një vendi të largët dhe kam me vete lajme të rëndësishme për Huniadin e Madh. Më prij për tek prijësi juaj."

"A mund të bëj kryq nëse dua ta bëj," u përgjigj roja, "përpara se të mësoj se kush jeni dhe çfarë doni ju? Eja, por qëndro larg, veç nëse dëshiron të provosh majen e mprehtë të një thike polake drejt e në zemër," vazhdoi roja. Ju siguroj se është diçka shumë më djegëse dhe e dhimbshme sesa zjarri grek, në se edhe ju jeni me të vërtetë i tillë."

"Miku im, ju qenkeni shumë i trashë ndërkohë që koha ime është shumë e shtrenjtë për ta humbur në diskutime të tilla të kota," iu hakërrye Iskanderi rojes. Pasi e tha këtë, komandanti turk e rrëzoi rojen për tokë me një të rënë, e kapi për zverku me duart e tij muskuloze me lehtësinë më të madhe, e hodhi mbi shpatullat e veta dhe duke e kërcënuar me vdekje të menjëhereshme nëse kundërshtonte, e mbuloi me peliçen e vet dhe bashkë me të në shpinë hyri në kamp.

Ata arritën tek një zjarr i madh rreth të cilit po ngroheshin disa ushtarë.

"Kush është aty?" bërtiti një roje tjetër.

"Një mik i Krishtërimit," u përgjigj Iskanderi.

"Bota?"

Iskanderi hezitoi.

"Bota ose unë do ta flakurij këtë," bërtiti roja, duke tërhequr shtizën në hark.

"Ura e Budës" u përgjigj menjëherë roja i rrëmbyer poshtë peliçes dhe sipër shpinës së Iskanderit, pasi ky i fundit e shkundi fort atë.

"Pse nuk u përgjigjët menjëherë?" bërtiti njëri prej rojeve.

"Pse talleni me ne, duke ndryshuar zërin?" bërtiti një tjetër. "Eja pra të shkojmë dhe mos bëni më shakara të tilla."

Iskanderi eci nëpërmjet të një korridori të krijuar prej çadrash në disa prej të cilave kishte dritë por krejt të heshtura. Më në fund, ai takoi shqytarin e një kalorësi polak i cili po kthehej nga një takim gazmor.

"Kush jeni ju?" pyeti Iskanderi.

“Jam një shqytar,” u përgjigj zotëria.

“Nuk dyshoj se je një burrë mëndjemprehtë i cili dëshiron të luaji me fatin,” iu kthye Iskanderi. “Ju duhet ta dini se kanë ardhur kohëra të vështira dhe kanë ndodhur gjëra të rëndësishme. Për t’i shërbyer këtyre kohërave, unë kam marrë peng një njeri i cili mbart sekrete shumë të mëdha për t’i ndarë me Lordin Huniadi. Po e mbaj atje, tek shatorrja e tij edhe pse tani ai është një barbar i egër dhe thuajse i tepërt për mua. Më ndihmo që ta çojmë tek shatorrja e Huniadit dhe ju do të merrni tëra shpërblimet dhe gjysmën e famës.

“Po flisni si një njeri shumë i mësuar djalosh dhe më duket sikur e njoh zërin tuaj. Nëse nuk gabohem ju quheni Leckinski,” iu kthye atij shqytari.

“Një i afërt i tij jam. Kemi një stërgjysh të përbashkët.”

“Kështu mendova edhe unë. I njoh ata Leckinskët përherë që prej zërit të tyre. Unë kam të drejtën t’ju ndihmoj me kushtet që përmendëm – tëra shpërblimet dhe gjysmën e famës. Është një barbar i egër më thatë, apo jo? Ne nuk mund ta presim në qafë nëse ai nuk do të tregojë. Tëra shpërblimet dhe gjysmën e famës!? Urra! Nesër do të jem kalorës. Hmmm, po pse më duket pak si një peshk që lëshon erë kjo punë?!”

Shqytari e kapi të rrëmbyerin për zverku i cili do të kishte folur po të mos ishte tmerruar prej kërcënimeve të Iskanderit i cili, duke e mbajtur rojen për këmbësh, e la zotërinë polak t’i printe drejt shatorres së Hunaidit. Ata arritën shpejt atje dhe Iskanderi, pasi e lëshoi barrën që kishte në qafë e la të rrëmbyerin vetëm në ngarkim të shqytarit dhe hyri në shatorren e Gjeneralit të Hungarezëve.

Një oficer e ndaloi atë në një korridor të shkurtër pak para se të hynte në apartament dhe kërkoi të dinte qëllimin e vizitës së tij. Ai i përsëriti dëshirën e tij për ta parë udhëheqësin hungarez pa humbur kohë për arësye shumë të forta. Oficeri hezitoi, por pasi thirri disa roje tjera, e la Iskanderin nën mbikqyrjen e tyre. Pastaj hapi nga prapa një perde, dhe u zhduk. Iskanderi dëgjoi zëra, por nuk kuptonte dot asnjë fjalë. Oficeri u kthye shpejt dhe pasi i urdhëroi gardianët që ta kontrollonin dhe ta çarmatosnin Iskanderin e drejtoi tek një portë tjetër.

Iskanderi dhe shoqëruesi i tij hynë në një apartament të një madhësie të konsiderueshme. Muret ishin plot me lëkura të varuara. Një variete parzmoresh dhe rrobash ishin lëshuar kapicë mbi një kolltuk. Një burrë i moshës së mesme, me një pamje madhështore, i mbështjellur në një peliçe prej gëzofi, me flokë të gjata ngjyrë gështenje dhe një kapele kadifeje ngjyrë të kuqe hermeline, endej poshtë e lart asaj dhome duke i diktuar disa instruksione një personi tjetër i cili ishte ulur në gjunjë në dysheme dhe merrte shënim. Ai shkruante nën ndriçimin e flakëve të një llampe prej brazeni. Valvitjet e flakëve të llampës ndriçuan plotësisht fytyrën e sekretarit. Iskanderi vuri re se aty gjëndej edhe një zonjushe shumë e bukur.

Ajo i ngriti sytë sapo pa që hyri Iskanderi. Vështrimi i syve të saj të zinj, të mëdhenj dhe shndritës si dy flakadanë e përshkoi atë tej për tej deri thellë në shpirt. Flokët korb të zeza të derdhura përmbi shpatulla zbrisnin në të dya anët e faqeve të saj. Ato ishin zbukuruar me fije të arta të gërshetuara dhe xhevahire të shumta. Një gërshetë e thurur bukur prej lëkure dhelpre të bardhë rrethonte si me kurorë ballin e saj të bardhë. Tiparet e fytyrës ishin të imta por të formuara thellë dhe një nuancë delikate i jepte gjallëri faqeve të saj të pastra si qiriri. Ajo i hodhi një vështrim të mprehtë Iskanderit, sapo ai dha ballë me atë pamje që ngjallte më shumë kureshje sesa bezdi, në atë orë të vonë të natës.

Huniadi ndaloi dhe e pa vizitorin e tij me një sy zhbirues.

“Që nga vini ju?” pyeti prijësi i hungarezëve.

“Nga kampi turk!” u përgjigj Iskanderi.

“A jeni i dërguar apo dezertor?”

“Asnjëri as tjetri”

“Po atherë?”

“I shndërruar.”

“Emri juaj?”

“Lordi Huniad,” iu kthye Iskanderit. “Kjo që do të them duhet të dëgjohet dhe vlen vetëm për veshët tuaj. Jam i pa armatosur. Megjithatë jam i vetmi kalorës i krishtërimit që vështirë se mund të frikësohet. Unë jam një njeri njësoj si juve, që në lindje, por tani edhe në rang ushtarak: Nëse jo për nga fama, për nga detyra po se po. Koha ime është shumë e vyer. Unë mund të qëndroj këtu vetëm aq kohë sa kali im të mbushet me frymë. Largoje agjutantin tënd që këtej!”

Huniadi i hodhi një vështrim vizitorit të tij i cili do të hutonte çdo mendje të kësaj botë me praninë e tij në ato rrethana. Iskanderi i qëndroi vështrimit xhbirues, i qetë dhe i pashqetësuar.

“Stanislav, ikë që këtej,” i tha Vojvoda oficerit. “Zotëri, kjo zonjë është bija ime dhe prej saj unë nuk mbaj sekrete.”

Iskanderi u përkul lehtë sapo oficeri doli që aty.

“Dhe tani, le të bisedojmë! Çfarë propozimi keni sjellur?” iu kthye ai Iskanderit.

“Unë jam një Princ epirot i detyruar të luftoj për muslimanët. Me një fjalë, qëllimi i ardhjes time këtu është të bëjmë një plan prej të cilit ne të dy mund të fitojmë, në të njejtën kohë: Ju triumfin, ndërsa unë lirinë e vendit tim.”

“Atherë, më trego, me ke kam nderin të flas?” pyeti Huniadi.

“I Madhi Huniad, emri im ndoshta është krejtësisht i panjohur për ju: Ata më thërrasin Iskander.”

“Çfarë? i shqeu syte Huniadi. “Krahu i djathtë i Muratit, pushtuesi i Caramanias, lulja e kavalerisë turke qenka këtu? A është e vërtetë se kam përpara luftëtarin e pakrahasueshëm të kohës tonë?” shpërtheu Huniadi duke ia marrë dorën musafirit të tij. Ai xhveshi shpatën e vet dhe ia zgjati Princit.

“Iduna” iu kthye Huniadi, vajzës së tij, “më në fund ju po e shihni vetë me sytë tuaj Iskanderin.”

“Jam shumë e gëzuar, zotëri,” u përgjigj Iduna, “nëqoftëse me të vërtetë ju kuptova, ne mund ta quajmë Princin Iskander si Kampionin e Kryqit.”

Iskanderi nxori nga gjoksi kryqin prej floriri dhe e puthi përpara saj.

“Ky ka qenë ngushëllimi dhe shpresa ime në vitet e mia të vështira, zonjushe,” tha Iskanderi.

“Ju ndoshta, e dini historinë time të dhimbshme, Lordi Huniad! Deri më sot, sovrani im i imponuar nuk më ka kërkuar që të xhvesh kordhën kundër vëllezërve të mi të krishterë. Por ajo orë më në fund ka rënë dhe ai më së fundmi ka vendosur që unë të zbatoj një linjë drejtimi që ai e ka menduar shumë gjatë. Karam Beu, i cili i di mirë nevojat tuaja, do t’ju sulmojë sapo ju të filloni tërheqjen. Unë do të komandoj krahun e majtë të trupave. Përkundër fuqisë superiore dhe pozicionit, mblidhuni në një dhe luftoni me besim. Unë planifikoj që në një moment të përshtatshëm të ditës, të tërheq trupat dhe me epirotët e mi të nxitojmë drejt vendit tim të lindjes dhe menjëherë të ngre flamurin e pavarësisë. Është një veprim shumë i rrezikshëm, por a nuk është vetë suksesi pjellë e guximit? Neve na duhet të ndihmojmë njëri tjetrin me mënyra të ndërsjellta. I vetëm, është e kotë të filloj një luftë e cila, me gjithë përparësitë aventureske, do të kërkojë përpjekje të jashtëzakonëshme dhe shfrytëzim të energjive, shumë mjeshtri durim pa fund. Por nëse Ju dhe mbreti Vladislav e mundni ushtrinë e Muratit në Bullgari, unë nuk jam pa shpresë se do të shkojmë drejt suksesit

përfundimtar. Mua më duhet të frymëzoj tëra ndjenjat më të pastra të humanizmit dhe të luftoj në të njejtën kohë, për vendin tim, për Zotin tim, dhe për kurorën time legjitime.

"Princ i guximshëm! Po të lëshoj në dorë besnikërinë time," i tha Huniadi Iskanderit, duke lëvizur përpara drejt tij dhe duke i marrë dorën. Më pas vazhdoi:

"Dhe derisa Iskanderi dhe Huniadi të kenë jetë, ata kurrë nuk do të pushojnë së luftuari bashkë deri sa të arrijnë qëllimet e tyre të larta dhe të shenjta."

"Ky është një betim solemn," tha Iskanderi, "edhe më i shenjtë sesa po të ishte shkruar në kodikët e Krishtërimit. Lady Iduna, lutjet tuaja!"

"Ato shkrime bëhen përherë për atletët e Krishtit," u përgjigj vajza e Huniadit. Pastaj u ngrit dhe pelerina e gjatë në të cilën ajo ishte mbështjellur mori një formë të shtrirë dhe madhështore."

"Iskander fisnik, kjo tespihe vjen nga *Sepulchra e Shenjtw*," i tha atij Iduna, "mbaje për hatrin dhe kujtimin e mbrojtësit tonë të bekuar i cili e dha jetën për të larë mëkatet tona."

"Iskanderi e mori tespihen, preku si pa dashje dorën delikate të vajzës, puthi me buzë të gjitha rruazat dhe i vari rreth qafës."

"Huniadi i Madh," iu drejtua Princi, "më duhet të kapërcej malet përpara se të zbardhë dita. Më ler të sprovoj se kampi i krishterë është në tërheqje."

"Le të jetë edhe kështu," tha hungarezi, pasi u mendua pak. "Dhe le të shpresojmë se dielli i së nesërmes do na sjelle ditë më të shndritshme."

Me këto fjalë mbaroi vizita e shkurtër dhe e jashtëzakonëshme i Iskanderit tek gjenerali i krishterë.

Kapitulli 5
Ndarja e Iskanderit nga ushtria e Sulltan Muratit.

Informatat e fshehta mbi shpërbërjen e kampit dhe tërheqjes së ushtrisë së krishterë arritën shpejt tek Divani i Karam Beut. Ai e thirri Iskanderin menjëherë që të konsultohej me të mbi veprimet që do të ndërmerreshin. Prijësit u pajtuan se ndjekja e menjëherëshme ishte e domosdoshme dhe se shumë shpejt Mali i Hemusit të egër do të lëshohej nga armiku dhe se mizëria e egër e kavalerisë së lehtë, e cila ishte ndoshta pjesë edhe më fatale e fuqisë ushtarake turke sesa vetë jeniçerët e famshëm, do të sulmonin pa mëshirë. Ata do të rrinin të gatshëm në prapavijën e tërheqjes së të krishterëve, me armët gati për t'i kapur në befasi.

Në fakt ishte e pamundur t'i bëhej rezistencë levizjes së tyre të papritur. Shpresa ishte tek një mësymje dërmuese. Më në fund, të lodhur prej sulmeve të përsëritura, Huniadi, i shoqëruar prej disa kalorësve të zgjedhur, e ujdisi punën e vet që nga prapavija, i dha urdhër ushtrisë të ndalonte dhe të bëhej gati për luftim.

Ndjekësit papritmas u tërhoqën deri tek një distancë duke duke u rrjeshtuar gradualisht në dy divizione. Ata pritën mbërritjen e ushtrisë turke që kishte përparuar. Muslimanët lëvizën përpara nën marshin e tyre të frikshëm luftarak duke treguar guxim të pashembullt, të frymëzuar prej triumfit që shpresonin se i priste. Nuk pritën veç pak deri sa u lëshuan pa mëshirë. Në të shquhej shumë mirë Iskanderi i ngjeshur me parzmore dhe i mbështjellur në jelekun e tij të kuq mbi gjokun e zi, duke shpalosur kordhën që i vezullonte në ajër.

Jeniçerët mësynë duke bërtitur me klithma të tmerrshme në emër të Allahut dhe Pejgamberit Alejhi Selam. Kalorësit e krishterë që betoheshin në shenjtët e tyre i panë turqit që po ju afroheshin deri tek maja e heshtës. Një shigjetë ishte shpërdredhur atë mëngjes. Një kalorës guximtar dhe një kalë i sprovuar ngritën pluhurin e asaj fushe duke u turrur mbi armiqët e panumërt. Ngado shiheshin topat dhe shigjetat që fishkëllenin në ajër. Nganjëherë një sokëllimë e vetmuar dëgjohej midis vringëllimave të përgjithshme e cila njoftonte për viktimën tjetër të rradhës.

Huniadi, ndërkohë që i shfaqte të gjitha tiparet e një luftëtari të sprovuar, shihte jo pa ankth pozicionet e trupave turke. Që këtej, parë nga natyra e vendosjes, të dy ushtritë kishin hyrë në luftë kundra njëra tjetrës bazuar në udhëzimet e të njejtit strateg: Iskanderit. Kur beteja në dy anët po bëhej edhe më e tmerrshme**,** u pa mirë se së shpejti forcat kryesore të dy ushtrive do të përplaseshin. Në këtë moment, Huniadi, me një pasiguri të tmerrshme, shqeu sytë duke parë nëse Iskanderi ishte i aftë dhe madje i vendosur që të ekzekutonte planin e premtuar. Me apo pa përmbushjen e këtij premtimi, ai e dinte mirë se kjo ishte ditë vendimtare për fatin e Kryqit.

Në ndërkohë Iskanderi ndiqte rrjedhën e ngjarjeve jo me më pak padurim se Huniadi. Karam Beu tashmë kishte urdhëruar më shumë se një herë që epirotët të futeshin në betejë, por edhe pse kaloi mëse një orë që nga koha kur u dha urdhëri, ata nuk i ndryshuan pozicionet e tyre. Më në fund, krejt i habitur, por ende i pa zemëruar, komandanti turk dërgoi shefin e sekretarisë së tij Musën vetë, që t'i kërkonte bashkëluftëtarit të tij shpjegime në lidhje me rrjedhën e betejës. Musa e gjeti Iskanderin të rrethuar nga disa prej fisnikëve epirotë më të zot'të, të gjithë hypur mbi kuaj, tek qëndronin të qetë nën hijen e një peme shumë të madhe. Kryeshefi i sekretarëve të Karam Beut ishte një oborrtar me shumë përvojë dhe një mjeshtër i vërtetë i komunikimit. Prandaj ai u paraqit sikur kishte shkuar më shumë për të marrë ndonjë këshillë sesa të përcillte ndonjë qortim për situatën e krijuar.

"Komandanti yt është një burrë i zgjuar, Musë!" iu përgjigj Iskanderi. "Por dhe Karam Beu mund të bëjë gabime. Ai mendon se një betejë nuk fitohet duke u shulla në

hijen e një peme. Unë ndryshoj prej tij, dhe madje mendoj se ne do të fitojmë edhe kështu sepse ka ardhur koha që luftën ta bëjme ndryshe. Më pëlqen e qeshura jote. Ajo është inkurajuese."

"Gjergj, Dhimitër, bëni menjëherë detyran tuaj!" Urdhëroi Iskanderi.

Me të thënë këtë, dy prej epirotëve më të fuqishëm, u sulen drejt sekretarit të gjorë, e kapën, e përkulën dhe e flakurisën mbi shalën e një kali.

"Tani, kushdo që e do vendin e vet të vijë pas meje!" thirri Iskanderi.

Pasi i tha këto, në krye të pesë mijë burrave, ai e la fushë betejën dhe me hapa shumë të shpejtë u nis për në Krujë, në kryqytetin e vendit të tij.

Kapitulli 6
Iskanderi drejt Atdheut, drejt Krujës.

Me një gëzim të jashtëzakonshëm, Iskanderi dhe kavaleria e tij rendën nëpër fushat e Rumelisë pa ndaluar asnjëherë, përveç rasteve të shkurtëra dhe ndërprerjeve për pushim sa për të marrë veten, derisa arritën në malet që kufizoheshin me Epirin, rreth pesëdhjetë kilometra larg nga kryeqyteti i tij, Kruja. Në mbrëmjen e hyrjes në mbretërinë e babait të tij, Iskanderi urdhëroi rojet të përgatisnin fermanin që do ta nënshkruante sekretari i Karam Beut, Musa, i cili gjëndej i lemerisur nga frika, meraku dhe dëshpërimi. Ai ishte vënë të ecte me pararojën.

"Qetësohu Musa i vyer!" i tha Iskanderi, duke e shtrirë sa gjërë e gjatë mbi një lëndinë me bar të gjelbërt. "Patëm një kalërim të shpejtë, por nuk dyshoj se së shpejti do ta marrim veten, me emër të zotit, dhe do jemi aty ku duhet të jemi. Është një qytet të cilin e quajnë Krujë, në të cilin një herë e një kohë, siç thonë legjendat, djalit të babait tim nuk do t'i duhej të kërkonte leje për të hyrë aty. S'ka gjë. Unë mendoj, Musa i vyer, se ju jeni i vetmi njeri që mund të nënshkruani emrin e tij. Eja tani, më shkruaj një ferman të nënshkruar prej Karam Beut për guvernatorin e qytetit që të thashë, për t'ja dorëzuar kampionit të guximshëm të Gjysëm Hënës, Iskanderit, dhe do të kalërosh në të ardhmen me një trok më të rëndë sesa thjesht të një sekretari."

Musa i vyer u përkul deri në tokë, lexoi materialet e shkruara që ia vunë përpara, nënshkruajti fermanin e kërkuar dhe ja dha në dorë Iskanderit. Ky i fundit, pasi u sigurua për nënshkrimin, e futi letrën nën sqetull.

"Do të nisem menjëherë drejt Krujës, me disa miq," tha Iskanderi. "A dëshironi ju bashkëluftëtarët e mi trima të më shoqëroni në këtë vigjilje feste të madhe por të vini nga drejtime të ndryshme? Më rënjen e natës së dytë mblidhemi në heshtje përpara portave të Krujës. Si thoni?

Me këtë fjalim, Iskanderi iu kishte bërë thirrje kalorësve të rinj të sapoardhur që ta shoqëronin. Me treqint kalorës, ai i la lamtumirën për një kohë të shkurtër trupave të tij për të kapërcyer me shpejtësi malet dhe rendur nëpër fushat pjellore të Epirit.

Kur ra dielli i mëngjesit, Iskanderi dhe bashkëudhëtarët e tij vunë re mu në fund tek një rrëzë mali një qytet shumë të bukur që shkëlqente nën rrezet e diellit që zbrisnin nga majat që i rrinin sipër si kurorë. Qyteti ishte i rrethuar me mure mbi të cilat ngriheshin kulla të larta dhe kishte një pamje madhështore. Prapa tij ngrihej një vargmal i purpurt dhe shumë piktoresk me majat të valëzuara, të zbardhura nga dëbora. Aty gjëndej një liqen i mrekullueshëm, i shtrirë si një çarçaf ngjyrë argjendi, në njërën anë të qytetit prej nga pulabardhat ngriheshin herë pas here. Gjelbërimin e pamasë, aty këtu, e thyenin shtëpitë e bardha.

"Ja tek është Kruja!" thirri Iskanderi. "Baballarët tanë të moçëm e zgjodhën këtë vend si truallin e vet, miqtë e mi! Ne do të jemi ata që do të tregojmë nëse ata i zgjodhën këto vise për të huajt apo për në, brezat e vet pasardhës."

Pas këtyre fjalëve, ai i ra mamuzeve të kalit dhe me zemrën që i gulçonte dhe fytyrën që i qeshte, Iskanderi dhe ata që e shoqëronin, do të arrinin shpejt në rrethinat e qytetit.

Qyteti ishte i mbështetur në një shpat mali poshtë të cilit kishte fusha pjellore të mbjella me drithëra dhe i veshur me ullinj dhe pemë frutore. Rruga që të çonte atje ishte me kthesa dhe kalonte thuajse krejt nën hijet e degëve të drurëve që vareshin gjatë tërë shtrirjes së saj. Zërat e cicërimave shpërndaheshin gjthandej. Ishte një mëngjes i freskët dhe i gëzuar. Iskanderi shkëputi një degë ulliri, e mbështolli rreth kokës dhe pasi hodhi një sy rreth e rreth me një qeshje shend e verë tha:

"Të dashur miq, le t'i mbledhim ne korrat e para!"

Njësoj si ai, të gjithë vunë mbi kokë nga një degë ulliri mbi kokë dhe e ndoqën udhëheqësin e tyre.

Ata arritën tek porta e qytetit e cila ruhej nga një garnizon i fuqishëm. Iskanderi, i shoqëruar prej grupi të tij më të afërt, të tij u ngjit me hap të shpejtë drejt kështjellës. Sapo zbriti nga kali, ai menjëherë shkoi tek divani i guvernatorit. Ky i fundit ishte një pasha i vjetër i cili e priti pushtuesin e Caramanias me tërë respektin që meritonte një kampion aq i shkëlqyer i Gjysmë Hënës.

Pasi shkëmbyen fjalët e zakonëshme siç e donte ai rast, Iskanderi duke ruajtur atmosferën e mirësjelljes ia vuri atij përpara fermanin për dorëzimin e kështjellës. Guvernatori plak, pa shfaqur ndonjë dyshim, ia dorëzoi çelësat Iskanderit dhe kërkoi leje që ta linte menjëherë vendin e komandës të cilin e kishte mbajtur deri tani.

Sapo ai dhe suvaria e tij dolën nga kështjella. Iskanderi bëri një shëtitje nëpër kështjellë. Në mbrëmje ai inspektoi garnizonin turk në sheshin e madh. Meqenëse ish-guvernatori ishte në një ankth të madh se si do të ikte nga Kruja aq papritmas, Iskanderi urdhëroi që një pjesë e konsiderueshme e garnizonit ta shoqëronte atë si një roje nderi dhe e la të qëndronte aty edhe një ditë. Pjesën tjetër ai e shpërndau në disa banesa ndërsa portat i vendosi nën ruajtjen e bashkëshoqëruesve të tij.

Në mesnatë epirotët, të gatshëm për të zbatuar urdhërat e të sapo-ardhurve u bashkuan poshtë mureve të kështjellës dhe pasi shkëmbyen sinjalet për të cilët ishin marrë vesh, i hapën portat. Një turmë e madhe marshoi menjëherë për ta siguruar kështjellën. Pjesa tjetër e udhëhequr nga prijësit e emëruar i rrethuan turqit kudo që ndodheshin. Kështu krejt papritmas, në mesnatë, në atë qytet të madh, u bë një zhurmë aq e frikëshme sa që njerëzit u zgjuan të tmerruar prej gjumit dhe filluan të shikonin të stepur çfarë po ndodhte. Menjëherë çdo tarracë shtëpie shndriti prej flakëve të pishtarëve dhe nata u bë ditë. Trupat e armatosura u lëshuan poshtë nëpër rrugë, duke vringëlluar kordhat dhe jataganët dhe duke bërtitur: “Kryqi, Kryqi! “ Liri! Liri! “Iskander, Iskander! Epir, Epir!”

Qytetarët i njohën bashkëpatriotët e tyre nga gjuha që flisnin dhe rrobat që kishin veshur. Emri i Iskanderit u përhap në qytet me shpejtësinë e zërit. Pyetjet, si ndodhi, nuk kishin të mbaruar. Një ndjenjë hyjnore i bindi ata menjëherë se ky burrë i madh, me vullnetin e zotit, ishte rikthyer në vendin e etërve dhe të fesë së tij.

Kështu çdo banor i qytetit, duke rrembyer armën më të afërt që gjeti, me një shpirt patriotik të eksituar u shpraz në rrugë duke bërtitur: “Kryqi, Kryqi!” “Liri, Liri!” “Iskanderi dhe Epiri!” Madje edhe gratë e flakën tej ndrojtjen femërore dhe shpalosën në vend të butësisë së gjinisë impulsin e zotërve të tyre. Ato rrëmbyen armët, kapën pishtarët në dorë dhe shpërthyen në betime, lutje dhe mallkime. Fëmijët të kapur pas fustanave të nënave përsërisnin me entusiazëm fraza të cilat i dëgjonin por ndoshta nuk i kuptonin.

Turqit luftuan deri diku mirë, por pastaj e kuptuan se ishin viktimat e kësaj ngjarje. Grupe të vogla dhe të izoluara ushtarësh u masakruan me armë të ftohta. Kështjella ishte fortifikuar me topa, por pjesa më e madhe e ushtarëve besonte më shumë tek forca e shpatave të ndryshkura dhe shtizave të shtrembëruara. Forca kryesore e garnizonit turk ishte strehuar në një pallat të vjetër të Kryepeshkopatës, e cila gjëndej në mes të qytetit, në një terren pak të pjerrët dhe të hapur. Ajo ishte një ndërtesë shumë e madhe e ndërtuar me gur të thjeshtë mali.

Këtu turqit u mbrojtën me çdo mjet derisa u dorëzuan edhe pse i përdorën harqet me efekt të tmerrshëm. Pjesa tjetër e qytetit tani ishte e sigurtë pasi ishte marrë në zotërim nga Iskanderi. Epirotët kishin arritur të merrnin me forcë hyrjen kryesore të pallatit. Porta e madhe mbrohej ndaj sulmeve të epirotëve prej turqve të cilët u detyruan më në fund të tërhiqeshin në një farë largësie.

Iskanderi urdhëroi të sillnin dy bateri me topa të cilët do të qëllonin nga poshtë lart në derën e kështjellës.

Në ndërkohë, ai urdhëroi të sillnin vandakë shumë të mëdhenj me rrfata që t'i ndeznin përpara ndërtesës. Tymi që shkaktoi djegia e tyre i pengoi të rrethuarit që të merrnin në shenjë. Hovi i njerëzve ishte i papërmbajtshëm. Përdorimi i topave e dha menjëherë efektin. Porta e madhe u shkund dhe u deshën vetëm disa goditje prej asaj arme shkatërrimtare që porta të shëmbej. Edhe ajo ra. Turqit që u lejuan të dilnin, ranë nën breshëritë e goditjeve. Më pas dëgjoheshin vetëm klithmat e tyre të agonisë. Disa guxuan të hidheshin nga dritarët**,** por edhe atje i prisnin ose majat e shigjetave ose të thikave. Disa u panë mbi çatinë e tarracave tek zgjatnin duart përpjetë në dëshpërim. Papritmas u njoftua se pallatit iu vu flaka. Një tym i bardhë në blu u shndërrua në një re të madhe dhe fill pas, sikur me magji, e tërë pjesa e pasme e ndërtesës u përthekua prej gjuhëve të zgjatura të flakëve të kuqe që u ngritën deri në qiell.

Në mes të ulurimave, bërtimave, klithmave, lutjeve dhe mallkimeve, çatia e pallatit ra. Pas kësaj pasoi një heshtje e tmerrshme si vdekja. Por menjëherë vendasit filluan të lëviznin dhe të mendonin për jetën e re që i priste në liri, e cila kishte lindur papritmas mbi ato gërmadha dhe shkatërrime.

Kapitulli 7
Iskanderi në Epirin e Lirë.
Iduna Huniadi e marrë peng në Adrianopojë.

Me të zbardhur agimi, Iskanderi dërgoi korrjerë anë e mbanë Epirit për të dhënë lajmin për marrjen e Krujës dhe ngritjen e flamurit të pavarësisë në qytetin e tij të lashtë. Po ashtu ai dërgoi edhe një korrier të besuar tek Huniadi i madh dhe një tek Princi Nikeas i Athinës. Njerëzit në të gjithë Epirin ndjeheshin të gëzuar pa masë për këtë arritje kaq të madhe dhe krejt të paparashikuar saqë ende nuk guxonin ta besonin. Njëherësh, ata u ngritën në të gjithë vendin dhe i masakruan turqit, madje edhe në qytetet që ishin ende nën pushtimin e Muratit dhe të mbrojtura prej garnizoneve të fuqishme të ushtrisë së tij.

Iskanderi ishte në ankth dhe e ndjente se duhej t'i largonte këto garnizone pa humbur kohë, me qëllim që, nëse Murati do të dërgonte një fuqi të madhe ushtarake kundër tij, siç edhe e priste, ata të mos kishin mbështetje tjetër përveçse forcat e veta. Qëllimi i tij nuk mund dhe as duhej menduar se u arrit thjesht dhe vetëm nga ndikimi që kishte lajmi për ardhjen në Epir. Prandaj, sapo trupat e tij pushuan pak, u thirrën rekrutë të rinj të cilët mbushën radhët e ushtrisë. Ata me shpirtin dhe gatishmërinë që kishin për të shërbyer, deshën vetëm disa ditë që të mësoheshin. Iskanderi në krye të dymbëdhjetë mijë burrave u nis që nga Kruja dhe marshoi drejt qytetit të fuqishëm të Petrelës. Gjatë rrugës ai takoi mbeturinat e garnizonit të Krujës të cilët po iknin në rrugën e tyre drejt Turqisë të cilët u dorëzuan vetë, vullnetarisht, pa çak pa bam.

Petrela ishte vetëm një ditë rrugë larg nga Kruja. Kur Iskanderi arriti atje, kërkoi menjëherë takim me guvernatorin. Gjatë takimit me të, ai i tregoi atij tërë historinë e vet, mposhtjen e turqve nga Huniadi dhe pamundësinë e Muratit për t'i ardhur në ndihmë atij. Pasi dëgjoi këto, turku u pajtua ta dorëzonte qytetin dhe ta linte vendin me trupat sipas kushteve të diktuara prej Iskanderit. Dhe kështu prej një kombinimi fatlum të guximit me shkathtësinë, marshimi i Iskanderit nëpër Epir u kthye më shumë në një triumf sesa në një fushatë luftarake. Garnizonet turke pa përjashtim, duke imitiuar sjelljen e shokëve të tyre në Petrelë dhe duke parë fatin e shokëve të tyre në kryeqytet, bënë të njejtën gjë. Kështu në më pak se një muaj, Iskanderi i kthyer në Epir, e kishte çliruar vendin e tij nga zgjedha muslimane.

Deri në këtë kohë Iskanderi nuk kishte dëgjuar asgjë as për Huniadin dhe as për Nikean. Por sapo hyri brenda portës së qytetit mësoi me interes të madh se Princi i Athinës kishte arritur në Kruje në mbrëmjen e kaluar dhe se korrieri i tij ishte kthyer nga kampi hungarez. Midis brohoritjeve të njerëzve të gëzuar, Iskanderi u ngjit përsëri në Kalanë e Krujës. Nikeas e priste tek porta. Iskanderi i zbriti kalit dhe e përqafoi mikun e tij. Ata ecën dorë për dore të shoqëruar prej një turme njerëzish që brohorisnin.

"I dashur miku im," i tha Iskanderi, kur ata mbetën përsëri vetëm, "E sheh që ne kishim të drejtë të mos dëshpëroheshim? Nuk kanë kaluar as dy muaj që kur u ndamë pa asnjë perspektivë, ose me shpresat më të zymta, dhe tani ja ku jemi në një rrugë të pastruar për të arritur atë që duam: Epirin e lirë!"

"Unë erdha të marr pjesën time në çlirimin e tij," tha Nikeas, me një buzëqeshje, "por ti Iskander je një Cezar i Ri!"

"Nikeas, besomë mua, përsëri do të keni shumë raste tjera që të provoni patriotizmin dhe guximin tuaj," iu përgjigj Iskanderi. "Murati nuk do ta lejojë kurrë këtë që ndodhi të kalojë kaq qetësisht. Nuk e kam filluar këtë luftë pa e ditur se kjo do të kërkojë të gjitha energjitë dhe durimin e një jete të tërë. Shpërblimi im më i madh është tua lë trashëgimi lirinë bashkëatdhetarëve të mi. Sa i takon gjërave të tjera, e ndjej se i

kam thënë lamtumirë çdo gëzimi të kësaj jete përveç naltësimit të ndërgjegjshëm të asaj që do të kërkonte një detyrë fisnike si kjo.

Ndërkohë, shoh se një lajmës ka ardhur nga Huniadi i Madh dhe po më pret. Deri sa mburoja e Krishtërimit ballafaqohet me situata si kjo që kemi, mundësitë e një sigurie të plotë janë shumë të vogla. Me këtë diversion të përhershëm në Bullgari, ne duhet ta kuptojmë se na duhet të luftojmë shumë deri sa të arrijmë suksesin. Ju nganjëherë qeshni me gjakftohtësinë time, Nikeas. Të them të drejtën, unë jam i qetë dhe gjakftohtë pasi nuk kam qenë kurrë më i vetëdijshëm për fuqinë e kundërshtarit tim se sot, edhe pse për momentin e kam mundur atë. Dëgjo si brohorasin njerëzit! Unë i dua ata, Nikeas. Ata janë të dehur prej ndjenjave të larta, të vërteta dhe bujare. Ata brohorasin sikur e kanë fituar edhe një herë vendin e tyre. Mjerisht, ata dinë shumë pak nga ajo se çfarë mund të sjellë kjo për ta edhe në rastin më të mirë. Jo! Mos më shih me habi! Ne kemi bërë gjëra të mëdha dhe do të bëjmë edhe më shumë. Kush pret i vetëm atje? Dhimitri? Thirre lajmësin e ardhur nga Lordi Huniades."

Aty u paraqit një epirot që mbante një pako mëndafshi të cilën ia dorëzoi Iskanderit. Lajmësi e preku më mirësjellje dorën e prijësit të tij, pastaj e puthi të veten dhe u tërhoq. Iskanderi e hapi vulën dhe nxori prej aty një letër nga mbulesa e mëndafshtë.

"Kështu po! Kjo është mirë!" u shpreh Iskanderi plot gjallëri pasi i hodhi një sy të shpejtë letrës. "Siç shpresova dhe mendova, një fitore e plotë. Karam Beu vetë qenka zënë rob dhe është burgosur. Rrobat, flamujtë, armët e rënda, thesari… Ushtar i guximshëm i Kryqit!" Ai po pëshpëriste me veten dhe lexonte nëpër dhëmbë deri sa erdhi një moment kur ai u step.

"Po kjo, ç'farë qenka kjo?" kërceu Iskanderi, duke marrë një pamje të vërënjtur. Buza filloi t'i dridhej dhe sytë iu errësuan. Ai eci drejt një dritarje harkore. Shoku i tij, i cili mendohej se do të vazhdonte të lexonte, nuk e bezdisi atë.

"Ah, Huniad i varfër, Huniad i varfër!" bërtiti Iskanderi më në fund duke tundur kokën.

"Çfarë i ka ndodhur?" e pyeti me nxitim Nikeas.

"Gjeja më e keqe që mund të ndodhë në luftë!" u përgjigj Iskanderi. "Diçka që po ma merr frymën. Na duhet t'i harrojmë punët tona! Për një moment na duhet të harrojmë edhe ty, Epir! Nuk është patriot ai që nuk lufton për këtë gjë. Eh, kaq e re, kaq e bukur! Një dhuratë e zotit, kaq e vyer! Një heroinë! Kur e pashë në krah të babait të saj tek i ndante shqetësimet më të, tek i ndihmonte këshilltarët e tij, tek ia kumtonte gjërat e nevojshme, mendova se pashë një engjell tek i shërbente të atit, në atë dhomë"

"Ndalu, ndalo për hatër të Zotit, Iskander" shpërtheu Nikeas me një shqetësim krejt të lexueshëm. "Çfarë është e tëra kjo?" Ndoshta jo, me siguri që jo…nuk është Iduna, jo, nuk është Iduna!"

"Ajo është!"

"E vdekur?" bërtiti Nikeas, duke nxituar drejt shokut të tij dhe duke e kapur për krahu.

"Edhe më keq!"

"Zoti i Madh!" bërtiti Princi, thuajse me furi.

"Më trego, më trego për gjithçka! Kjo vonesë po ma bren trurin, Iskander. Ju nuk e dini se çfarë do të thotë emri i asaj vajze për mua. Ajo është i vetmi njeri i qënjes time, vetë bekimi dhe mbase farmaku i jetës time. Tregomë i dashur mik! Këtë ta kërkoj me ngulm. Ku është Iduna?"

"E marrë peng dhe e burgosur prej turqve," u përgjigj Iskanderi.

"Iduna, një e burgosur tek turqit? Kurrë nuk mund ta besoj këtë. Po përse i ngjeshim shpatat ne? Ku është kavaleria? Iduna, një e marrur peng prej turqve! Do të

jetë gënjeshtër! Nuk mund të ndodhë kjo! Iskander, unë qenkam frikacak, edhe ju! Të gjithë qenkemi frikacakë! E burgosur e turqve! Iduna! Çfarë, çfarë? Trendafili i Krishërimit qenka rrëmbyer prej qenëve me turban të Muratit? Lamtumirë Epir! Lamtumirë Athina ime klasike! Lamtumirë fushat e Greqisë dhe ëndërrat që i bëjnë ato më të shndritshmet! Dielli i tërë gëzimeve të mia dhe shpresa që kisha, paska perënduar, dhe paska perënduar përgjithmonë!"

Pas kësaj Nikeas i shkundi flokët, rrobat i vërviti për tokë dhe fytyrën e mbuloi me duart e tij.

Iskanderi eci nëpër dhomë me një hap të nxituar i zhytur në mendime. Pas disa minutash ai e vuri dorën mbi shpatullat e Princit të Athinës dhe u përpoq ta ngushëllonte atë.

"Kjo është punë e kotë, Iskander, është punë e kotë," i tha atij Nikeas. "Dua të vdes."

"Edhe nëse do të isha i dashuri i saj, në një situatë si kjo," iu përgjigj Iskanderi, "vështirë se do ta konsideroja lënjën menjëanë të detyrës time për lirinë e Epirit, veç nëse i kushtoja gjithçka të dashurës time në vend të atdheut."

"Hah!" bërtiti Nikeas, që atje nga dyshemeja ku ishte ulur me duart në kokë dhe e pyeti Iskanderin: "A e mendoni në ndonjëfarë mënyre mundësinë e shpëtimit të saj?"

"Nëse ajo jeton, duhet të jete në burgun e Sarajeve të Adrianopojës. Ju gjykoni po aq mirë sa edhe unë për atë që na pret nëse bëjmë një përpjekje të tillë. Kjo pa asnjë dyshim është një aventurë e vështirë, por edhe më e vështirë më duket që një gjë e tillë të shmanget nga një kalorës i krishterë." Iu përgjigj Iskanderi.

"Tek kuajt!" bërtiti Nikeas, "tek kuajt" – dhe përsëri, çfarë mund të bëjmë? Sikur të jetë në një vend tjetër dhe jo në kryeqytet do ta nxirnim që andej me forcë! Po në zemër të perandorisë?! Kjo është e pamundur. A ka ndonjë çmim me të cilin t'i paguajmë turqit që ta lirojnë? Principata ime do të mblidhte sado shumë të kërkojnë për ta liriar atë xhevahir."

"Kjo nuk është edhe aq gjë e zgjuar dhe sigurisht as edhe aq e lehtë," u përgjigj Iskanderi, "pasi shpërblimi nuk do të kishte asnjë vlerë. Huniadi iu ka ofruar t'i shkëmbejnë me Karam Beun, tërë të burgosurit e rangut të tij, dhe shefat e trofeve, por Murati ka refuzuar as të dëgjojë për çfarëdo kushti që i ofrohet. E vërteta qenka se Iduna ka rënë në sytë e djalit të tij, Mahomedit të ri."

"Shën Maria Virgjëreshë! A nuk keni mëshirë për këtë vajzë të krishterë?" u shpreh Nikeas. "Mahomedi i ri! A duhet që ky i pabesë i shthurur...? Ah! Iskander i dashur! I dashur Iskander! Ju jeni kaq i zgjuar dhe kaq i guximshëm, ju që keni zgjidhur çdo gjë dhe guxuar të bëni çdo gjë! Më ndihmo, më ndihmo! Të bie në gjunjë. Të përgjërohem! Merre ti në dorë këtë çështje për të provuar shtypjen e urryer si dhe për hatër të tërë atyre që ju doni dhe nderoni, për besimin tuaj, për vendin tuaj dhe ndoshta edhe miqtë tuaj. Bëje gjeninë tënde të madhe një engjell fluturues të nxitojë për të shpëtuar Idunën e embël. Shpëtoje atë, të lutem, shpëtoje!"

"Mendime si këto po më përshkonin mëndjen kur fola në fillim," u përgjigj Iskanderi. "Do të gjejmë mënyrën më të mirë që i shkon më shumë lotëve të Princeshës sesa lakmive të djaloshit turk. Eja Nikeas, ne duhet të luftojme me Fatin**,** por që ta bëjmë këtë duhet të jemi të vendosur ndaj tij siç është vetë Fati i vendosur ndaj nesh!"

Kapitull 8
Iskanderi "Doktor Armen" drejt Adrianopojës, për të shpëtuar Idunën.

Menjëherë pas kësaj bisede të Nikeas, Iskanderi thirri disa prej komandantëve kryesorë të Krujës në kështjellë. Ai iu parashtroi atyre disa prej rregullave për administrimin e Epirit dhe i njoftoi për domosdoshmërinë e largimit të tij të menjëhershëm për një kohë të shkurtër. Po atë mbrëmje, sapo doli hëna, së bashku me Princin e Athinës e la qytetin dhe u nis për në Adrianopojë. Të dy udhëtuan me shpejtësi të madhe derisa arritën në një qytet afër kufirit. Aty kaluan një ditë dhe shetitën nëpër pazar. Iskanderi bleu për vete rrobat e një doktori armen. Ai ndryshoi aq shumë sa i veshur me rroba të zeza, me kapelen e rrumbullakët prej leshi të zi në kokë, me fytyrën dhe duart me njolla dhe me mjekër dhe mustaqe të rruara, ishte e pamundur që të njihej. Nikeas, si shoqëruesi i tij, u vesh me një rrobe të trashë me ngjyrë të kuqe, e cila i shkonte shume pas trupit, me një kapele të kuqe në kokë me një xhufkë të gjatë ngjyrë blu sipër saj. Ai mbante një çantë të madhe plot me ilaçe, disa instrumenta kirurgjikë dhe ca libra. Me këtë paraqitje tebdil, sapo portat e atij qyteti u hapën, Iskanderi hipur në një çili të vogël dhe Nikeas në një gomar të madh, nisën udhëtimin nëpër malet e Ballkanit, aty ku ndahet Epiri nga Rumelia.

"Kam përballuar furtunën e luftëtarit më të aftë në tërë Azinë kur për të parën herë iu ngjita këtyre maleve," tha Iskanderi dhe vazhdoi: "Shpresoj që udhëtimi i sotëm të mbyllet me sukses."

"Besomë! Them se unë jam më i pranueshmi prej ne të dyve," tha Nikeas. "Megjithatë, unë shpresoj se ne nuk do të kthehemi me duar bosh."

"Si erdhëm deri këtu, Nekeas?" i tha Iskanderi. "Ju kurrë nuk ma keni përmendur emrin e Idunës kur ishim në Athinë? Unë kurrë nuk do ta mendoja këtë kur i bëra atë vizitë të papritur dhe të shpejtë Huniadit. Ajo është një vajzë me cilësi të rralla."

"Kur ishim në kamp unë e dija që ajo ekzistonte, po aq pak sa edhe ju," u përgjigj Princi. "Ndërsa për gjërat tjera, e vërteta është Iskander se janë disa shkëmbime të shkurtëra në dashurinë tonë, të cilat shpresoj se koha do tu japë formën e duhur." Pasi i tha këto, Nikeas ia hypi gomarit dhe i gjuajti me shkop një zogu që po qëndronte në një degë të një peme. Iskanderi nuk e vazhdoi atë bisedë të cilën shoku i tij dukej se nuk kishte qejf ta dëgjonte. Udhëtimi i tyre ishte i lodhshëm. Aty rreth mbrëmjes ata arritën në krye të rrugës së zakonëshme dhe me që zbritja ishte më e vështirë, atyre ju desh të pushonin deri sa do të zbardhte drita.

Në mëngjes iu shfaq një pamje magjepsëse e fushave të pasura të Rumelisë dhe diku larg qyteti i madh i Adrianopojës. Kupolat dhe minaretë po i lante me dritën e vet dielli i atij mëngjesi. Pamja e shkëlqyer me njëherë ua ringjalli tëra forcat. U duk se çasti i rrezikut ose edhe i fatit kishte ardhur. Ata iu zbritën kafshëve si dy njerëz të lodhur dhe u paraqitën tek porta e qytetit. Lehtësia e madhe që kishte Iskanderi, si njohjës shumë i mirë i atij vendi, karakterit turk, rregullave të përdorura në hyrje, nuk ishte njësoj edhe për Nikeas-in, i cili shfaqte dyshime, nervozizëm dhe padurim. Më së pari ata ujdisën një vend fjetje në një bujtinë me emër në lagjen me pallatet më të mira të qytetit. Pastaj pasi secili zuri dhomën e vet, doktori armen i ndjekur prej mikut të tij

vizituan disa prej kafeneve të lagjes, duke njoftuar në të njejtën kohë arritjen e tyre, profesionin dhe aftësitë që zotëronin.

Pasi e tatoi pulsin e qytetit, Iskanderi shqyrtoi gjuhët që fliteshin dhe shpërndau ilaçet dhe recetat. Ai dëgjoi me interes dhe habi bisedat në të cilat ai shpesh ishte vetë heroi. Ai mësoi se turqit ende nuk e kishin marrë veten prej shtangies që ju kishte shkaktuar guximi dhe suksesi që ai vetë kishte korrur. Ata ende nuk besonin të ishte vërtetë e mundur dhe dukej se ishin më shumë të habitur sesa të zemëruar. Politikanët e kafeneve, kryesisht jeniçerët, ishin më të zëshëm në pëshpërimat e tyre. Popullariteti i Muratit ishte zbehur përpara triumfit të Huniadit dhe *naltësimit* të Iskanderit.

"Por Allahu në shumë raste i ka ndihmuar besnikët e vet," vinte re Iskanderi në biseda me ta. "Unë dëgjova gjatë udhëtimeve të mia se ju keni kapur një Princeshë tepër të rëndësishme të kaurrëve."

"Zoti është i madh!" tha një turk i vjetër me mjekër të gjatë e të zbardhur. "Hekimi (doktori) i përgëzon besimtarët që kanë rrëmbyer një grua."

"Jo kaq thjeshtë," u përgjigj Iskanderi, "dëgjova se ajo gruaja ishte një Princeshë. Nëse është kështu, njerëzit e Frangistanit duhet të shpaguajnë për një grua kaq të rëndësishme. Nëse e dorëzoni atë kaurre aq të vyer ju mund të çlironi shumë prej besimtarëve tuaj."

"Mashallah!" u hodh një turk tjetër i vjetër, duke rrufitur kafenë. "Hekim Beu po thotë gjëra të mençura."

"A mund ta vras nënën time unë?" shpërtheu një jeniçer i ri me zemërim të madh. "Kjo është ajo gjëja që më bën të egërsohem ndaj Muratit. A nuk është ajo e bija e një kaurri të mallkuar, e atij qeni bir qeni, Huniadit? Dhe a nuk ka ofruar për shpagim për atë trimin tonë Karam Beun vetë dhe luftëtarët që ai i ka kapur dhe i mban? Dhe a nuk është vetë Sulltan Murati që ka thënë Jo? Dhe përse ka thënë jo ai? Për shkak të djalit të tij, Princit Mahomed. Ai në vend që të luftonte kundër kaurrëve ka lakmuar një prej grave të tyre dhe është bërë majmun. Pah! A mund ta vras nënën time unë? Edhe nëse kaurrët do të marshonin drejt qytetit unë nuk do të luftoja. Jemi dhjetë mijë vetë të betuar të mos luftojmë për kaurrët dhe as për ata që i duan kaurrët!"

Shefi i eunukëve të Mahomedit, i cili rrinte dhe vështronte, e mori fjalën dhe tha: "Lermë t'ju tregoj se unë nuk jam një thashethemexhi dhe as një njeri i përçmuar që të bëj një akt ç'burrërimi. Princi i ri mund t'i mposht kaurrët pa ndihmën e atyre që janë aq të zhurmshëm kur kënaqen nëpër kafene por janë aq të heshtur kur janë në fushëbetejë. Për sa i takon gjërave të tjera ju të gjithë duhet të ndjeheni të qetë për Princeshën frënge. Ju flisni sikur ajo po ikën dhe shpejt do të vdesë. Jo nuk e len njeri. Sulltani ka ofruar njëqind qese floriri për cilindo që e kuron atë. Cfarë është më e rëndësishme është se floriri nuk do të numërohet asnjëherë prej hasnadarit, madje unë kam të drejtë ta dyfishoj atë.

"Provoje fatin tënd, hekim," i thanë Iskanderit disa që koloviteshin duke qeshur nëpër shezllone.

"Allahu e ka goditur Princeshën frënge," tha turku i vjetër me mjekër të bardhë.

"Ai do ti ndëshkojë të gjithë kaurrët," tha shoku i tij më i vjetër duke hurpë kafenë. "Kështu është e shkruar."

"Eh! Nuk do të desha të dëgjoja për gratë skllave që i pret vdekja," tha jeniçeri i ri, me një ton të butë, "veçanërisht kur ato janë të reja. Murati mund ta shpaguante atë.

Ai mund t'ja jepte njërit prej oficerëve të tij ose ndonjë djali të ri që ka dëshmuar zotësinë e tij." Dhe kështu duke dredhur mustaqet dhe përplasur kamxhikun jeniçeri i ri doli rrëmbimthi nga kafeneja.

"Kur ishim të rinjë,"i tha turku plak me mjekër të bardhë shokut të tij, duke tundur kokën, "kur ishim të rinj."

"Ne e pushtuam Anadollin dhe kurrë nuk e hapëm gojën," i tha shoku i tij.

"Unë kurrë nuk kam dhënë një mendim timin deri sa u bëra gjashtëmbëdhjetë vjeç," tha turku plak, "sepse ishte njëri në familjen tonë që e bënte atë punë."

Krye - eunuku, pasi mbaroi gotën e sherbetit, u largua. Doktori armen i vajti mbrapa atij.

Kapitulli 9

Iskanderi në qytetin perandorak në Adrianopojë, në kërkim të Iduna Huniadit të zënë peng.

Krye - eunuku u kthye tek një varrezë nëpër të cilën kalonte një rrugë mespërmes një si korridori selviash, tek lagjia e Sarajeve. Doktori armen i shoqëruar prej ndihmësit të tij, e ndoqën po me të njejtin hap.

"Fisnik i nderuar!" tha doktori armen. "A mund të kem vemendjen tuaj për një moment, ju lutem?"

"Hekim i vyer, a je në vete?" u përgjigj krye-eunuku, duke u kthyer me një buzëqeshje inkurajuese të një sjellje plot përfillje.

"Patjetër që po?"

"Do të tregoj gjëra të rëndësishme," i tha atij doktori armen.

Eunuku u ul këmbëkryq krejt pa kujdes mbi një varr të gdhendur bukur dhe me një ndjenjë të fortë superioriteti rrotulloi një xhevahir që i shndriste në gishtin e tij. Pastaj pa hezituar fare i dha adresën hekimit.

"Unë jam doktor," tha armeni.

Eunuku tundi kokën.

"Dëgjova atje në kafene se Sulltani, i Plotfuqishmi ynë, kishte ofruar një shpërblim të madh për këdo që mund të shëronte atë robinën e vyer."

"Jo më pak se njëqint qese floriri," pohoi eunuku. "Shpërblimi është në proporcion me urgjencën e çështjes. Besomë mua, zotëri i vyer, gjëndja është e vajtueshme."

"Me jetë a vdekje?" iu kthye armeni. "Unë zotëroj një hajmali me efekt magjik të cilës nuk i reziston asnjë ç'rregullim shëndetësor. Unë do të provoja efektin e saj."

"Kjo nuk është hajmalia e parë që na është ofruar, doktor i vyer," tha eunuku, duke buzëqeshur me mosbesim.

"Por e para që iu është ofruar me këto kushte," tha armeni. "Më lejoni ta kuroj unë robinën dhe prej atyre njëqint qeseve të flororit një pjesë do t'ju takojë juve. Ajmen! Aq shumë besoj në këtë sukses saqë mendoj se nuk ka asnjë arësye të mos ketë sukses. asnjë rrezik nuk e kërcënon suksesin e saj."

Sapo tha këtë, armeni hoqi prej gishtit një unazë me një gur të çmuar dhe ja zgjati eunukut. Shërbëtori i vyer i Sarajit kishte një shije të hollë për xhevahiret. Ai e pa gurin e çmuar me admirim dhe e vendosi në gishtin e tij me një ndjenjë vetëkënaqësie të jashtëzakonëshme. "Unë nuk dua favore për të promovuar shkencën dhe veprat e mira të bamirësisë," tha eunuku me një sjellje imponuese.

"Qenka vërtetë një gur shumë i çmuar dhe do ta mbaj si një kujtim prej një të huaji të zgjuar dhe që fitova menjëherë respekt për të. Të premtoj se do ta mbaj me kënaqësi. Ah, po, po më thonit diçka rreth hajmalisë. A e keni me gjithë mend? Nuk dyshoj se ka mjete të cilat ndihmojnë të arrihet qëllimi. Por Princi Mahomed është aq i dhunshëm kur nuk kënaqet ose kur zhgënjehet sa ç'është bujar kur arrin atë që dëshiron. Kuroje këtë robinë të krishterë dhe vërtetë që mund t'i kemi qeset e premtuara të mbushura plot. Por po dështove, edhe koka jote dhe me siguri e imja do të vërviten në hendekun e Sarajeve."

"Fisnik i madh!" u shpreh doktori, "Unë jam i gatshëm të ndërmarr eksperimentin sipas kushteve që përmendëm. Je i sigurtë që pacientja, nëse është e gjallë, duhet që këtë ilaç ta marrë sa më shpejt. Ju do të habiteni nga efekti i menjëhershëm i hajmalisë. Besomë, sikur t'i kishit parë ata që janë shëruar nga kjo kurë do të na kishit kërkuar edhe në fund të botës po të ishim," shtoi ai.

“Tani e keni fjalën ju,” u përgjigj eunuku, “të merreni me një njeri që ka parë diçka nga bota. Unë udhëtoj çdo vit nëpër Anadoll me Princin Mahomed. Sikur të isha një njeri fanatik dhe mëndjengushtë që nuk ka qenë kurrë përtej Adrianopojës do të isha mosbesues i pandreqshëm. Por unë jam një padron i shkencës dhe kam dëgjuar shumë për hajmalitë. Sa mund të peshojë kjo unazë, mendoni ju?”

“Kam dëgjuar se është një gur i çmuar me një masë të pakrahasueshme,” iu përgjigj armeni.

“Ku thatë se jeni të vendosur, hekim?”

“Tek hani i Bedredinit.”

“Vend shumë i mirë për të qëndruar. Mirë, do të shohim. A keni edhe xhevahire tjera? Ndoshta mund t’ju vë në kontakt me disa që kanë çmime më të mira kur të behëni gati për të ikur. Hani i Bedredinit është i vendosur në një vend shumë të përshtatshëm. Ndoshta rreth mbrëmjes mund të rrufitim nga një kafe së bashku tek ai han dhe do të flasim për këtë punën e hajmalisë. Allahu qoftë me ju, hekim i vyer!” uroi Eunuku, tundi kokën, jo pa guxim, dhe mori rrugën që donte.

“Ishtë ankthi që na mundon që më mbajti pa shpërthyer në të qeshura,” tha Nikeas. “Një ‘padron’ i shkencës, ky mizantrop, mendjeshkurtër, makut, spitullaq. O Shën Mëri!”

“Hesht, miku im!” e qortoi Iskanderi duke buzëqeshur. “Krye - eunuku i trashëgimtarit tashmë të caktuar të kurorës së Perandorisë Turke është shumë më i rëndësishëm sesa një Princ i varfër, ose një rrebel i paligjshëm. Ky njeri me vlerë mund të na hyjë shumë në punë dhe unë besoj se do të na ndihmojë pasi ia kemi gjetur çelësin. Është e qartë se ai do të bjerë në grep. Na duhet një karrem edhe më i mirë për të mos e lenë që të na dalë nga dora. Por ne duhet të jemi shumë të durueshëm dhe të mos harrojmë se fati i kujt është në teh të briskut.”

Kapitulli 10

Iskander merret me "shërimin" e Idunës me "hajmalinë" e tij.

Krye - eunuku nuk i la 'shokët' e rinj aventurierë të prisnin gjatë. Përpara se muezini që nga minareja të thërriste zërin e akshamit, ai u shfaq tek Hani i Bedredinit për ta takuar doktorin armen.

"Ejani shpejt! Nuk kemi kohë për të humbur," i tha eunuku Iskanderit. "Merr me vete çfarëdo që të duhet dhe ndiqmë mua!" Eunuku i priu udhës ndërsa Iskanderi dhe Nikeas ruanin një distancë të caktuar prej tij. Pasi zbritën në rrugë, arritën tek varreza ku kishin biseduar po atë dite. Kur mbrrinë tek vendqëndrimi, eunuku u kthye dhe iu tha armenit:

"Dëgjomë hekim i vyer, në qoftëse më mashtron unë kurrë nuk do të mbroj më një njeri të shkencës. Kurrë! Unë pata rastin e lumtur që të flisja me Princin Mahomed këtë mbasdite për hajmalinë tuaj. Unë i kam dhënë atij aq shumë garanci se ju do ta shëroni atë zonjë sa që tani e gjej krejt të pamundur që ta shtyjmë trajtimin e saj, madje as deri nesër. Ia përmenda të tëra kushtet. I thashë Princit se garancia më e madhe është vetë jeta juaj. Nuk i përmenda asgjë për pjesën e shpërblimit, hekim i vyer. Kjo është një çështje që mbetet midis nesh. I besoj ndershmërisë tuaj sikundër bëj gjithmonë me njerëzit e shkencës."

"Nuk do të luaja me profesionin tim dhe as me besimin tuaj për asnjë gjë në këtë botë, prandaj rri i qetë," u përgjegj Iskanderi. "A do të thotë kjo se do ta shohim sonte robinën tuaj?"

"Ah, më fal, se kam ca dyshime për këtë. Po ju a jeni të përgatitur për këtë? Ne ndoshta edhe mundemi të fitojmë pak kohë**,** por vetëm nëse bëhet shumë e domosdoshme."

"Patjetër i dashur zotëri; Ne jemi përherë të përgatitur dhe të gatshëm, në çdo kohë, në çdo moment."

Kështu, duke biseduar ata kaluan nëpër varreza dhe arritën në një farë lartësie tek një vend si një tarracë. Eunuku, i cili mbahej në një shkop prej argjendi i çoi ata deri tek një portë e vogël, e hapi dhe ata hynë brenda atij gardhi pas të cilit shfaqej një grumbull i madh me shkurre masive. Më pas nëpër një rrugë zikzake ata kaluan nëpër një livadh të gjërë. Aty gjëndej një ndërtesë e parregullt, shumë e madhe. Kur iu afruan asaj, një djalë me sjellje shumë arrogante iu priu me shpejtësi drejt një porte dhe sapo shkuan aty ai iu drejtua Iskanderit.

"Ju jeni ai doktori armen?"

Iskanderi pohoi pa zë.

"Po hajmalinë e keni me vete? Po kushtet a i dini? Shëroje këtë vajze të krishterë dhe kërko çfarë të dëshirosh! Dështo dhe aha! Të iku koka!"

"Kushtet janë krejt të kuptueshme, Princ i Naltmadhërishëm!" iu përgjigj Iskanderi.

Ky djali nuk ishte as më pak dhe as më shumë i rëndësishëm sesa vetë djali i Sulltan Muratit dhe pushtuesi i ardhshëm i Konstandinopojës.

“Kaflisi”, i shqiptoi emrin eunukut,” do tu dërgojë menjëherë tek pacientja juaj,” tha Mahomedi. “Sa më takon mua, unë nuk do të gjej dot rehati deri sa të di rezultatin e vizitës që po bëni. Prandaj do të shetis rreth e rrotull në këto kopshtije dhe të vazhdoj të këpus lule. Kjo është e vetmja kënaqësi që më ka mbetur që kur ajo u sëmur.”

Kaflis ua bëri me shenjë miqëve ta ndiqnin dhe bashkarisht hynë në Saraje.

Në fund të një galerie të gjatë ata u ndeshën në një portë të madhe të cilën e hapi vetë Kaflisi. Iskanderi dhe Nikeas për një moment kujtuan se kishin arritur tek salla hyrëse e Kullës së Bebelit. Në fakt aty gjetën vetëm një turmë të madhe grashë të punësuara për distilimin e luleve të rralla të jaseminit, që lëshonin një si zhuzhurimë. Zërat e tyre u shuan sapo të huajt dhanë ballë, krejt sikur i kishte urdhëruar njeri. Por kur morën vesh se aty gjëndej një doktor me djalin e tij, habia dhe frika e përzier me nderim u zhdukën menjëherë. Ato u tubuan rreth Iskanderit të zhytura në kureshtje pa fund. Secila kërkonte të dinte diçka nga mjeshtria dhe dijenitë e këtij aventurieri rreth mjeksisë misterioze. Kjo skenë nuk zgjati shumë pasi Kaflis i sulmoi dhe i përzuri gratë duke i kërcënuar me shkop dhe ndonjërën duke e goditur nga prapa. Kjo bëri që ato të largoheshin menjëherë duke lëshuar britma të dhunëshme, duke sharë me nofka që ua veshnin eunukëve e që Iskanderi dhe shoqëruesi i tij i dëgjuan me një indiferencë të shtirur.

Pasi ikën nga ky korridor, eunuku dhe shoqëruesit zbritën nëpër një shkallë të gjërë. Në fund ata ndaluan përpara një dere. “Kjo është dhoma e kullës,” tha udhërrëfyesi i tyre, “dhe këtu do ta gjeni robinën.” Ai trokiti në një derë të cilën e hapi një skllave. Iskanderi dhe Nikeas, me vështirësi po e fshihnin ankthin tani që po i afroheshin një apartamenti të vogël por aq të rëndësishëm.

Në fund fare gjëndej një vend i fshehur, i mbuluar me një perde të lehtë e të hollë. Eunuku pasi i la aty, eci edhe më tej dhe me kujdes tërhoqi perden anash me ngadale dhe i tha disa fjalë me zë të ulët të burgosurës së mazgallës. Brenda disa minutash eunuku i bëri me shenjë Iskanderit të shkonte drejt saj, dhe i pëshpëriti atij: “Ajo në fillim nuk donte t’ju shihte. Por më pas kur i tregova se jeni të krishterë, pranoi.” Pasi i tha këto fjalë, ai e tërhoqi perden dhe nxori në dritë një femër të veshur me një rrobë të gjatë si vello, të ulur në një kolltuk.

“Zonjushe e nderuar,” i tha mjeku (në greqisht) të cilën e kishte konstatuar se eunuku nuk e kuptonte: “Më fal për zellin e një miku të krishterë. Mos më gjyko kështu të veshur me këtë rrobe, por unë në fakt i kam shërbyer babait tuaj të shquar. Unë do t’ja kushtoja tërë jetën time shërbimit ndaj vajzës se Huniadit të Madh.”

“Njeri i huaj dhe i sjellshëm,” u përgjgij robina, “unë isha krejt e papërgatitur për një vizitë të tillë. Falenderit. Falemnderit për simpatinë tuaj por fati im i keq më ka sjellë përtej mundësive për t’ju gëzuar ndihmës njerëzore.”

“Zoti i di vetë punët e veta moj fisnike,” iu kthye asaj Iskanderi, “dhe me bekimin e Tij ne mund të arrijmë çdo gjë.”

“Kam frikë se duhet të shoh vdekjen si të vetmin shpëtim,” u përgjigj Iduna, “dhe për më tepër, kam frikë se ajo ditë e shpëtimit tim nuk do të jetë aq e largët sa ç’e mendojnë pengmarrësit e mi. Por ju jeni doktor, pra, eja më trego se sa shpejt Natyra paska për të më ndihmuar që unë të dal në liri?”

Ajo i zgjati dorën Iskanderit, i cili ia mori dhe ia shtërngoi paqëllimshëm.

“Fisnike,” i tha asaj, “mjeshtria ime si doktor ishte thjesht aftësia për të hyrë brenda këtyre mureve. E vetmja hajmali që kam unë me vete është një porosi prej miqëve tuaj.”

“Vërtetë?” pyeti Iduna me një ton aspak të qetë.

“Mbaje veten, fisnike,” tha Iskanderi, duke e ndërprerë. “Mbaje veten! Po të ishe dikush tjetër dhe jo vajza e Huniadit, kurrë nuk do t’i kisha hyrë kësaj aventure kaq të rrezikshme. Por unë e di që Lady Iduna ka trashëguar diçka më shumë sesa thjesht emrin e stërgjyshërve të saj të lashtë: Ti je mbartëse e shpirtit të tyre heroik.”

Nëse ndonjëherë ka patur ndonjë moment të jetës së Idunës, në të cilin ndjeu se duhej të mblidhte tërë energjië e saj, ai moment kishte ardhur. Doktori që po i fliste, dhe shoqëruesi që e priste tek dera ishin dy prej miqëve më të devotshëm të saj. Nuk kishte rrezik që ata nuk e merrnin përsipër për ta shpëtuar atë. Ata e kishin menduar shume mirë planin për të cilin ishin të sigurtë se do ta realizonin. Por përsëri, për ta arritur këtë duhej nga ajo vetë një përqëndrim shumë i madh në çdo aspekt. Në mendjen e saj duhej tendosje e jashtëzakonëshme, forcë fizike, marrje rreziku, shmangie frike dhe sakrificë. A ishte Lady Iduna e përgatitur për tërë këtë qëndresë dhe tërë këtë rrezik?

“Njeri fisnik,” iu përgjigj Iduna, “Unë nuk ju shoh dot si një njeri të huaj, pasi askush tjetër në këtë botë përveç një luftëtari kalorsiak nuk do t’i hynte një aventure thuajse të çmendur si kjo. Unë kam frikë se i keni bërë llogaritë gabim në lidhje me karakterin tim. Unë jam një robinë dhe kur e sheh se ku jam shumë shpejt do të jem edhe e ç’nderuar. Si liria ashtu edhe fama dhe nderi im janë njësoj në rrezik. Nuk ka rrezik dhe as vuajtje me të cilën të mos përballesha nëse kjo me jepte qoftë edhe një shenjë të vogël se do ta rifitoja përsëri lirinë dhe sigurinë e nderit tim.”

“Ju jeni pikërisht në atë mëndje të cilën dëshiroj edhe unë që të jeni. Tani, dëgjoi me vemendje fjalët e mia, zonjushë e dashur. Përfito nga vizita e kësaj mbrëmje dhe shprehu tek rojtarët tuaj se ju keni pësuar një përmirësim të dukshëm që prej vizitës time. Bëni çmos të rritni besimin e tyre tek aftësia dhe mjeshtria ime shëruese. Ndërkohë, unë do të lëshoj një raport të tillë që takimet tona të përditshme të mos jenë të vështira. Tani për tani, lamtumirë! Princi Mahomed po pret dhe më duhet të shkëmbej disa fjalë me të përpara sesa të largohem për sot.”

“Dhe a duhet të ndahemi pa i njohur unë këta miq kaq bujarë, ndaj të cilëve jam në një borxh kaq të madh, për një akt përkushtimi kaq të lartë i cili ndoshta do ta ndryshojë fatin tim të keq?” tha Iduna. “Ndoshta ju nuk e mendoni besimin e patundur që keni marrë tek një njeri ndaj të cilit ju nuk keni asnjë interes që ta mashtroni, dhe që, edhe nëse e mashtroni, nuk mund ta vendosni në një pozicion më të keq se sa ai ku gjëndet ajo sot. Unë vetë duhet të përmbush besimin tuaj, atë besim që prehet tek ju. Më ler të paktën të lehtësoj poshtërimin që më sjellin orët e vetmisë, me rikujtimin e miqëve të cilëve iu detyrohem për një vepër të miqësisë e cila më ka mbushur me një ndjenjë thagme prej së cilës unë ende nuk e kam marrë veten.”

“Personi, i cili ka penetruar në Sarajet e Adrianopojës i maskuar për të shpëtuar zonjushën Iduna, është Princi Nikeas ,” u përgjigj Iskanderi.

“Nikeas?” bërtiti Iduna me një ton zemërimi. “Zëri që po dëgjoj sigurisht nuk është ai i Princit Nikeas. As forma në të cilën unë e shoh atë tani,” shtoi ajo, pasi u zbulua. Në krah të saj qëndronte figura e lartë e doktorit armen. Ajo vuri re fytyrën e errët dhe të panjohur dhe i hodhi sytë rreth e rreth, duke u shfaqur me një bukuri të rrallë, por krejt të dërmuar.

“Unë jam një mik i Princit Nikeas,” tha doktori. “Ai është këtu. A mund të afrohet? Aleksis,” thirri shkurt Iskanderi, pa pritur përgjigjen e saj. Shoqëruesi i doktorit u afrua, por ishte eunuku ai që e shoqëroi nga afër.

“Krejt në rregull” i tha Iskanderi Kaflisit. “Ne jemi në rregull me njëqint qeset. Por, pa asnjë dyshim, me dikë tjetër që do të merrej me këtë rast, kjo zonjë do të ishte e pashpresë edhe nëse do t’i jepje dyfishin.”

“Zoti është Një,” tha eunuku, duke lëmuar gurin e çmuar në unazën e gishtit me një pamje vezulluese prej diamanti. “Unë kurrë nuk jam penduar që i kam ndihmuar njerëzit e shkencës. Princi pa na pret i vetëm. Eja këtu!”

Ai e mori Iskanderin për krahu.

“Ku është djali juaj? Çfarë po bëni aty zotëri?” Pyeti eunuku, prerazi për Nikean, i cili po vonohej dhe i puthte dorën Idunës.

“Po i kërkoja zonjushës një favor, të shkoja me të tek kafeneja;” u përgjigj Nikeas “harruat që unë nuk marr asnjë kfart prej të njëqint qeseve?”

“E vërtetë,” tha eunuku. “Por do të ketë diçka edhe për ty, mos u bëj merak. Do të gjëndet edhe për ty ndonjë pjaster. Unë dua të inkurajoj njerëzit e shkencës dhe të gjitha u takojnë atyre. Por mos shko t’i harxhosh të gjitha në një mëngjes, djalosh! Rëndësi ka që robina të shërohet. Mos harro të ma rikujtosh, djalosh se ndoshta mund t’ju jap edhe më shumë sesa një.”

Kapitulli 11
Iskanderi takohet inkonjito me Princin Mahomed në Sarajet e Adrianopojës.

Kaflis dhe shoqëruesi i tij arritën përsëri në bahçe. Mugëtira po kalonte. Një burrë mbi kalë i shoqëruar prej disa tjerëve që ecnin në këmbë gati sa nuk u hodh përmbi ta. Ishte vetë Princi Mahomed.

"Hekim, si thua?" pyeti ai në atë stilin e tij prej kapadaiu, "a mund ta shëroni vajzën apo jo?"

"Po, patjetër," u përgjigj Iskanderi vendosmërisht.

"Tani dëgjo, hekim," tha Mahomedi. "Më duhet që shumë shpejt të iki nga qyteti dhe të nxitoj drejt Epirit në krye të trupave tanë. Jam betuar në Rrasën e Shenjtë për dy gjëra: Përpara se të dalë Hëna e Re do të kem shti në dorë zemrën e Idunës dhe kokën e Iskanderit!"

Doktori tundi kokën në shenjë miratimi.

"Nëse do të arrish t'i rikthesh shëndetin vajzës frënge," vazhdoi Mahomedi, "e cila do të më shoqërojë brenda dhjetë ditësh në udhëtimin tim për në Epir, atëherë kërko prej thesarit çfarë të duash, madje po të të pëlqejë mund të bëhesh edhe doktor i vetë Sarajit. Si thua?"

"Shpresa dhe besimi është që brenda dhjetë ditësh ajo të thithë ajrin e Epirit," u përgjigj Iskanderi.

"Për atë mjekër të babës tim dhe qimen e Pejgamerit Alai Selam ju do bëheni njeriu i zemrës time," bërtiti Princi. "Përderisa ti shëron me hajmali, hekim beu, a mund të më japësh shpresë se do të më sigurosh një takim me atë rrebelin epirot brenda kohës që të thashë, kështu që unë të mund të mbaj betimin, Si thua? Çfarë më premton?"

"Ka edhe premtime magjike të tilla," u përgjegj Iskanderi. "Por mbaje mend mirë këtë që po të them: "Unë mund të siguroj vetëm takimin, por jo edhe kokën e epirotit."

"Ajo më takon mua ta pres, pastaj," tha Mahomedi, me një nënqeshje arrogante. "Por, takimin, takimin," këmbënguli ai.

"A e dini se ku është shatërvani i Kallishtës në Epir? Vlerat e ujit të tij janë shumë të njohura, Naltmadhni?"

"Kam dëgjuar për të."

"Zhyte tre herë kordhën tënde në ujrat e tij në mesnatën e një hëne të re dhe çdo herë thirre armikun që dëshiron ta takosh. Të siguroj se do ta takosh."

"Nëse e shëroni robinën unë do ta besoj këtë që më tregove dhe do ta realizoj edhe takimin," u përgjigj Mohamedi, menjëherë.

"Rri pa merak, e kam marrë përsipër që ta bëj këtë dhe do ta bëj," u përgjigj doktori.

"Mirë atherë, edhe unë do ta mbaj premtimin tim," tha Princi.

"Por kujdes," tha doktori, "ndërkohë që unë marr përsipër të shëroj zonjushën dhe të gjej atë luftëtarin, nuk mund të siguroj Naltmadhninë Tuaj as për zemrën e njërës dhe as për kokën e tjetrit."

"Kjo kuptohet," tha Mahomedi.

Kapitulli 12
Iskanderi dhe Nikeas e nxjerrin robinën Iduna nga burgu i Sarajeve të Adrianopojës.

Doktori armen nuk la pa vizituar pacienten robinë në orët e para të mëngjesit tjetër. Kryeunuku Kaflis e priti atë me një buzëqeshje inkurajuese.

"Hajmalia tashmë veproi;" tha eunuku: "Ajo ka kaluar një natë të qetë dhe përmirësimi duket qartë. Qeset tona janë të sigurta. Më duket sikur po e shoh veten duke e numëruar flororin. Por po të them diçka hekim i vyer. Mu afro edhe pak mu afro!" dhe Kaflisi hodhi një vështrim rreth e rrotull për të parë nëse ishtë ndokush afër që të dëgjonte. "Unë e di se Princi është shumë bujar, a e kuptoni? Ne i ndajmë floriret. Nuk do të zihemi. Sidoqë të vijë puna, unë asnjëherë nuk jam penduar që kam ndihmuar një njeri të shkencës dhe jam i sigurtë që kurrë nuk do të pendohem as tani e tutje. Siç e shihni, Princi është i dhunshëm**,** por bujar. Unë nuk do desha që ajo të shërohej aq shpejt... eh?"

"Ju e dini më mirë se askush këtë çështje," u përgjigj Iskanderi, me një gjest të plotë miratimi, kur ata hynë në dhomën e kullës.

Iduna e luajti rolin e saj me përpikmëri. Në fakt kjo kërkoi më pak mjeshtri sesa pritej nga vizitorët e saj. Sëmundja e saj, e cila mund të kishte sjellë një fund fatal, ishte në origjinën e vet tërësisht mendore. Ishte shpresa që iu ngjall asaj papritur për liri, kthim tek familja dhe vendi i saj e shfaqur në atë moment të vështirë kur ajo kishte rënë në dëshpërim të plotë, që e bëri të merrte veten menjëherë. Në fakt ajo tani nuk mund ta fshihte naltësimin shpirtëror që kishte pësuar, andaj filloi të qeshte kur Iskanderi i përmendi pëpjekjen e afërt që kishte ndërmend të ndërmerrte si dhe dyshimin dhe rreziqet që mbarte kjo përpjekje. Ankthi i tij për tu kthyer menjëherë në Epirin e sapo çliruar e detyronte atë të ndërmerrte veprime të matura por të menjëherëshme për shpëtimin e Idunës. Nuk duhej humbur asnjë minutë. Prandaj gjatë vizitës së tretë, ai e paralajmëroi Idunën rreth një përpjekje shpëtimi të fortë që do të mund të ndodhte në mëngjesin e ditës tjetër. Deri në këtë moment, Iskanderi ishte ruajtur të mos e shfaqte veten fare tek Iduna. Ai ishte detyruar të adoptonte forma të ndryshme sjellje për të mos e prezantuar veten e tij para saj. Por nga ana tjetër ai nuk mund t'ja fshihte vetvetes më, se vajza e Huniadit kishte ndikim mbi ndjenjat e tij, edhe pse ai vetë nuk kishte ndonjë dëshirë që t'i inkurajonte ato. Miqësia e tij e pastër për Nikeas -n dhe bindja se detyra e tij ishte të perqëndrohej krejt dhe vetëm tek çështja e clirimit dhe ruajtjes së lirisë së vendit të tij, do të kishin ndikimin e vet tek lumturia e shokut të tij dhe ruajtja e respektit për vetveten. Në fund të fundit, ai ishte aq krenar sa nuk do t'i lejonte dot vetes të shijonte idhëtimin e aktit të kundërshtimit.

Sikur të kishte kapur edhe më shumë elementë të një ndjenje shumë të përzemërt që gjallëronte jo vetëm nga ana e Nikeas por edhe nga ajo e Idunës, mbase ai nuk do të kishte këmbëngulur aq shumë në ruajtjen e maskës së tij. Por ai prej kohësh kishte dyshuar se pasioni i Princit të Athinës për Idunën nuk gjente të njejtën përgjigje nga ana e të bijës së Huniadit. Kjo e bënte të ndjente ankth shumë të madh sidomos nëse Nikeas do ta shfrytëzonte tërë meritën e aventurës që kishin marrë përsipër. Iskanderi dyshonte pak se, nëse do të arrihej me sukses nxjerrja nga pengmarrja e Idunës, kjo do t'i jepte dorë Nikeas që të dilte me kërkesa të papranueshme për zemrën e asaj vajze,

për të cilën ai po luftonte që ta shpëtonte nga skllavëria dhe çnderimi, duke rrezikuar jetën e tij për të përfituar grada, emër të mirë dhe dashuri. Prandaj Iskanderi bëri shumë përpjekje për ta bërë Idunën të besonte se ai ishte thjesht dhe vetëm një agjent i besueshëm i Nikeas dhe se plani i tij fisnik për shpëtimin e saj nga Sarajet e Adrianopojës ishte i tëri i parapërgatitur prej mikut të tij rinosh. Ndërkohë, gjatë atyre tre ditëve, gjatë të cilave ata ishin takuar për aq pak kohë sa kishin mundur, ishin shkëmbyer shumë pak fjalë midis Nikeas dhe zonjushes. Në të vërtetë këto fjalë kishin qenë për të, në një farë mënyre, shumë frymëzuese dhe shprehnin një shkallë kaq të thellë mirënjohje dhe një respekt të tillë të shprehur hapur, saqë Nikeas-i nuk do të mund t'i rezistonte më bindjes mikluese që kishte vetëkrijuar, se ai më në fund e kishte tërhequr interesin e përhershëm të zemrës së saj. Shpesh atij i shkonte mëndja të turrej në ndenjtësen ku ishte ulur ajo dhe t'ja ngjiste buzet tek duart e saj. Çuditërisht, edhe parashikimi për lumturinë personale që e priste nëse realizohej kjo, nuk ia zbuste dot zilinë ndaj fatit të mirë të Iskanderit, të cilit i lejohej biseda me Idunën, pa pengesa. Në kthimin e tyre për tek hani, ai mezi e përballonte urrejtjen që ndjente për eunukun pompoz dhe torturën që ai i shkaktonte me bisedat e tij prej budallai, për arrogancën që shfaqte Kaflisi kur tregonte për vështirësitë që haste në bisedat me Idunën.

Ndërkohë e tërë Adrianopoja gumëzhinte nga përgatitjet për pushtimin e menjëhershëm të Epirit. Kthimi i Iskanderit ishte bërë edhe më urgjent. E ndërsa bëheshin përgatitje të ethëshme, aventura për çlirimin e Idunës po arrinte tek mëngjesi i ditës së katërt i aksionit për ta shpëtuar. Ata u bënë gati përsëri të shkonin në Saraje. Si çdo ditë tjetër, edhe atë mëngjes ata u shoqëruan prej Kaflisit i cili i përcolli deri tek dhoma në kullë. Gjatë udhës, ai e përgëzoi Iskanderin për përmirësimin e shpejtë të shëndetit të robinës.

Sapo hynë në dhomë, doktori eci përpara, ndërsa Nikeas, që e ndiqte nga pas, i filloi "procedurat" duke e goditur fort në kokë dhe rrëzuar eunukun në dysheme. Iskanderi u kthye menjëherë për ta ndihmuar atë. Ata arritën t'ja lidhnin gojën dhe ta shtrinin për tokë Kaflisin e alarmuar dhe të habitur. Iduna pastaj u shfaq e veshur krejt si Nikeas, në kostumin që ja kishin sjellë në çantën e tyre. Iskanderi dhe Iduna menjëherë ikën nga Saraji pa lënë asnjë dyshim dhe vrapuan drejt hanit. Aty ata i mprehën kuajt që i kishin lënë gati dhe u nisën me nxitim pa humbur asnjë moment drejt një shatërvani. Me të arritur aty, pritën pak me ankth derisa të arrinte Nikeas i cili pasi kishte qëndruar edhe disa minuta në dhomën e robinës së larguar tashmë, u përvodh heshturazi duke u kujdesur të kyçte derën prej nga nuk do të dilte dot aq shpejt Kaflisi. Ai zbriti shkallëve dhe nxitoi nëpër Saraje pa parë njeri të gjallë. Kur kishte arritur gati tek dera e lulishtes, ai u vu re prej rojeve të eunukut që ishin aty afër.

"Hej, po ti!" bërtiti njëri prej tyre; "Unë thashë se ju sapo kaluat këtu?"

"Kështu bëmë," u përgjigj Nikeas, pa i dhënë dyshimit të rojes as më të voglën vëmëndje, "por u ktheva për të marrë çantën, të cilën e kisha harruar." Ai nuk iu dha kohë që të reflekreagonin, rendi në rrugën e tij, kaloi nëpërmjet portës me shumë nxitim, vrapoi nëpër varreza, nxitoi nëpër rrugë, i hipi kalit, dhe doli në trok me shpejtësi nëpër dyert Sarajit. Kur ia kapi syri Iskanderin dhe Idunën që po e prisnin, ai ua bëri me dore që të niseshin menjëherë dhe pas pak ata u bashkuan në një karvan dhe pa shkëmbyer asnjë fjalë rendën me shpejtësi, pa marrë as frymë deri në perëndimin të diellit.

Kur nata ra, ata kishin mbërritur tek një pyll i madh me gështenja. Të rraskapitur siç ishin, u ulën që të pushonin nja dy orë, më shumë për hatër të kuajve sesa të tyre

vetë. Ankthi nuk e linte Idunën t'i gëzohej atyre orëve të para të lirisë, të asaj lirie që ishte ende nën kërcënim.

Kështu i liruan kuajt dhe i lëshuan që të kullosnin në livadh. Iskanderi ndezi një zjarr dhe përgatiti ushqim të çastit. Nikeas i bëri Idunës një si vend ulje me gjethe ku të mbështeste edhe kokën. Në fakt, ndryshe prej çfarë dëshironte ai, ajo më kot u mundua të flinte. Përpara mesnatës ata përsëri u nisën për udhë duke kalëruar me hap të shpejtë në drejtim të maleve. Kështu ecën deri në orët e mesditës, kur kuajt u lodhën aq shumë për shkak të udhëtimit të gjatë dhe temperaturës së lartë. Iskanderi dukej shumë serioz dhe shpesh hidhte një sy prapa në drejtim të Adrianopojës.

"Na duhet të dalim jashtë rrethit të ndjekjes," tha Nikeas. "Imagjinoni sesi Kaflisi i gjorë është ende i shokuar për atë që i ndodhi."

"Nuk kemi zgjidhje tjetër veç të arrijmë tek malet," iu përgjigj miku i tij, "unë kisha pak frikë se mos kuajt do të kishin vështirësi për të bërë tërë këtë rrugë të gjatë, por ata ja dolën. Prandaj nuk mund të llogaritim në ta më shumë se edhe tre orë që nga ky moment. Princ, miku ynë Kaflis ishte një personazh tepër i rëndësishëm sa nuk mund të lihej pa u shpaguar."

"Në dorën tënde Virgjinë e Shenjtë!" u lut Ledi Iduna. "Unë nuk e ysht dot më kalin tim të lodhur."

Ata iu ngjitën një kodre të vogël me një pamje të gjërë mbi fushën. Iskanderi ndaloj dhe hodhi një sy rreth e rrotull, gjë që ia shtoi ankthin.

"Po shoh disa kalorës atje larg të cilët nuk më pëlqejnë," tha doktori.

"Edhe unë i shoh," tha Nikeas. "Duhet të jenë udhëtarë si puna jonë."

"Më mirë të vdesim se të biem në dorën e tyre," tha Iduna.

"Levizni," tha doktori, "dhe më leni t'i shoh këta kalorës i vetëm. Do të thoja se në pamje të parë qenkan disa në pyll. Brenda dy orësh ne duhet të arrijmë tek malet."

E bija e Huniadit dhe Princi i Athinës zbritën nëpër rrëpirën e pjerrtë. Përpara tyre, por në një distancë të konsiderueshme rridhte një lumë i rrëmbyeshëm dhe i gjërë, brigjet e të cilit i lidhte një urë e rrënuar e kohëve romake. Në anën tjetër të bregut shtrihej një fushe, e cila zgjatej drejt maleve.

"E mrekullueshmja Iduna, ndjehuni e sigurtë," tha Princi i Athinës.

"I dashur Nikeas," u përgjigj miku i tij, "A e merr me mend se çfarë përgjegjësie kam unë?"

"Nuk është momenti i duhur për të shprehur tërë mirënjohjen time," iu përgjigj ai.

"Unë kam frikë se Lady Iduna kurrë nuk do ta shprehë dot mirënjohjen e saj ndaj Nikeas."

Miku i tij i shkundi yzengjitë, e shpoi kalin me mamuze dhe levizi me shpejtësinë më të madhe, të mundshme.

"Nikeas!" thirri ai, "Ndalo."

Ata i ndaluan kuajt e tyre të furishëm.

“Po tani! Miku im,” tha Princi. “Dukeni i shqetësuar.”

“Lady Iduna!” tha armeni, “po na ndjekin.”

Deri tani shpresa për të dalë në liri nga njëra anë por edhe frika se mos dështonte e kishin shpëtuar Idunën nga dhimbje të tilla të cilat në çfarëdo rrethanash tjera do të ishin provuar të ishin fatale. Por tani e ballafaquar me faktin se bash në momentin kur ajo po i gëzohej përmbushjes fatlume të asaj sipërmarrje aq të guximshme, dështimi vdekjeprurës ishte absolutisht më afër se kurrë dhe kërkonte një përmbledhje të madhe të energjive të saj të shterruara. Ajo u zbeh e tëra, ngriti duart dhe sytë e dëshpëruar drejt qiellit në një agoni që nuk përshkruhet, uli kokën dhe shpërtheu në dënesë të papërmbajtura. Nikeas i shpërqëndruar fare kërceu nga kali, u përpoq ta qetësojë Idunën thuajse të mpirë dhe pastaj, duke parë me keqardhje drejt mikut të tij aventurier, ia kapi duart në dëshpërim. Miku i tij ishte i përhumbur në mendime.

“Erdhën ata,” tha Nikeas, duke marrë pozicion mbrojtje,” më duket se e shoh njërin në krye të kodrës. Larg! Fluturoni! Më në fund le të vdesim duke luftuar. E dashur, e dashur Iduna, a do të mjaftonte jeta ime për të shpëtuar tënden! O Zot! Kjo qenka agoni a vërtetë.”

“Të shpëtosh është e pamundur,” tha Iduna, në një ton qetësie e cila i habiti ata. “Ata duket se janë më shumë sesa ne. Vajmedet! Miq guximtarë, unë ju solla në këtë situatë! Më falni, më falni! Më vjen turp nga vetvetja për dhimbjen egoiste që ju kam shkaktuar. Krahasojeni këtë me gjëra tjera dhe jo me një shpirt të ngushtë dhe një mëndje të dobët. Na ka mbetur vetëm një rrugëdalje. Nuk duhet të biem në duart e tyre. Po, ne jemi luftëtarë dhe do të vdesim si të tillë. Unë në të vërtetë jam thjesht një femër, por jam edhe e bija e Huniadit. Nikeas, ti je miku i babait tim. Dua vetëm një gjë: Ma ngul thikën në gjoks dhe të vdes!”

Princi në përhumbjen e tij të heshtjes ia shtërngoi duart Idunës. Buzët filluan t’i dridheshin nga emocioni i papërmbajtur. Papritmas ai bëri përpara dhe e lëshoi veten tek këmbët e mikut të vet të heshtur.

“Oh, Iskander!” shpërtheu Nikeas, “Mik i madh dhe i lavdishëm! Koka dhe zemra ime janë të dyja tepër të dobëta për këtë sprovë kaq të tmerrëshme. Shpëtoje atë, të lutem, shpëtoje!”

“Iskander!” Shpërtheu Iduna në britma. “Iskander?!”

“Në të vërtetë, unë kam fatkeqësinë të jem Iskanderi, zonjushë e dashur,” u përgjigj ai. “Kjo në fakt është një situatë pothuajse e pa shpresë. E shoh se më duhet të përballoj më shumë se disa burra prandaj më duhet ta mbledh veten. Kjo ka ndikim mbi fatet e shumë e shumë njerëzve, jo vetëm tuajin dhe timin por të tërë Epirit. Eja! Nikeas, ka vetëm një rrugëdalje! Ne duhet të zemë pritë tek ura!”

Pasi i tha këto fjalë, Iskanderi i rrahu shpatullat Idunës, i hypi përsëri kalit dhe i ndjekur prej atyre të dyve nxitoi drejt lumit.

Kur arritën tek bregu i lumit, Iskanderi bërtiti: “Uji është i pakalueshëm. Unë do të mbroj urën edhe pse do të jetë e vështirë t’i bllokoj tek vau për aq kohë sa ju dhe Iduna të keni arritur tek malet. Prandaj ikni! Mos mendoni më për mua! Jo! Nuk dua lot e dashur zonjushe, nëse nuk doni të më ç’burrëroni! Një buzëqeshje frymëzuese dhe

gjithçka do të jetë në rregull. Nxitoni për në Krujë dhe mos bëni asgjë që t'ju vonojë me shpresën se do bashkoheni me mua përsëri. Më besoni, ne do të takohemi një ditë, por veproni siç iu them unë, sikur këto të ishin fjalët e mia të fundit! Zoti të bekoftë, Nikeas! Mos më përshpërit! Të paktën një herë lëre doktorin ta komandojë pasonjësin e vet! Zonjë e embël, me kujto me babain tend! Ah sikur të kisha patur edhe unë një bijë të tillë në Epir që të udhëhiqte vëllezërit e saj nëqoftëse unë do të vritesha. Idunë, tregoi Huniadit të Madh se pasuria ime më e vyer është liria e vendit tim."

"Lamtumirë, lamtumirë!"

"Unë nuk do të them lamtumirë!" bërtiti Iduna. "Edhe unë mund të luftoj. Unë do të qëndroj dhe do të vdes bashkë me ty."

"E sheh, po vijnë! Besomë mua, unë do t'i mund. Ikë, ikë vajzë fisnike! Nikeas, ruaje atë me kujdes! Zoti të bekoftë djalosh! Jeto dhe qofsh i lumtur! Jo, jo në një botë tjetër. Në këtë! Por dijeni, sa më larg të jeni ju të dy, më besoni, aq më i fortë do të jetë krahu im. Me të vërtetë ua kërkoj këtë me ngulm. Ikni!"

Nikeas e fluturoi Idunën në shalën e kalit të saj, e drejtoi atë mbi urën e prishur dhe të ngushtë, i ra kalit me tërë forcën e mamuzeve dhe u nisën të dy së bashku rrugës lakore drejt kodrave. Iskanderi i ndoqi ata më sy tek po largoheshin. Iduna disa herë ia valviti mindilin kampionit të saj që kishte mbetur i vetëm. Ndërkohë Iskanderi hoqi rrobet e armenit dhe i hodhi në lumë, mori pozicionin që kishte patur, i shtriu këmbët, kontrolloi mirë gjendjen e armëve që kishte dhe u bë gati të shkëlqente tashmë në rolin e vet: Luftëtarit të lirisë.

Ura ishte e tillë, e ngushtë sa vetëm një kalorës mund të kalonte mbi të. Ajo mbahej në tre harqe. Harku i qendrës ishte i një masë shumë të konsiderueshme ndërsa tjerat ishin të vogla dhe të zhytura në ujë në të dy anët. Në shumë pjesë parapeti mural i urës ishte prishur madje në disa pasazhe kalimi ishte thuajse i pamundur për shkak të gurëve që kishin rënë dhe çarjet e rrezikshme që ishin shkaktuar ndër kohëra. Në qendër të harkut mesor ishte një gur i madh i gdhendur në trajtën e një helmete shumë të madhe, e cila i jepte vetë emrin asaj ure me të cilin e njihinin njerëzia e asaj ane.

Një togë kalorësisht erdhën me rroka – trokun e tyre të shpejtë duke bërtitur dhe uluritur. Ata i yshtën kuajtë me forcë deri sa, për habinë e tyre, u ndeshën me Iskanderin i cili me shpatën e mprehur qëndronte i gatshëm të mos i lejonte të kalonin. Për një moment ata ndaluan**,** por menjëherë zgjodhën të notonin nëpër lumë. Pa pandehur, kuajt e tyre të stërlodhur u tërhoqën mbrapsht prej instinktit të frikës nga ujërat e rrëmbyeshëm dhe të thellë. Njëri prej tyre që ngiste një vraç të mrekullueshëm të zi e mori rrezikun mbi vete.

Kalorësi hyri në ujë deri tek mesi i vaut. Uji u ngjit mbi barkun e kafshës. Iskanderi shkuli një gur tepër të rëndë me aq lehtësi sa të kishte vjelur një frut të pjekur nga një pemë dhe e hodhi me një saktësi vdekjeprurëse mbi armikun e tij. Kalorësi rënkoi dhe ra për të mos u ngritur më. Kali i lehtësuar nga barra që kishte, i mblodhi tërë forcat dhe kaloi në anën tjetër të lumit. Pasi doli në livadh kali hunguroi, u shkund i tëri dhe u shtri në bar i kapitur.

"T'ja presim kokën kaurrit!" bërtiti njëri prej kalorësve dhe u turr furishëm drejt urës. Thika e tij e mbrehtë u ndesh me atë të Iskanderit dhe u bë copë - copë prej goditjes që pësoi. Në moment koka iu nda nga supet dhe e mbuloi gjaku. Menjëherë tërë

kalorësit, secili i vendosur për të marrë hak për shokët e tij, u turrën bashkë pa u menduar dy herë drejt Iskanderit dhe bënë gjithçka mundën për ta mposhtur atë.

Shpata e Iskanderit shndriti si vetëtimë. Dy prej armiqëve të tij më të rrezikshëm ranë për tokë, por epërsia numerike mbizotëroi dhe në çdo rast, megjithëse prapsonte çdo goditje ai ndjeu se ishte duke humbur terren.

Më në fund ai u gjet në qendër të harkut të mesit të urës në një pozicion të volitshëm i cili i mundësoi për një moment t'i mbante turqit në vá, duke fituar kohë për vete që të merrte frymë. Papritmas ai bëri një lëvizje vendimtare, e çau më dysh kokën e drejtuesit të bandës dhe e gjuajti disa metra larg. Më pas duke u kthyer ngadalë në pozicionin e mëparshëm, ai i mblodhi tërë energjitë supernatyrale dhe me fuqinë që i erdhi shkuli gurin më të madh të urës. Midis asaj zhurme dhe klithme kuajt dhe kalorësit u shpërndanë për një moment sa andej këndej. Disa ranë përdhe prej copave të mëdha të gurëve të lëshuar mbi ta, të tjerë luftuan për të zënë si të mundnin vendin e mëparshëm. Midis tyre, Iskanderi, i pa dëmtuar, u zhyt sikur të ishte zotëruesi i plotë i lumit dhe ia nguli thikën mu në zemër të vetmit notar që kishte arritur të dilte në anën epirote të lumit. I zhytur në ujë dhe thuajse me forca të shterruara, Iskanderi më në fund qëndroi në kufirin e anës tjetër, shkundi krahët dhe vështroi skenën e shkatërrimit të jashtëzakonshëm që kishte lënë prapa ajo betejë aq e pabarabartë.

Tre ose katër viktima të tij ishin shtrirë të mavijosura dhe pa frymë në anën tjetër të lumit. Një kalë i mbytur në ujë kishte mbetur afër tyre i kapur në **haraklina**. Beteja tani kishte marrë fund ndërsa dallgët e ujërave të kaltërt dhe të ndritshëm të lumit rridhnin nën hijet e harqeve të urës.

"Iduna! Tani je e sigurtë" bërtiti Iskanderi. "Tani për Epir!" Sapo tha këtë, ai i hypi kalit që kishte kullotur në livadh gjatë tërë asaj kohe, i kërceu në shpinë dhe pas pak nxitoi drejt maleve të vendit të tij.

Kapitulli 13

Iduna në një udhëtim me Princin Nikeas.

Ndërkohë le të mos harrojmë Princin e Athinës dhe Ledy Idunën. Këtyre miqve aventurierë shumë shpejt iu humbi nga sytë kampioni i tyre i devotshëm. Ata u futën në një luginë që gjarpëronte e cila ngadalë dalë i nxori tek maja e parë e vargmaleve të Epirit. Që andej ata vështruan tek u shfaq një luginë e gjërë dhe një hon shkëmbor prej nga shumë rrugë mushkash ndaheshin në drejtime të ndryshme. Pastaj arritën në një zonë malore e cila ngrihej përpara tyre deri në qiell, e mbuluar me pyje bungu, lisash dhe gështenjash. Nikeas zgjodhi rrugën të cilën e konsideroi si më të pamundurën për ata që i ndiqnin duke vijuar drejt perëndimit deri sa hynë në një luginë që freskohej prej një prrocke me ujë që gurgullonte që nga malet. Kjo rrjedhë uji e kishte bërë tokën sa pjellore aq edhe të këndshme. Shkurret e egra të harlisura me ngjyra të shndritshme rifreskonin pamjen dhe kënaqnin syrin ndërsa aroma e bimëve aromatike ua ktheu përsëri ndjesitë e humbura. Përmbi bregun e lumit ata panë një kryq të madh të gdhendur në dru të ashpër i cili sikur ua qetësoi shpirtin dhe zemrën e krishterë. Ndërkohë që emblema e shenjtë i mbushi me shpresë dhe mëshirë, dukej se një ogur i mirë iu vinte refugjatëve të ndjekur nga muslimanët. Një eremit i përunjur me mjekër të bardhë e të gjatë doli nga një shpellë. Ai ishte i veshur me të zeza dhe zbriti dalë ngadalë duke u mbajtur në një shtagë prej thane.

Iduna dhe Nikeas deri këtu e kishin kyçur gojën dhe vazhdonin udhëtimin të zhytur secili në brengën e vet. E shkatërruar nga ankthi, çrregullimet dhe lodhja trupore, vajza e Huniadit mezi qëndronte mbi shalën e kalit. Në kokën e saj vlonte vetëm një mendim që e bënte të vuante dhe të mos mendonte dot për asgjë tjetër: Fati i Iskanderit. Qëkur e pa atë për herë të parë, në bisedën e jashtëzakonëshme në vend-ndodhjen e të atit, shumë herë i ishte rishfaqur imazhi i heroit. Ajo shumë shpesh i kishte rikujtuar cilësitë e larta dhe karrierën e tij të mahnitshme. Pamja e Iskanderit i shkonte përsosmërisht për shtat famës së tij, diçka që ishte aq e rrezikëshme për zemrat e femrave.

Dhe tani, kur Iduna mendonte se sa i detyrohej atij njeriu për të gjithë atë që ajo kishte në ato momente, përkushtimit të tij të pa interes dhe gjithçkaje që e bën jetën të mundshme, nderin dhe lirinë, vendin dhe të afërmit, ai imazh i shfaqej edhe më shpesh. Ajo ishte e lidhur me ndjenja të tilla të cilat sikur Iskanderi t'i dinte se ekzistonin do t'i ishte shtuar fuqia e krahut dhe frymëzimi për arritje të reja që kërkojnë energji të pafundme njerëzore. Më shumë se një herë Iduna kishte arritur në atë pikë sa t'i kërkonte Nikeas arësyen që i kishte shtyrë si njërin, si tjetrin, si atë, ashtu edhe Iskanderin, që të ruanin me aq fanatizëm maskimin e shokut të tij. Por një ndjenjë të cilën ajo nuk e kishte zgjedhur vetë, luftonte brenda saj me sukses kundër kureshtjes së saj torturuese. Ajo ndjeu një pengesë të tmerrshme për ta përmendur emrin e Iskanderit me Princin e Athinës. Në ndërkohë, Nikeas vetë nuk dukej se kishte ndonjë dëshirë për të folur rreth asaj çështje. Pas shprehjeve të para e të menjëherëshme të frikës për fatin e mikut të tyre si dhe shpresave që kishin se do t'i shpëtonte rrezikut me të cilin ishte ndeshur ai, ata iu rikthyen heshtjes. Ajo heshtje shpesh thyhej prej Nikeas, i cili qahej për vuajtjet e mikeshës së tij, të cilës Iduna i përgjigjej me një buzëqeshje të venitur.

Skena e re ku kishin hyrë tani dhe pamja e qeshur e eremitit u shoqërua me pershëndetje të ndërsjellta. Nikeas, pasi eci pak përpara, tentoi të tërhiqte vemendjen e njeriut të shenjtë. Ai filloi të bisedonte me të dhe i rrefeu për fenë që besonte, për

burgosjen, vuajtjet dhe shpëtimin dhe i kërkoi atij t'i strehonte. Eremiti bëri me shenje me shtagë drejt një shtegkalimi të gjërë i cili zgjatej që nga bregu i lumit deri tek një shpellë. Në emër të mbrojtësit të tyre të bekuar, ai i ftoi peligrinët tek vendbanimi i tij i egër kundrejt një pagese të vogël. Ajo ishte një shpellë e cila sapo të hyje brenda zgjerohej dhe përbëhej nga disa dhoma fjetje të vogla. Dukej se ajo ishte vepër e një pune të bërë prej të krishterëve të hershëm të cilët kishin gjetur aty strehë në ditët kur përndiqeshin. Arti i përdorur aty kishte plotësuar punën dizenjuese të papërfunduar të mrekullueshme të natyrës. Shpella ishte e freskët, e këndshme dhe e pastër. Qielli dukej nëpërmjet të një të çare në një guvë të saj. Dyshemeja ishte e shtruar me pllaka të zbukuruara. Në një prej cepave qëndronte një kryq prej bronxi ndërsa në një tjetër një kandil digjej përpara pikturës së Madonës së qeshur embëlsisht përmbi hyjninë e saj të vogël, Jezusin. Eremiti vuri përmbi tavolinën solide prej druri, të cilën ai vetë e kishte lëmuar, ca mjaltë, peshk të thatë dhe një vedër druri mbushur nga burimi i pastër që gurgullonte poshtë tyre. Ishte ushqim i thjeshtë, por i shijshëm. Miqtë e tij u ulën mbi ca ndejtëse të ashpra.

Sapo filluan ta merrnin veten, Eremiti iu kërkoi me kujdes t'i tregonin historinë e aventurave të tyre. Kur e pa se Eremiti, nisur nga veshja, e mori gabim gjininë e Idunës, Nikeas mendoi se nuk do të ishtë keq të mos e kundërshtonte atë. Prandaj e prezantoi Idunën si vëllain e vet. Ai e pershkroi vetveten dhe vëllain si dy të rinjë athiniotë, të cilët kishin rënë rob kur shërbenin si vullnetarë në udhëheqjen e Huniadit të Madh dhe kishin mundur të organizonin shpëtimin e vet që nga Adrianopoja në mes rrezikut shumë të madh dhe vështirësive të jashtëzakonëshme. Nikeas ndjeu se e kishte shuar kureshtjen e Eremitit, duke respektuar vëllezërit e tij të krishterë në tokat e Paynim – it. Pastaj, pasi shprehu tërë devocionin ndaj Kryqit, kur pa që Iduna kishte nevojë të tmerrshme për të pushuar, i kërkoi leje atij që t'i dërgonte të pushonin. Që këtej, Eremiti vetë, pasi rrëmbeu një barrë me krande të freskëta, e rregulloi një vend në njërin prej qilarëve dhe e ftoi Idunën e bukur që të pushonte aty. E bija e Huniadit, pasi u përul përpara altarit të Virgjinës dhe i ofroi asaj mirënjohjen për të gjithë mëshirën që kishte treguar për të kohëve të fundit, iu fal asaj duke mërmëritur fjalë paqeje dhe lutje për mikpritësin dhe shokun e saj. Më pas shkoi tek divani i ashpër për të rënë në një gjumë vdekje aq të embël sa ç'ishte pafajsia që mbart'te me vete.

Por qetësia nuk ra edhe mbi qerpikët e Nikeas përkundër të gjitha përpjekjeve që bëri për ta vënë vetveten në gjumë. Zemra e Princit të Athinës ishte shpërqëndruar prej dy pasioneve më të fuqishme kontradiktore – dashurisë dhe xhelozisë. Kur Eremiti, pasi iu tregoi miqve vendin e tyre të pushimit dhe për vete shkoi të flinte në vendin e tij të thjeshtë e të rregullt, Nikeas iku nga shpella dhe shkoi e qëndroi tek bregu i lumit. Prej aty ai soditi ujërat e rrëmbyeshme që vezullonin dhe shkumbonin nën dritën e hënës. Princi i Athinës, me gjithë cilësitë e admirueshme që zotëronte, ishte edhe një prej atyre njerëzve të cilët ndikohen vetëm prej pasonit të tyre dhe që në çështjet e jetës përherë e përgjithmonë shtyhen prej imagjinatës më shumë sesa prej arsyes së shëndoshë. Në këtë moment tërë mendimet dhe ndjenjat, tërë vlerësimet dhe imagjinata u shkrinë në dashurinë për Idunën. Kjo i kishte errur sytë fare dhe tejkalonte çdo cak. Tani ai ishte i vendosur të bënte gjithçka, të kalonte çdo rrezik që mund t'i dilte përpara për të bërë që ajo kurrë më të mos e takonte Iskanderin ose edhe nëse ndodhte kjo, ta takonte vetëm si gruaja e Nikeas. Krahasuar më këtë çështje të dorës së parë, e ardhmja dukej sikur po venitej dhe merrte kuptim tjetër. Çlirimi i vendit, mirëqenja e shokut të tij, madje edhe ruajtja e kredos së tij të shenjtë, të gjitha këto çështje të mëdha dhe fisnike për të cilat në rrethanat tjera, ai ishte i përgatitur të sakrifikonte fatin dhe jetën e tij,

tani nuk i interesonin ose nuk kishin ndonjë rëndësi për të. Dhe tani kur Legjionet e Gjysmëhënës ishin në pikën e shpërthimit kundër Epirit për të shtypur kauzën patriotike dhe kristiane për të cilën Iskanderi dhe ai vetë kishin menduar aq shpesh, interesi i tij shkërmoqej nga mungesa e Iskanderit dhe drejtohej vetëm e vetëm tek interesat e vetë Nikeas. Ai sigurisht kishte rrezikuar dhe ndoshta, nëse do të kiheshin parasyshë ngjarjet e ndodhura gjatë orëve të fundit dhe vetë sakrificat e bëra, Princi i Athinës do të vendoste që bashkë me të bijën e Hunaidit të linin gjithçka dhe të iknin dhe të jetonin diku në një vend të largët. Por edhe pse i errësuar nga egoja, vaniteti dhe eksitimi i tij i papërmbajtur, Nikeas-it i duhej ta përmbushte qëllimin e tij me sa më pak ushtrim detyrimi apo dhune. Ai tanimë ishte një shoqërues i refuzuar dhe në rrethana të cilat nuk linin pothuajse asnjë vend për shpresa.

Asgjë tjetër përveç respektit për shpëtimin e saj në atë mënyrë aq kalorsiake, nuk mund të ngjallte interes në zemrën e Idunës, të cilën ai aq dëshpërimisht e lakmonte. Ky akt heroik jepte shkas për një mëtim ndaj mirënjohjes së saj më të thellë, të cilin ajo vetë duhej ta shfaqte ndaj shpëtimtarit të saj, pra atij vetë, Nikeas. Mirëpo pasja e tërë atyre cilësve aq të rëndësishme nga dikush tjetër dhe mungesa e tyre në karakterin dhe në sjelljen e tij, ishin arësyet e vërteta dhe kryesore të refuzimit të saj ndaj tij.

Në rrjedhën e pakëndshme të ngjarjeve, ashtu siç kishin ardhur deri tani, vepra në të cilën ai e bazonte plotësimin e dëshirës së tij ndaj Idunës mbetej vetëm shpëtimi që i kishte berë asaj. Ky ishte çelësi që hapte derën e realizimit të ëndrrës së tij. Por atij i dukej se suksesi i arritur për shpëtimin e kishte vendosur në një situatë më të disfavorshme nga ajo që kishte pasur më parë. Mbetja vetëm me princeshën, aq të lakmuar dikur, kishte ringjallur të gjitha ndjenjat dhe ngrohtësinë e athershme, flakën e të cilave nuk kishte patur as forcën dhe as vullnetin që ta shuante. Ndërkaq, në anën tjetër, ai nuk mund t'ja fshihte vetvetes faktin se Iduna e dinte mirë se në tërë këtë aventurë për çlirimin e saj ai kishte luajtur thjesht një rol të dorës së dytë dhe se tërë gjenia, bujaria, guximi dhe kredia për realizmin e kësaj vepre të madhe i takonte Iskanderit. Ky i fundit, pasi i fali lirinë duke marrë mbi vete aq shumë rrezik, me aq shumë energji, mëndjemprehtësi, shkathtësi dhe mjeshtri, e kishte shpëtuar atë falë një veprimi të paimagjinueshëm, të atillë sa mund të bënte me turp tërë kalorësit e Krishtërimit. E në fund të fundit, ai ndoshta tërë këtë e kishte arritur me çmimin e jetës së vet.

Tani lindte pyetja: Po çfarë do të ndodhte nëse Iskanderi kishte mbijetuar? Kjo do të ishte një rastësi e madhe, por edhe mund të ishte e vërtetë. Robërimi i përjetshëm i Greqisë dhe triumfi i tmerrshëm i Gjysmëhënës ndoshta do të lidheshin me atë ngjarje të vetme. Po a duhej që shpëtimi i Idunës të justifikonte një çnderim dhe poshtërsi të tillë? Le të mos na i verbojë sytë pasioni. Tani po binte mesnata dhe Nikeas i papushuar, madje edhe më i lodhur se më parë prej ëndrrave torturuese, përfshirë edhe udhëtimin dhe përpjekjet e bëra, e detyruan të kthehej në shpellë dhe t'i vinte në gjumë të rëndë tëra këto shqetësime pa fund.

Kapitulli 14
Iduna dhe Nikeas të strehuar tek një Eremit.

Eremiti u ngrit sapo shndritën rrezet e para të Diellit. Ndërkohë që po merrej me punët e mëngjesit, atij iu bashkua Iduna e cila dukej e pushuar dhe e gëzuar pas atij gjumi të thellë. Pasi i bëri adetet fetare, mikpritësi i saj i nderuar i propozoi që të shkonin dhe të freskoheshin në ajrin e pastër të mëngjesit. Kështu, duke zbritur nëpër bregun e rrëpirtë drejt lumit, ai i priu asaj nëpër një luginëz të vogël që lagej nga një rrëke e hollë e rrëmbyshme, jo me aq shumë ujë. Turrat e **rrfatave** të prera nga pemët dhe plepat e hollë e të gjatë gjëndeshin në dy anët e rrugës mbi muret rrethuese prej guri të veshur me myshqe. Fushat me bimësinë e tyre ishin harlisur dhe formonin mozaik me ngjyra të qilimtë. Njëra anë e luginëzes ndriçohej nga rrezet e mrekullueshme të diellit që sapo kishte rënë mbi të, ndërsa tjetra ishte ende në hije.

"Këtu ju mund t'i gëzoheni natyrës dhe lirisë në siguri të plotë," tha Eremiti, "sa për armiqtë tuaj, nëse ende nuk e kanë lënë përndjekjen tënde, ata më kot do të kërkojnë në këtë vend të qetë."

"Është vërtetë qetë këtu o njeri i mirë," tha Iduna. "Por për dikë që sapo ka shpëtuar prej robërisë, kjo qetësi është edhe më e ndjeshme."

"Është e vërtetë," tha Eremiti. "Edhe unë kam qenë i zënë rob dikur."

"Me të vërtetë o njeri i mirë! Ku, tek të pafetë?"

"Tek të pafetë, o peligrin i butë?"

"A keni qenë në Adrianopojë?"

"Pengmarrësit e mi nuk ishin muslimanët," u përgjigj Eremiti, "por armiq shumë më të rrezikshëm. Ishin pasionet e mia djallëzore. Ishte koha kur syri im shndriste si i juaji, peligrin i butë, ndërsa zemra ime nuk ishte aq e pastër."

"Zoti është i gjithëmëshirshëm," tha Iduna dhe shtoi, "pa ndihmën e Tij, edhe më të fuqishmit nuk janë asgjë tjetër veçse hije."

"Kështu qëndro," u përgjigj Eremiti, "dhe do ta meritoni më shumë dashurinë se sa mëshirën e Të Madhit. Plot tridhjetë vjet të gjata i kam kaluar në vetmi, duke medituar për të kaluarën dhe përsëri ajo mbetet një temë e bollshme dhe pjellore për të ardhmen. Orët e mia të jetës nuk janë kurrë të rënduara dhe shqetësimi im i vetëm është sesi të sillem dhe si të veproj me njerëzit e tjerë. "

"Sa shumë duhet të keni parë, o njeri i mirë!?" i tha Iduna.

"Kam parë shumë por ndjerë edhe më shumë. Prapëseprapë ju ndoshta do të mendoni se rezultati i tërë përvojave të mia është shumë i vogël. Por unë dua të them vetëm diçka: Kurrë mos i besoni vetes tuaj."

"Kjo është një e vërtetë e madhe," vuri re Iduna, "por kjo të çon tek një tjetër e vërtetë edhe më e madhe."

"Po ashtu është," u përgjigj Eremiti. "Ne bëhemi shumë të zgjuar kur plakemi. Ja, njësoj si ky lum në dimër i cili është plot me ujë por në verë thahet. Kështu edhe zjarri i rinisë, njësoj si dielli që bën të avullojë ujin dhe ta **mejë** rrëkenë, ashtu shuhet dalëngadalë nga pleqëria."

Iduna nuk u përgjigj. Eremiti i tërhoqi vëmendjen tek një copë tokë e mbjellur në anën tjetër të bregut të lumit.

"Çdo mëngjes ngrihem dhe ndjej kënaqësinë e bujarisë së pakufishme," gati sa nuk bërtiti ai. "Dje ju provuat mjaltin dhe peshkun që ju servira. Sot do t'ju ofroj diçka të rafinuar dhe të shijshme. Do ta thejmë mëngjesin në një luginë shumë të këndshme. Ti pusho këtu, rinush i butë ndërsa unë do të thërras vëllain tënd për të ngrënë së bashku. Kam vënë re se ai nuk ka një shpirt aq të lumtur sa i juaji.

"Ai është më i madh dhe ka parë më shumë," u përgjigj Iduna.

Eremiti tundi kokën dhe duke u mbështetur tek krruta e tij u kthye tek shpella. Iduna mbeti e ulur mbi një gur të mbuluar me myshk duke dëgjuar zogjtë që po zgjoheshin dhe duke medituar për fatin e Iskanderit. Ndërsa ishte zhytur në këto persiatje dhe ëndërrime, dikush e thirri me emër. Ajo ngriti sytë dhe u skuq e tëra kur e pa Nikeas-in.

"Si e kam mikun tim të embël? bërtiti Princi i Athinës.

"Aq mirë sa shpresoj të jeni edhe ju, i dashur Nikeas. Ne me të vërtetë ishim me fat që gjetëm një mikpritës kaq të sjellshëm."

"Mendoj se mund të përgëzoj për sigurinë që ke treguar," tha Princi. "Ky shteg i pashkelur do të na çojë brenda dy ditëve në Epir. Prandaj nuk i frikësohem ndjekjes së mëtejshme."

"Veprat dhe jo fjalët do të tregojnë në të ardhmen se sa shumë të detyrohem ty," tha Iduna. "Gëzimi im do të jetë vërtetë i tillë vetëm atherë kur babai im të mësojë se kam shpëtuar. Ah sikur bashkëudhëtari ynë i ndjerë të ishte dhe të gëzonte me ne."

"Mos ke frikë mikja ime," u përgjigj Nikeas. "Unë besoj në fatin e mirë të Iskanderit."

"Nëse dikush do t'ja dilte në rrethana të tilla, pa asnjë dyshim që është ai," ia ktheu Iduna. Por ajo ndeshje e vuri fatin e tij në sprovë e tmerrshme."

"Dëgjomë, e dashur zonjushe, le t'i flakim tutje mendimet e zymta!"

"Ne mundemi që thjesht dhe vetëm të mendojmë për të" tha Iduna. "Por kur të kthehemi mbrapa dhe të gjykojmë se sa shumë është e ndërvarur jeta e tij nga ai çast, atherë si mund të jemi të gëzuar ne?"

"Jeta ime duhet të jetë e tillë kur jam pranë Idunës," u përgjigj Nikeas.

E bija e Huniadit mblodhi myshk nga gurët dhe i gjuajti mbi valët e ujit të lumit.

"Zonjushe e dashur!" iu drejtua Princi i Athinës, pasi u ul pranë saj dhe i mori dorën. "Më fal, nëse në këtë moment një ndjenjë e papërmbajtshme më shtyn ta hap përsëri një bisedë e cila, shpresoj se nuk do të jetë aq e pakëndëshme për ty si dhe më përpara kur shprehët atë pakënaqësi. Oh! Iduna, Iduna! Më e mira, më e dashura! E sheh, ne përsëri jemi bashkë. Edhe një herë shih përmbi atë formë të padepërtueshme dhe dëgjoje muzikën e atij zëri të mrekullueshëm. Të kërkova me ngulm e ndoshta e shkela edhe besën time. Të kërkova, të kërkova dhe më në fund të gjeta në robëri dhe në pikëllim. Më fal mua, mua të varfërin, Iduna! Oh! Iduna, nëse është e mundur, më duaj!"

Ajo e tundi kokën dhe ia hoqi sytë.

"Është e pamundur të mos i dua shpëtimtarët e mi," u përgjigj ajo, me një zë të mekur dhe të dridhur. "Si mund të mos pranoj kërkesa që shprehin mirësi prej Princit të Athinës? Por unë nuk isha e përgatitur t'i kthehesha edhe një herë temës më të dhimbshme të bisedave tona, në çfarëdo rrethanash që do të përsëritej ajo, dhe aq më pak në këtë që jemi sot."

"Mjerisht," u përgjigj Princi, unë nuk mund ta kontrolloj pasionin tim. Jo thjesht lumturia por vetë jeta ime është e varur tek ajo nëse Iduna bëhet imja ose jo. Rri me mua, e dashura ime, rri me mua! Po të ishe ti në vendin tim, edhe ty do të nevoitej kjo fjalë."

"Ju lutem pushoni!" bërtiti Iduna, me një zë të vendosur. Ajo e tërhoqi dorën nga e tija dhe u ngrit rrëmbimthi.

"Këtu nuk është vendi dhe as koha për një bisedë të tillë." iu kthye e nervozuar.

"Unë nuk kam harruar që vetëm disa ditë më parë isha një robinë e pashpresë. Nuk harroj që edhe tani jeta dhe fama ime janë në rrezik. Më është ofruar mëshirë dhe ndihmë e jashtëzakonëshme, por prapëseprapë unë ende kam nevojë për ndihmën

qiellore. Tjera fjalë duhet të dëgjoja prej teje i dashur Nikeas," vazhdoi ajo në një ton më të butë.

"Ju i keni hyrë një sipërmarrje sa heroike aq edhe fisnike. Përmbusheni atë me po të njejtin shpirt ju lutem!" i tha Iduna me një ton lutës.

Ai do të ishte përgjigjur, por në atë moment, shtaga e Eremitit kërciti përmbi gurë. Krejt i hutuar dhe i ngulfatur nga forca e pasionit, Princi i Athinës u largua prej Idunës dhe u ngjit me vrap drejt pjesës së epërme të asaj luginëze për të fashitur zemërimin dhe zhgënjimin që e kishte kapluar.

"Hej djalosh i mirë," thirri Eremiti. "A nuk do t'i bashkohesh vëllait tënd? Unë ende nuk ua mësova emrat. Si quhet ai?"

"Nikeas, o njeri i mirë."

"Hm, sa mirë, po ju si quheni?" këmbënguli ai në të tijën.

Iduna u skuq dhe hezitoi të tregonte por më në fund, ashtu siç ishte e hutuar, i tha emrin e parë që i erdhi në mëndje.

"Quhëm Iskander," shqiptoi ajo si nëpër dhëmbë emrin e njeriut që i rrinte në mendje.

"Nikeas! Iskanderi dhe unë po të presim!" thirri Eremiti.

Iduna u dridh e tëra. Ajo u habit, por u ndie e gëzuar kur pa se Princi u kthye me një buzëqeshje në fytyrë dhe u ul për të ngrënë vaktin me shumë fjalë të gëzueshme.

"Tani unë propozoj që ju dhe vëllai juaj Iskanderi të qëndroni disa ditë me mua nëse me të vërtetë ajo që ju ofroj unë ju pëlqen," tha Eremiti.

"Ju falenderoj shumë njeri i shenjtë," u përgjigj Nikeas, "por çështjet tona janë të një natyre shumë urgjente. Në të vërtetë as që do të kishim qëndruar këtu po mos të ishte për vëllain tim më të ri, Iskanderin, i cili, siç mund ta shihni edhe ju lehtësisht, është shumë pak i mësuar me tendosjet e kohëve të fundit. Por neve na duhet të ecim para se të perëndojë dielli."

"Me ne do të vijnë dhe do mbeten kujtimet më të mrekullueshme të mikëpritjes tuaj" shtoi Iduna."

"Zoti qoftë me ju ngado që të shkoni!" u përgjigj Eremiti.

"Besimi im është me të, i qofshim falë", e ritheksoi Iduna.

Kapitulli 15
Nikea dhe Iduna mysafir tek prifti Kristo.

Dy orë para perëndimit të diellit, pasi i shaluan mirë e mirë kuajt tashmë të pushuar, Nekeas dhe Iduna ikën nga shpella e Eremitit. Ata u ndanë plot me fjalë të ëmbla dhe morën rrugën e tyre përkrah bregut të Lumit. Ecën nëpër dritë dhe nëpër terr deri sa u shfaq hëna nën ndriçimin e zbetë të së cilës udhëtuan deri sa ngjitën zinxhirin e fundit, atë më të lartin e majave të maleve aty nga agimi i ditës tjetër. Drita e bukur e mëngjesit zbuloi për ta fushat e harlisura të një vendi të krishterë. Me njëfarë gëzimi të dyjëzuar ata zbritën drejt tokash të mbjella me lloj lloj bereqetesh.

Ata u ndalën në një fshat të bukur të lulëzuar plot me orkide dhe zabela ullinjësh. Princi i Athinës menjëherë kërkoi të takonte priftin ose kryeplakun e fshatit. Dikush që qëlloi aty i çoi ata drejt shtëpisë së priftit por ai nuk gjëndej aty pasi kishte vajtur tek vreshta. Pasi e la Idunën me familjen e priftit, Nikeasi shkoi ta kërkonte vetë. Vreshta ishte mbushur plot me njerëz, secili i zënë me punët e stinës duke mbledhur gjithë shend e verë rrushin dhe të lashtat. Disa kishin mbështetur shkallët mbi degët e rënduara dhe vilnin vilat e rrushit dhe i hidhnin nëpër kosha. Vajzat këndonin si në kor. Ato ishin veshur me përparset ku mblidhnin rrushin që shndriste si margaritar. Në qendër të vreshtës, një burrë i moshës së mesme vështronte i qetë krejt atë çfarë ndodhte dhe i nxiste të rinjtë dhe ata të papërvojë të punonin edhe më shumë.

"Kristo," thirri Princi i Athinës, kur iu qas atij. Prifti u kthye, por u pa qartë se nuk e njohu menjëherë personin që e kishte thirrur.

"E shoh," vazhdoi Princi, "që shqetësimi që më brente se mos më njihnin me këto rroba të çuditëshme paska qenë i kotë. Kjo rrobë qenkërka një maskë e vërtetë."

"Princi Nikeas!" thirri prifti.

"Asnjë fjalë, Kristo!" u përgjigj Princi. "Për ti rënë shkurt, kam kapërcyer malet e Rumelisë dhe vetëm tani mundem ta besoj se do të arrij atje ku dua. Kam edhe një mik me vete. Nuk dua ta dijë asnjeri. Më kupton? Është çështje shtetërore. E marr si të mirëqenë faktin se këtu nuk gjëndet askush që më njeh pas këtyre tre vitesh mungese dhe siç jam i veshur me këtë rrobë i bërë tebdil."

"Ndjehuni i sigurtë, zoti im," u përgjigj Kristo. "Kur arritët të më lajthitni mua që të kam njohur që kur ishe jo më i madh sesa ky kalavesh rrushi, ju me siguri që me të tjerët do ta keni shumë më të lehtë.

"Në rregull atëherë. Unë do të qëndroj këtu një ose dy ditë me qëllim që tu jap atyre mundësi për tu përgatitur për pritjen time. Ndërkohë, është e domosdoshme që menjëherë të dërgojmë një korrier atje. Ju duhet t'i bëni tëra këto për mua, Kristo! Oh më fal se desh harrova, po vajzat si janë?" e ktheu bisedën ai.

"Eh, ashtu kështu, Naltmadhnia Juaj," u përgjigj Kristo. "Një burri me shtatë vajza i dalin telashe çdo ditë të javës."

"Por jo kur janë aq të bukura sa vajzat tua!?"

"Epo, një njeri i pashëm për vete thotë përherë gjëra të bukura për të tjerët. Sa i takon Aleksinës, ajo do që të martohet."

"Shumë normale është kjo. Le të martohet, pse jo?" ia ktheu Nikeas.

"Por pastaj vjen Helena e cila dëshiron të bëjë të njejtën gjë," tha prifti.

"Edhe më normale, sepse ajo është edhe më e bukur. Po të pyetesha unë, do t'i martoja që të dya," iu përgjigj Nikeas.

"Aj, aj, aj, kjo është edhe më mire sepse kush është vetë i bukur vetëm gjëra të bukura thotë. Nuk kam kundërshtim për Aleksinën që të martohet dhe madje as për Helenën, por ja tek na del edhe Laisa"

“Ha ha ha!,” shpërtheu në të qeshura Princi. “E shoh i dashur Kristo, që motrat e mia të adoptuara iu japin juve shumë kokëçarje. Megjithatë, tani më duhet të shkëputem për të shkuar tek bashkëudhëtari im. Eja sa më parë të mundesh i dashur mik, që të rregullojmë çdo gjë. Paç vjelje sa më të bollshme për vete dhe sa më pak dhelpërira për të tjerët! ” Pasi i tha këto, Princi u largua.

“Mirë! Kujt do ti shkonte mendja se do ta shihnim atë këtu?” bërtiti prifti i vyer. “I njejti qenush i gëzuar si përherë! Me çfarë qenka marrë atje në Rumeli? Çështje shtetërore më tha!? Me të vërtetë? Sido që të jetë, unë do ti rri epifanisë time e cila më thotë se çfarëdo të jenë ato çështje, në fund të fundit një vajzë e bukur është dhe duhet të jetë në këtë mes.

Kapitulli 16
Mashtrimi i Nikeas: Iduna në Kështjellën e "Justinianit" në Kallishtë.

Më në fund, Iduna e mrekullueshme pas tërë këtyre vuajtjeve dhe rreziqeve, më në fund u vendos në një shtëpi e të tillë e cila të paktën kishte një çati. Aleksina, Helena, Laisa dhe motrat tjera nxitonin t'ja kalonin njëra tjetrës për t'i tërhequr vëmëndjen dy "vëllezërve", e sidomos atij më të riut.

Mirësjellja e tyre bëhej pak qesharake prej kuriozitetit që prisnin ta shuanin me padurim nga përgjigjet e Idunës. Vajza e Huniadit mundohej të jepte përgjigje me sa më shumë kujdes. Vajzat mundoheshin të bëheshin sa më interesante përpara "tij". Helena iu përgjigjej pyetjeve të Aleksinës ndërsa Laisa atyre të Helenës. Krejt çfarë duhej të bënte Iduna ishte të qeshte, të mos fliste dhe të tregohej sikur Iskanderi ishte i pashëm, por edhe i turpshëm. Kur Nikeas e takoi Idunën, në mbrëmjen e ditës së dytë të qëndrimit të tyre aty, e njoftoi atë se kishte qenë aq me fat sa të rikthente një miqësi të herëshme me një bashkëudhëtar të vjetër të armëve, një fisnik i cili i kishte ftuar të pushonin në kështjellën e tij. Po ashtu ai i tregoi Idunës se kishte dërguar një korrjer në Krujë që ta njoftonte Iskanderin dhe shpresonte se brenda disa ditëve do të sillte informacione të fshehta për të parë se çdo të bëhej në të ardhmen. Pra a duhej që ata të niseshin menjëherë drejt kryeqytetit të Epirit apo të shkonin në Bullgari, në rast se Huniadi ishte ende në fushatë? Pas kësaj ata u nisën në udhëtimin e tyre. Nikeas kishte porositur një karrocë për Idunën, pasi iu paraqiti një pretekst për shendet të dobët të saj tek Aleksina dhe motrat e saj. Ata u shoqëruan prej një trupe të vogël kavalerie të armatosur mirë, pasi sipas të dhënave që kishte Nikeas, vendi ende ishte i përfshirë në trazira. Me të zbardhur dita, Nikeas dhe Iduna u nisën për rrugë. Një orë pas mesditës ata pushuan tek një pus uji, i rrethuar prej ullinjësh dhe pritën deri sa kaloi ajo vapa e tmerrshme. Më pas ia hypën përsëri kuajve dhe u nisën në një rrugë me kthesa mespërmes kodrave të gjelbërta që pjesërisht ndërthureshin me fushën e gjërë. Kur po perëndonte Dielli, Princi i Athinës e tërhoqi perden e karros dhe kërkoi që Iduna të shihte një kështjellë të mrekullueshme që ngrihej mbi një kodër pranë një fushe pjellore dhe që konturohej qartë prej dritës së zbehtë të ditës që po shkonte drejt errësimit.

"Unë kam frikë se miku im Justinian nuk është kthyer në kështjellë. Por ne jemi miq të vjetër dhe ai dëshiron që unë të veproj si shërbëtori juaj. Jam i sigurtë që ai për hatrin tim do të bëjë gjithçka që ti të kënaqesh."

"Qenka me të vërtetë një kështjellë e mrekullueshme," u përgjigj Iduna, "dhe askush përveç një kalorësi të vërtetë nuk e meriton një vepër të tillë."

Ndërkohë që ajo po fliste**,** komandanti i grupit shoqërues i ra borisë dhe ata filluan të ngjiteshin thikë përpjetë në një rrugë me kthesa. Ata i ranë shkurt mespërmes një pylli të veshur me bimë nga ato që rrinë përherë të gjelbërta. Ngjitja e vështirë dhe graduale i çoi tek një mur e rrethuar me bedena që i jepnin formë në horizont krejt fortesës. Aty gjetën disa ushtarë roje dhe komandantin e tyre. Portat e kështjellës u hapën dhe kryeshërbëtori, i shoqëruar prej një suite të përbërë prej shumë shtëpiakëve, bënë përpara duke iu uruar Nikeas dhe Idunës mirëseardhjen. Princi i Athinës zbriti nga kali dhe e ndihmoi *bashkë-udhëtarin* të zbriste nga karroca. Paralel me grupin shoqërues dhe të prire prej krye-kujdestarit ata hynë në kështjellë. Pasi kaluan nëpërmjet të një holli të mrekullueshëm me mure të veshura me piktura dhe armë të zgjedhura të varura aty këtu, i zbritën shkallët prej mermeri Pentelic. Aty, të shoqëruar ecën drejt një suite me dhoma me tavane të larta, të dekoruara me ornamente të bukura, shtruar me qylyma oriental dhe të mobiluara me shumë kolltuqe dhe dollape të

shtrenjtë. Ndërkohë që admironin një spektakël kaq të ndryshëm nga gjithçka që kishin parë dhe përjetuar deri tani ata, kryeshërbëtori i shoqëruar prej një numri sherbëtorësh të veshur në rroba të shndritshme, bëri përpara dhe iu ofroi atyre pije të freskëta dhe të zgjedhura, kafe dhe embëlsira, sherbet dhe verë të thartë.

Pasi i bënë formalitet e para të njohjes, Nikeas duke u ndjerë i afërt me kryeshërbëtorin, i tha që Lady Iduna ndoshta duhej të pushonte dhe menjëherë një kryeshërbëtore e shoqëruar prej vajzash nga më të bukurat, secila duke mbajtur në dorë një pishtar aromatik prej trandafilash, ecën drejt Lady Idunës dhe e ftuan atë të shkonte me to drejt apartamentit të saj. Kryeshërbëtorja dhe shoqëruesit e saj e dërguan vajzën e Huniadit poshtë tek një galeri e gjatë, e cila i çonte tek dhoma më e bukur e kështjellës. Aty ishte një paradhomë si një tendë, e pikturuar, e mbushur me tingujt e cicërimave të zogjëve të gjallë. E dyta, e cila ishte shumë më e gjërë, ishte tërësisht e rrethuar me pasqyra veneciane. Të vendosur mbi qylyma persianë gjëndeshin shumë kolltuqe kadife, all të kuqe, të mbuluar prej cohash shumë të kushtueshme. Dhoma e tretë ishte një banjo, e bërë në trajtën e një guacke gjigande. Çatia ishte e bërë me alabaster dritëpërçuese që përflakej prej dritëhijeve që vezullonin.

Kapitulli 17
Arritja e Idunës në Kështjellën e Princit

Një breshëri tingujsh të trumpetave njoftoi ardhjen e Lady Idunës dhe Princit të Athinës. Ata ishin veshur si për ceremoni dhe kaluan përpara të pranishme të buzëqeshur. Iduna ishte veshur për banketin me rrobat e gjinisë së saj, madje ndoshta të vendit të saj, dhe dukej se nuk mund të mos ndikohej dhe të shfaqte edhe entusiazëm nga ky ndryshim i papritur i rrethanave dhe veçanërisht kalimi i mënjëhershëm nga një jetë me vështirësi të jashtëzakonëshme, rreziqe, vuajtje dhe mungesa të mëdha tek luksi, siguria dhe kënaqësia. Ata ishin ngritur shpirtërisht madje ndiheshin të gëzuar dhe ajo buzëqeshte me Nikeas-in me simpati dhe gëzim. Ata festuan atë mbrëmje, dëgjuan muzikë të ëmbel, folën për aventurat e tyre dhe prej asaj gjallërie dukej sikur u harrua për një farë kohe edhe vetë fati i Iskanderit.

"Nuk kalojnë dy ose tre ditë dhe do të mësojmë diçka më shumë për këtë çështje," tha Nikeas. "Në ndërkohë, një pushim për ty Iduna është absolutisht i domosdoshëm. Tani do të keni kohë ta ndjeni edhe më shumë lodhjen e asaj që keni përjetuar. Nëqoftëse Iskanderi ka arritur në Krujë, jam i sigurtë se ai tashmë e ka njoftuar babain tuaj për ty. Por nëse ai nuk ka arritur, unë kam rregulluar që të niset një korrjer nga ai qytet për tek Huniadi. Prandaj mos rri në ankth. Përpiqu të jesh e lumtur, Iduna! Unë vetë jam i sigurtë që çdo gjë do të shkojë më së miri."

"Eja, më jep fjalën duke u betuar mbi këtë Kupë të Tenedos dhe në shëndetin e babait tënd, zonjushë e mrekullueshme!" i tha Nikeas.

"Po nga ta di unë që në këtë moment ai nuk është në çastin e vdekjes" u përgjigj Iduna. "Kur nuk jam me ata që i dua, jetoj vetëm me frikën e fatkeqësive që mund t'ju ndodhin atyre." vazhdoi ajo.

"Në këtë moment ndoshta edhe ai e mendon burgosjen tënde prej barbarëve. Përsëri sa gabim! Hiqe mendjen prej gjërave të këqia!" iu kthye Princi.

"Si të dëshironi, nëqoftëse nuk kushton aq shumë sa dhurata për një mikëpritës," tha Iduna. "Po kur mendoni se fisniku juaj Justinian do të vijë?"

"Oh! Mos e vër re atë," tha Nikeas. "Ai do të kishte arritur nesër, por lajmi i madh që i dhashë mund t'ja ketë ndryshuar planet. Unë i tregova atij për pushtimin që po na kanosej. Siç duket ai e ka parë të nevojshme t'i vizitonte prijësit fqinjë ose edhe të vazhdonte udhëtimin drejt Krujës."

"A do vijë ajo ditë kur të jem në kampin e babait tim?" tha Iduna.

"Shpejt do të jemi atje, e dashur zonjushe," u përgjigj Princi. "Eja, i vlefshmi im," shtoi ai duke iu kthyer kryeshërbëtorit, "pi edhe ti për lumturinë e takimit të kësaj zonjushe fisnike me miqtë e saj!"

Kapitulli 18
Dashuria e pafat e Nikeas.

Kaluan katër ditë në kështjellën e Justinianit, në të cilat Nikeas bëri tëra përpjekjet për t'i hequr ankthin Idunës. Një ditë e kaloi duke bërë vizita, një ditë e argëtoi me një shfaqje fajkojsh, ditën e tretë e dërgoi tek rrënojat e një tempulli aty pari dhe i lexoi autorin e tij të dashur, Eskilin, nëpër rreshtat e kollonave antike. Askush nuk mund të ishte aq miqësor dhe zbavitës me Idunën sa Nikeas, dhe ajo vetë vështirë se mund të mos ia njihte tërë këto virtyte dhe favore atij. Korrjeri ende nuk ishte kthyer nga Kruja, por Nikeas vazhimisht gjente arësye të ndryshme bindëse për mos ardhjen e tij. Megjithatë vonesa u bë kaq e padurueshme dhe e bezdisshme për Idunën sa erdhi një moment kur ajo u detyrua t'i propozonte Princit të Athinës se ata duhej, pa asnjë vonesë, të niseshin drejt Krujës. Sa më shumë argumente bindëse në favor të qëndrimit të tyre në kështjellë sillte Nikeas, aq më shumë Iduna këmbëngulte në kërkesën e saj.

"Në të vërtetë, i dashur Nikeas," i tha ajo në njërën prej këtyre ditëve, "ankthi për të parë babain tim ose për të dëgjuar prej tij është kaq i madh sa që gati nuk ka rrezik të cilin nuk do ta ndërmerrja përsipër thjesht dhe vetëm për ta plotësuar këtë dëshirë. Më duket sikur të kam rënë në qafë më tepër se duhet. Por ne nuk jemi më në një vend armik, ku nevojiten roje dhe udhërrëfyes. Prandaj, më ler të iki e vetme!"

"Iduna!" thirri Nikeas, qortueshëm. "Mjerisht! Iduna, ju jeni mosmirënjohëse dhe unë nuk e prisnja këtë prej teje!"

"I dashur Nikeas!" u përgjigj vajza, "ju vazhdimisht më keni keqkuptuar! Do të ishte kënaqësi e pafund që të kthehesha vetë tek babai im, Huniadi. Jetojmë në kohëra jo të zakonëshme ndërkohë që edhe ju nuk jeni një person i zakonshëm. Ju harroni që është dikush që ka pretendime më të mëdha ndaj jush, madje më shumë se sa një vajzë, sado e harlisur që të jetë. Ai dikushi është vendi juaj. Nuk ka rëndësi nëse Iskanderi do të jetë në Krujë apo jo. Rëndësi ka që Epiri dhe Greqia kërkojnë praninë dhe përpjekjet e Princave të tyre. Dhe ti ke pjesën tënde të përgjegjësisë, apo jo?"

"Unë nuk kam atdhe," u përgjigj Nikeas, trishtueshëm, "dhe asnjë gjë të cilës t'i detyrohem."

"Nikeas"! Bërtiti Iduna. "A jeni ju ai poeti patriot i cili dje mëtonte t'i ngjante Themistokliut?"

"Mjerisht po Iduna! Por dje, ju ishit muza ime. Nuk besoj se jeni lodhur nga kjo kështjellë," vazhdoi Princi me një ton melankolik. "Ky vend nuk paska asgjë interesante për ty! Ndërsa por për mua, përmban krejt çfarë është më e dashura dhe më e vyera. Zonjushë e urtë, do të mjaftonte një buzëqeshje jotja që unë ta recitoja dhe madje ta rivalizoja Themistokliun."

Ndërsa u thanë këto, ata po ecnin së bashku në hollin e kështjellës kur Iduna kaloi anash dhe bëri sikur po vështronte me vemendje një mburojë. Nikeas iu afrua dhe i vendosi butësisht krahun mbi shpatulla dhe kështu së bashku u larguan që aty.

"Më e dashura Iduna," tha ai, "më fal, por unë besoj se ju e dini që çdo burrë lufton për fatin e vet. Qënka shkruar që fati im të bjerë në dorën tënde. Ekziston një luftë midis mizerjes dhe lumturisë, lavdisë dhe turpit. As mos prit që unë ta braktis fatin tim për një të ardhme të shndritshme pa bërë asnjë përpjekje. Edhe njëherë po i bej thirrje mëshirës tënde, dhe nëse ajo nuk përgjigjet, atëherë dashurisë tënde. Sikur Iduna të bëhej imja, sikur ajo të qëndronte dhe të ishte vetëm e imja, atëherë do të betohesha solemnisht se nuk ka pengesë që mos ta kapërcej, nuk ka karrierë që mos ta realizoj, nuk ka asgjë që do të më pengonte për të arritur qëllimet e mia. Por kjo siguri,

ose kjo pasiguri, nuk di si ta them, më bën të deklaroj se unë nuk mund të ekzistoj pa këtë qëllim i cili tani është i vetmi i jetës time. Prandaj po të bie në gjunjë që ti të më mundësosh që ta arrij atë dhe këtë ta bësh vetëm për mua."

"Nikeas," tha Iduna, "kjo ripërsëritje e vazhdueshme e një teme të ezauruar tregon një zemërngushtësi të jashtëzakonëshme nga ana jote."

"Ah medet! Iduna! Ju e kuptoni se jeta ime varet tek një fjalë e jotja, të cilën shoh se ju nuk doni ta shqiptoni dhe pastaj guxon dhe më flet për zemërgjerësi. Jo! Iduna, nuk është se unë jam zemërngushtë."

"Atherë më ler të them se je i pa-arësyeshëm, Princi Nikeas." iu kthye ajo.

"Thuaje si të duash ti vetë, Iduna, por le ta marrim si të mirëqenë se do të thuash se jeni e imja."

"Më fal zotëri, unë jam njeri i lirë tani, apo jo?"

"E lire? A po më nënvleftëson mua ti Iduna? Kujt ja dedikoni këtë liri ju?"

"Kjo nuk është hera e parë që ju po më kujtoni një detyrim, kujtimi i të cilit është gdhendur thellë në ndërgjegjen e jetës time në mënyrën më mbresëlënësë. Madje edhe kjo bisedë aspak e këndshme nuk më bën dot të ndjehem më pak mirënjohëse se sa jam. Unë kurrë nuk mund të harroj krejt çfarë iu është dashur ty dhe mikut tend të bëni për lirinë time," vuri në dukje Iduna.

"Miku im!?" u përgjigj Princi i Athinës, i zbetë dhe i nervozuar. "Miku im? A duhet të ma përmendësh çdo herë mikun tim?"

"Nikeas!" iu kthye Iduna. "Nëse ke harruar se çfarë ishte e mirë për mua, të paktën përpiqu të kujtosh çfarë është e mirë për ty, vetë?"

"Qënje e bukur!" thirri Princi, duke iu afruar dhe duke i marrë dorën me pasion. Më fal! Më fal!" u përgjërua ai. "E kupton besoj se unë nuk e kontrolloj dot më veten. Unë jam asgjë! Unë jam asgjëja nëse Iduna shfaq të tillë mëdyshje!"

"Nuk ka vend për mëdyshje këtu, Nikeas," iu përgjigj Iduna me kokë ulur, "prandaj dëshiroj dhe kërkoj që kjo bisedë të mbyllet këtu dhe mos të hapet më kurrë."

"Atëherë ta tregoj unë ty, vajzë fodulle," shpërtheu Princi i Athinës që kishte dalë nga kontrolli i vetvetes, duke kërcëllitur dhëmbët dhe shoqëruar fjalët me veprime të dhunshme. "Unë nuk mund të përçmohem kështu dhe të mos bëj asgjë, ndërsa ti ta kalosh këtë kaq lehtë. Iduna është imja, imja dhe e askujt tjetër në këtë botë!"

"Të jetë e vërtetë kjo që po përjetoj apo jam në ëndërr?" bërtiti vajza e Huniadit. "Vërtetë erdhi puna deri këtu? O Zot, po edhe unë pse habitem? A nuk e kam njohur këtë njeri se kush ishte që prej shumë kohësh? Mirë atëherë, unë që nga ky çast do të iki nga kjo kështjellë!" kercënoi ajo.

"Do ta bëje nëse nuk do të ishe e burgosur," iu përgjigj Princi me qesëndi dhe u mbështet tek armët e varura në mur.

"E burgosur?" thirri Iduna duke ngritur zërin në kupë të qiellit. "Unë e burgosur? Atherë unë do t'ju sifdoj juve. Në këtë kështjellë ju jeni vetëm një mysafir, siç jam edhe unë. Unë do të ankohem tek kryeshërbëtori, në mungesë të pronarit të kështjellës. Ai kurrë nuk do të lejojë që nderi i flamurit të të zotit të tij të dhunohet prej një djaloshi pasionant, kapriçioz dhe të pa arësyeshëm!"

"Për cilin zot e keni fjalën?" pyeti Nikeas.

"Për mikun tënd, Lordin Justinian," u përgjigj Iduna. "Vështirë se mund ta pranojë ai një shpërdorim të tillë të mikpritjes së tij?"

"Miku im, Lordi Justinian!" u përgjigj Nikeas, me një nënqeshje tallëse. "Unë jam i habitur se si një personazh i persekutuar aq keqas siç ishte Lady Iduna të mashtrohej kaq lehtë prej një 'djali pasionant!" Vërtetë paskeni besuar ju, qoftë edhe për një moment, se ka ndonjë zot tjetër të kësaj kështjelle përveç skllavit tënd të devotshëm që ke përpara?"

“Çfarë, çfarë!” klithi Iduna, vërtetë e frikësuar.

“Në fakt unë kam nderin ta kem Ledy Idunën mysafiren time,” vazhdoi Nikeas, me një ton shumë të hidhur. “Këtë kështjellë në Kallishtë, më e bukura në tërë Epirin, e trashëgoj nga mëma ime. Kohët e fundit rrallë e kam vizituar atë. Por tani kjo do të bëhet rezidenca ime e dashur, e imja, nëse do të ndodhë, siç shpresoj unë që të bëhet edhe vendi i ceremonisë tonë martesore.”

Iduna pa rreth e rreth si e mahnitur, pastaj u hodh mbi një kolltuk dhe shpërtheu në lotë. Princi i Athinës vërtitej lart e poshtë hollit në një gjëndje ku mungonte plotësisht qetësia edhe pse nuk kishte asnjë zhurmë.

“Besëthyer!” Bërtiti Iduna në mes të dënesëve.

“Lady Iduna!” pëshpëriti Princi duke iu qasur pranë. “Dëgjomë me qetësi! Unë nuk do të përpiqem të fsheh këtë mashtrim të cilin e bëra i dehur nga hijeshia jote. Vetëm ajo mund ta frymëzonte, madje edhe ta justifikonte këtë mashtrim. Dëgjomë mua Lady Iduna, të dua me një pasion që më ka shoqëruar gjithë jetën që kur të kam njohur. Tek e fundit, vendi ku kam lindur dhe rangu që kam madje edhe fati im nuk janë pengesë që unë të bashkohem me një vajzë si kjo e të Madhit Huniad. Nëse pretendimet e mia personale nuk do t’i shkonin për shtat përsosmërisë tënde, atëherë cili Princ në botën e krishterë do të meritonte ty? Unë jam i ri. Zonjushet e oborrit më quajnë të pashëm. Për babain tënd dhe nderin tuaj i kam thyer disa shtiza. Madje edhe ti e dashur Iduna njëherë e një kohë ke thënë se unë isha i mençëm. Eja, eja, kij mëshirë! Bëje Athinën time të bukur të pranojë një zonjushe si ty! Një at i shenjtë është në gatishmëri e dashur zonjushe. Eja dhe qeshu! Brenda disa ditësh do të arrijmë tek kampi i babait tuaj dhe pastaj do t’i ulemi në gjunjë, siç bëj unë tani, dhe t’i kërkojmë dorën për bashkimin tonë të përjetshëm!”

Pasi i tha këto, ai ra në gjunjë dhe ja mori dorën me forcë duke ia ngulur sytë mu përpara si i çartun. Por ajo tregonte vetëm pikëllim dhe zymtësi.

“Nikeas, qenka e kotë të kërkoj bujarinë tënde. Po të them se nuk ja vlen të flasim për të kaluarën, por as të qortoj për të tashmen. Unë jam një vajzë e vetme dhe e shtypur, por gjëja më e fundit që mund të pranoj është të përndiqem. Nikeas, mbaje mend këtë: Unë kurrë nuk mund të jem e jotja. Prandaj nga ky çast i dorëzohem të Madhërishmit!”

“Krejt në rregull Iduna. Që nga kulla e kështjellës mund të shohesh valët e Detit Jon. Por ti ke zgjedhur të mbetesh këtu si e burgosur, e mbyllur brenda këtyre mureve, derisa një prej anijeve të vijë prej Pireut dhe të na dërgojë në Itali. Ti do të bëhesh e imja, Iduna! Se në çfarë rrethanash do bëhet kjo, është në dorën time. Vazhdo me kokëfortësinë tënde dhe kështu mund t’i japësh lamtumirën përgjithmonë edhe babait edhe vendit tënd. Bëhu e arësyeshme dhe një fat i madh, i cili mbart me vete çdo gjë që të lumturon ty, të pret!”

Pasi i tha tëra këto, Princi u largua duke e lënë Lady Idunën, në mendimet e saj të trishtuara.

Kapitulli 19
Iduna përsëri e burgosur – Tani në kështjellën e Kallishtës.

Lady Iduna fillimisht kishte prirjen ta shihte sjelljen e Princit të Athinës si një sjellje prej pasionanti me shpërthime kalimtare. Shoqeria e gjatë me të e kishte bërë të besonte se ai sillej, si dhe më parë, si një djalë i llastuar. Por pastaj, sapo ngeli e vetme në apartamentin e saj, kryeshërbëtorja e njoftoj se që nga ai çast ajo duhej ta dinte se ishte e burgosur. Prandaj nuk i lejohej të lëvizte pa lejen e saj. Iduna filloj të dridhej për dhunën e mundshme që mund të pësonte nga një njeri me mendje të tillë të çoroditur. Ajo u përpoq ta tërhiqte kujdestaren në anën e vet, por kjo ishte e pamundur, pasi ajo ishte shumë mirë e përgatitur për të mos bërë asgjë pa miratimin e eprorit të vet. Midis gjërave tjera të burgimit, asaj iu kërkua që të raportonte tek roja i caktuar për ruajtjen e saj, për çdo bisedë që bënte me cilindo në atë kështjellë.

Lady Iduna tani ishte tej mase e trishtuar. Ajo mendonte për babain e saj por nuk i shqitej nga mendja as Iskanderi. E kaluara i dukej si një ëndërr. Shpesh prirej të besonte që ishte ende, madje do të mbetej përherë e burgosur në Sarajet e Adrianopojës dhe se të gjitha incidetet e habitshme që kishin ndodhur kohët e fundit të jetës së saj, nuk ishin gjë tjetër përveçse skena të një ëndrre të keqe dremitje surreale aluçinative. Ishin disa gjëra të vogla, si bje fjala, rënja e këmbanës, disa emblema të shenjta të krishtera ato që e bënë të besonte se ishte në një tokë të Krishterë. Këto e bindën për të vërtetën e tmerrshme që ajo kishte rënë përsëri në robëri dhe që ishte një e burgosur, mjerisht, tani jo prej turqve por prej shoqëruesit të saj të dashur grek të rinisë. Zemërimi ndaj sjelljes së Nikeas ia forcoi vullnetin për të bërë diçka. Ajo vendosi të bënte një përpjekje për të shpëtuar. Dhomat e saj ndriçoheshin vetëm që nga lart. Në fillim mendoi të përvidhej gjatë natës nëpër galeri, por dera ishte kyçur shumë mirë. Pas një prove të tillë, ajo nxitoi të kthehej tek dhoma e saj nën frikën dhe pikëllimin që e bënë të shpërthente në vaj.

Dy herë gjatë ditës shërbëtorët dhe kujdestarja e vizituan Idunën duke i sjellë edhe ushqim. Pastaj ikën dhe në largim e siguruan derën që mos të dilte dot.

Kështu kaloi një javë e tërë. Në mbrëmjen e ditës së nëntë, Iduna u habit kur pa se kujdestarja i solli asaj një letër, e lëshoi në krvat dhe u largua. Iduna e mori letrën me një ndjenjë kurioziteti që në fakt nuk ndillte ndonjë kënaqësi. Kjo ishte e vetmja gjë që kishte ndodhur gjatë robërimit të saj të dytë. Ajo e njohu menjëherë dorëshkrimin e Nikeas prandaj e hodhi për tokë pasi dyshoi se do të ishte ndonjë provokim. Por sërish mendoi me vete se letra duhej lexuar dhe vendosi ta hapte.

Në letër ai e njoftonte se kishte arritur një anije nga porti i Athinës në bregdet dhe se, që nesër, ajo do të nisej për në Itali. Ai i tregonte gjithashtu se turqit nën komandën e Mahomedit e kishin pushtuar Shqipërinë dhe se hungarezët, nën komandën e babait të saj kishin ardhur të ndihmonin Kryqin. Ajo çfarë mungonte në letër ishte se nuk thuhej asgjë për Iskanderin. Por ai i kujtonte se shumë shpejt dikush do ta merrte dhe të niste drejt bregdetit, ta hypnin në një anije dhe ta nisnin për një vend të huaj. Këtu, varej nga Iduna nëse do të ishte aq e mençur sa t'i jepte mundësi Nikeas që ta merrte dhe ta çonte tek i ati dhe që andej t'i bashkohej atij në luftën e madhe për mbrojtjen dhe lirinë e vendit dhe besimit të saj. Letra ishte shkruar me ton urdhërues por jo në mënyrë të pasjellshme. Gjithsesi, në mendjen e Idunës letra lente përshtypjen e një njeriu të vendosur, por të dëshpëruar që e kishte shkruar atë.

Iduna siç ishte e pikëlluar kërceu nga kolltuku dhe e mati dhomën me mend nga një cep në tjetrin, nga dyshemeja në tavan. Një erë e fortë tundi perden dhe e fiku

llampën. Ikja e shërbëtores së fundit për atë ditë tregonte se aty nuk do të kishte ndonjë moment tjetër kur njeriu të ndjehej se ishte gjallë. Errësira ia shton trishtimin edhe më shumë pikëllimit ndërsa drita është qetësuesi më i mire në atë situatë.

Kjo fatkeqësi e pa imagjinuar duket se e mundonte Idunën në mënyrë dërmuese. Pasi lëvizi kuturu nëpër dhomë me shpresë se do të shihte diçka rreth e qark, duke përplasur duart plot me nervozizëm, papritmas vëmëndjen ja tërhoqi një rreze drite që ndriçoi në një pikëz të dhomës. Ajo eci ngadalë dale drejt saj duke i zgjatur duart si në boshllek. Menjëherë e kuptoi se rrezja kishte hyrë nëpëmjet një të çare të një kornize nga njëra prej pasqyrave të mëdha e cila e zbukuronte murin. Sapo e preku kornizën, ajo pa sesi lëvizi me shpëjtësi drejt saj, menjëherë. Sikur të mos kishte qenë shumë e kujdesshme, pasqyra që lëvizi përpara do ta kishte goditur me forcë të madhe në fytyrë por asaj i vajti mendja t'i tërhiqte duart gradualisht dhe i shpëtoj asaj. Vendi që u zbulua prej pasqyrës doli të ishte një mazgalle e formuar prej një dritarje të ngjitur me të. Një grilë prej druri, ose një errësuese ishte aq e ronitur, sa edhe drita hynte tejpërtej pa asnjë pengesë po mos të kishte qenë pasqyra.

Iduna e kapi dorezën dhe pasi e tërhoqi pak si me vështirësi në fillim, dritarja u hap. Robina vështroi me ngazëllim dhe ndjenjë lehtësuese pamjen e mrekullueshme që ju shfaq përpara syve. Poshtë saj trandafilat aromatike në mes të shkurreve të mpleksura ngjyroseshin si me argjend nga drita e asaj mbrëmje. Përpara saj shfaqej një rrafshinë e gjërë e rrethuar prej vargmalesh me maja të mprehta që valëzonin në horizontin me qiell të pastër, ku po formësohej edhe harku i gjysmë hënës së re, si një ogur i mirë kundër pushtuesve muslimanë.

Iduna vështroi e mahnitur atë pejsazh dhe aty për aty mori një vendim të guximshëm për tu arratisur nëpërmjet të mazgallës. Ajo i mbylli sytë me duar për t'i ruajtur mos ia vriste drita të cilën kishte aq ditë pa e parë. Ndoshta ajo për një çast u kënaq në meditimet që e rrëmbyen pas vetes, por pastaj mori në dorë disa çarçafë të lënë mbi kolltuk, i lidhi nyje njëri pas tjetrit së bashku duke krijuar një si litar të gjatë, e shtërngoi rreth këmbës së kolltukut, u kacavjerr në të dhe e lëshoi veten në mëshirën e Virgjinës së Shenjtë. Kështu e bija e Huniadit zbriti me sukses në bahçen poshtë dritares.

Ajo u ndal të merrte frymë dhe t'i gëzohej atij momenti lirie. Ky ishte një veprim i guximshëm i arritur me shumë trimëri. Por rreziku tanimë veç sa kishte filluar. Ajo pa se kishte zbritur në pjesën e pasme të Kështjellës dhe u përvodh në maja të gishtave ngadalë dalë si një drenushë. Aty pa një portë të vogël që po ta kalonte mund të dilte jashtë por që padyshim që ishte e ruajtur mirë. Një roje i vetmuar ishte ulur në gjunjë përpara portretit të Shën Gjergjit ndërsa në krah të tij ishte një calik vere thuajse i zbrazur.

"O Shenjti im!" thërriste roja besimtar, "na ruaj prej të pafeve turq!" Iduna bëri një rreth të kujdesshëm pas tij. "A duhet që njerëzit të cilët nuk pinë verë t'i pushtojnë të krishterët?" vazhdonte roja. Iduna e vuri dorën sipër bravës së derës. "Ne të falenderojmë për të vjelat e bollshme," thoshte roja. Iduna e hapi portën me një prekje të lehtë dhe pa zë, gjë që mund ta bëjë vetëm një dorë femre. "Dhe për hatër të Lordit Iskander!" shtoi roja.

Iduna shpëtoi!

Tani ajo ishte prapë e lirë, por ishte e lirë në vetmi. Ngadalë dale ajo u nis drejt fushës së gjërë me shpresë që të arrinte në ndonjë qytet ose ndonjë fshat përpara se të merrej vesh se kishte ikur nga kështjella. Prandaj nxitoi aq sa mundi me vrap rreth tre orë pa pushim deri sa arriti tek një zabel i mrekullueshëm ullinjësh që mbulonte një fushë të tërë të tej mbushur e cila ndahej në dy degë. Në fund të pyllit të ullinjëve dukej se kishte një shteg. Ajo kaloi nëpër atë shteg dhe eci nëpër të rreth një kilometër derisa

arriti tek një zonë e hapur dhe shumë e gjelbëruar. Në mes të atij vendi gjëndej një strukturë e bukur antike prej mermeri të bardhë e mbështjellur nga dritë-hijet e rrezeve diellore të pasditës dhe një curril uji mijëravjeçar i një shatërvani shumë të njohur.

Po afrohej mesnata. Iduna ishte e strapacuar. Ajo u ul tek shkallët e shatërvanit për të pushuar. Ndërkohë që po mendonte për tërë aventurat e jetës së saj dëgjoi një fështfërime në mes të drurëve dhe e trembur u ngrit dhe u fsheh pas një peme.

Ndërkohë që po qëndronte atje, me zemrën që i drithërohej, figura e fanepsur e një burri iu afrua shatërvanit nga ana tjetër e pyllit të ullinjëve. Ai i ngjiti shkallët dhe vështroi poshtë ujit sikur kishte etje për të pirë. Por në vend që ta bëntë këtë, ai nxori shpatën, e zhyti në ujë tre here dhe të tre herët thirri me zë të lartë emrin e Iskanderit. Pas kësaj Iduna, e nxitur prej një impulsi që nuk i rezistoi dot, doli nga vendi ku ishte fshehur, por menjëherë lëshoi një klithmë kur pa se aty ishte Princi Mahomed!

"O, Natë e Lavdisë!" shpërtheu me emfazë Princi duke ecur drejt saj. "A po e shoh me të vërtetë Idunën! Kjo është me të vërtetë diçka magjike!"

"Largohu! Largohu!" shpërtheu Iduna si e marrosur pasi ja doli të largohej me vrap prej tij.

"I doli fjala hekimit që këtë shushunjë dinake do ta takoja dhe ku më mirë se këtu?" tha Mahomedi, duke e kapur atë.

"Aq mirë sa e deshët edhe ju, përdhunues!" u përgjigj një zë madhështor.

Një figurë e lartë zbriti poshtë nga pylli dhe iu ndërsye turkut.

"Jam këtu për ta plotësuar marrëveshjen time, Princ Mahomed, "tha ai njeri i çuditshëm, duke mprehur shpatën.

"Iskanderi?!" pasthirri Princi.

"Jemi takuar edhe më parë Princ, por sot le të veprojmë sikur ky të jetë takimi ynë i fundit."

"I poshtër, tradhëtar i poshtër," shau sa mundi Mahomedi, "A je ti me të vërtetë? Imagjino se si do ta ngjyeja tehun e skeptrit tim perandorak në gjakun e skllavit tim të arratisur! Jo, erdha këtu të sigurohem për ndëshkimin tënd, por unë nuk mund ta ul veten të bëhem edhe ekzekutori yt. Roje, suluni dhe kapeni! Kapini që të dy!"

Iduna fluturoi drejt Iskanderit, i cili e mori në krahët e tij ndërkohë që e vërtiste shpatën në luftë me të tjerët. Rojet e Mahomedit u derdhën nga pylli i ullinjëve sapo morën urdhër nga Princi.

"Dhe ti Mahomed mendon se me të vërtetë unë u edukova në Sarajet tuaja dhe u mashtrova nga ustallarët Muslimanë?" iu hakërrye Iskanderi. "Unë të ofroj një beteje të vetme nëse dëshiron dhe të ftoj të luftojmë si burrat që beteja të jetë e barabartë."

Ai fishkëlloi dhe menjëherë një trupë hungarezësh të drejtuar prej Huniadit vetë, dolën nga ajo anë e pyllit prej nga Iskanderi kishte bërë me shenjë.

"Hajde pra atherë", tha Mahomedi. Shpatat e tyre vringëlluan, por shoqëruesit kryesor të të birit të Muratit, duke i parë rrethanat e momentit e kuptuan karakterin momental të kësaj aventure krejt rastësore, prandaj e tërhoqën Princin turk menjëherë.

"Atëherë, kjo grindje do të zgjidhet nesër në fushën e Kallishtës," tha Mahomedi.

"Epiri është gati," iu përgjigj Iskanderi.

Turqit u tërhoqën. Iskanderi e dërgoi Idunën e habitur tek babai i saj. Huniadi e mori n'grykë fëmijën e vet të humbur prej kaq kohësh dhe nuk pushonte së përqafuari atë.

Ata i lanë sytë me ujin e freskët të shatërvanit ndërsa ajo u rigjallërua.

"Ku është Nikeas?" pyeti Iskanderi.

"Zotëri fisnik, ju jeni dy herë çlirimtari im," iu përgjigj Iduna, "pasi unë në fakt rashë përsëri në robëri. Më vjen turp ta them, por kësaj here pengmarrësi im u bë Princi i Krishterë."

"Shën Maria"! Shpërtheu Iskanderi. "Kush mund të jetë ky zuzar?"

"Ai zuzar, Lordi Iskander, është miku juaj nga njëra anë dhe nxënësi i babait tim të dashur, yti Lord Huniad!"

"Nikeas i Athinës?" bërtiti Huniadi.

Iskanderi ra në një heshtje të trishtuar.

Të ulur në cepin e shatërvanit, Lady Iduna i tregoi babait të saj dhe Iskanderit krejt çfarë kishte ndodhur me të që kurse ajo dhe Nikeas u ndanë nga Iskanderi. Ajo nuk ia fshehu Huniadit tërë devocionin që Iskanderi kishte treguar për të, dhe sesi ky burrë kaq trim çdo gjë e kishte bërë pa asnje bujë.

Huniadi i madh nuk dintë çfarë të bënte dhe as sesi të vepronte: A të tregonte dashurinë për fëmijën e vet të dashur deri atherë të humbur, apo të shprehte mirënjohjen për Iskanderin? Kështu ata vazhduan të bisedojnë për një farë kohe me Iskanderin që e hodhi xhyben e vet rreth shpatullave të Idunës dhe thuajse pa qëllim e preku në krahun e saj.

Në momentin që ata po bëheshin gati të ktheheshin në kampin e tyre të Krishterë, u dëgjuan zëra njerëzish. Kësaj radhe zhurma vinte po nga ai drejtim nga kishte ardhur Iduna. Që andej doli një grup burrash me pishtar në dorë. Ata kërkonin në çdo pëllëmbë toke nga të gjitha anët duke prishur qetësinë e asaj nate.

Iskanderi dhe Huniadi qëndruan në gjëndje gatishmërie, por shpejt e morën vesh se kishin të bënin me grekë. Drejtuesi i tyre, kur e pa grupin afër shatërvanit, eci përpara që të vazhdonte kërkimin me më shumë kujdes. Por kur i pa dhe i njohu personat që ishin aty, i ra pishtari nga dora, ktheu kokën nga ana tjetër dhe e fshehu fytyrën me duar.

Iduna u mbështet tek babai i saj. Iskanderi mbeti me sytë e ulur për tokë, ndërsa Huniadi i ashpër dhe i tmerrshëm duke e humbur krejt durimin për atë që i kishte ndodhur vajzës, u ngrit, eci drejt të huajit, i vuri dorën mbi sup dhe iu drejtua:

"Djalosh, sikur pendimi të zinte vendin e turpit për atë që ke bërë do të ishte më mirë. Shpesh iu kam paralajmëruar për pasojat fatale që mund të kishte shpërthimi i pa matur e pasionit tënd. Të kam paralajmëruar më shumë se një herë se sado e madhe të ishte zgjuarsia dhe pasuria jote, prapëseprapë do të vinte koha kur karakteri yt i tillë do të të vendoste në një pozicion sa të dëshpëruar aq edhe të turpshëm. Princ i Athinës, ajo orë ka ardhur!"

Ti je përpara tre vetëve të cilët i kë lënduar më shumë në këtë botë dhe para të cilëve duhet të ndjehesh i përulur. Këtu është një mik i cili rrezikoi vetë ekzistencen e tij për mirëqenjën dhe jetën tënde. Ndërsa ju e kthyet atë thjesht në një kodosh për përmbushjen e dëshirave tua dhe më pas e tradhëtove, e le në baltë në momentin më të vështirë të jetës së tij dhe ike. Kjo zonjushe të ka shoqëruar në rininë tënde dhe të ofronte pozicionin më të mirë zyrtar. Ju e keni trajtuar atë një mijë herë më keq sesa pengmarrësit e saj turq."

"Sa më takon mua zotëri, babai juaj ka qenë miku im më i dashur. U përpoqa që t'ja ktheja miqësinë duke ja plotësuar boshllekun me kujdesin që tegova për fëmijën e tij të mbetur jetim. Si e kreva unë detyrën time, nuk e vlen ta përmend. Si e kreve ti tëndën, mund ta dëshmojë kjo zonjushe këtu, bija ime, ish e burgosura jote. Zotëri, ti e provon më mirë se askush tjetër në këtë botë."

"Oh më fal! Më fal, zotëri," iu kthye Princi i Athinës, dhe i ra në gjunjë. "U përçmova keqas. Çdo fjalë jotja më ther drejt e në thelb të zemrës. Është vetë Providenca që i prishi tëra planet e mia dhe unë i qëndroj atij vullneti. Uroj që kjo zonjushe të më falë sado që unë e kam vështirë qoftë edhe ta mendoj, lerë pastaj të shpresoj. Sa ju takon juve, falja juaj është një dhunti hyjnore. Ndoshta kujtimet e ditëve të hershme mund ta shkrijnë zemërimin Tuaj. Sa ju takon juve, zotëri, oh më falni se nuk flas dot

Iskander fisnik, nëse nuk e kam gabim ju mund të pëshpërisni fjalët në atë vesh të mrekullueshëm që bezdiset më pak se nga unë.”

Qofshi të lumtur! Unë nuk dua ta pengoj të ardhmen tuaj me zotimet e mia. Dhe prapë se prapë do ju them: “Lamtumirë!”

Princi i Athinës u largua në një gjëndje tërësisht të trishtuar. Iskanderi e shoqëroi atë.

“Nikeas,” i thirri ai, por Princi u fut ne pyll për të mos u kthyer mbrapsht.

“I dashur Nikeas,” i thirri prapë Iskanderi. Princi hezitoi.

“Le të mos ndahemi kështu,” i tha Iskanderi. “Iduna është shumë e lumtur. Ajo më tha t’ju thoja se ua ka falur të gjitha.”

“Zoti e bekoftë atë dhe Zoti të bekoftë edhe ty!” u përgjigj Nikeas . “Të lutem, më ler të iki.”

“Jo! i dashur Nikeas, a nuk jemi miq më?”

“Më i miri dhe besniku Iskander. Do të vij tek kampi dhe të takoj heret në mëngjes. Tani për tani më ler vetëm.”

“I dashur Nikeas, vetëm edhe një fjalë, të lutem! Ju më keni thënë njëherë e një kohë se ajo që dëshiroj dhe që guxoj të ëndërroj se e dua, nuk arrihet kurrë.

“Këtë e di, miku im i dashur, e di,” u përgjigj Nikeas. “Unë të bie në gjunjë me adhurimin e përunjur. Mos më thuaj asgjë tjetër, asgjë! Ajo ka lindur për tu bërë gruaja e një heroi.”

“Dhe ai hero jeni ju!”

Kapitulli 20
Retrospektivë – Iskanderi pas Betejës së Urës

Pas betejës së Urës, Iskanderi kishte nxituar pa asnjë vonesë për në Krujë. Në udhëtim e sipër ku nuk i kishte vajtur mëndja rreth Idunës dhe Nikeas. Ai e ngushëlloi vetveten duke kujtuar përgjigjet që kishte marrë për atë kurs që kishin marrë mardhënjet midis tyre si dhe me bindjen se ata tani do të ishin të sigurtë. Korrieri nga Kruja që e njoftoi Huniadin për shpëtimin e së bijës solli edhe njoftimin se Epirin do ta ndihmonte Huniadi kundër pushtimit të pashmagshëm të turqve. I shtyrë prej mirënjohjes personale si dhe për shkak të detyrës publike, Huniadi kishte vendosur që në krye të njëzet mijë ushtarëve të vinte vetë në Epir. Kur qenë ndarë, Huniadi dhe Iskanderi e patën lëvduar njëri-tjetrin ndërsjelltas, duke premtuar se në rast se Iduna binte në ndonjë problem, ata, si njëri edhe tjetri do të ndihmonin që ky problem të zgjidhej dhe të shuhej ankthi që mund të kaplonte si njërin ashtu edhe tjetrin.

Udhëheqësit të Epirit i ishte bërë qejfi shumë që miqtë e tij kishin fluturuar menjëherë drejt Transilvanisë dhe vetë Vojvoda ishte i lumtur që njeriu i parë që do ta përqafonte në Krujë do të ishte fëmija i vet i humbur prej kohësh. Prandaj kur u takuan, çuditërisht as njëri as tjetri nuk kishin çfarë t'i thonin njëri tjetrit për atë çështje pasi i kishte kapluar habia dhe ankthi. Ngjarjet iu dhanë atyre shumë pak mundësi për ta pritur qoftë më të mirën apo edhe më të keqen. Ditën kur Huniadi dhe shigjetarët e tij arritën në Krujë, ushtria pushtuese e turqve e komanduar nga Mahomedi i kaloi malet dhe fill pas e vendosën kampin e tyre në fushën pjellore të Kallishtës.

Pasi Iskanderi, me ndihmën e Huniadit, princave fqinjë si dhe forcave patriotike të vendasve të tij u vu në këtë moment në krye të një force të cilës Princi turk nuk do t'i bënte dot ballë, ai zgjodhi të marshonte me njëherë dhe të ndeshej me otomanët dhe të vendoste fatin e vendit të tij në fushëbetejë.

Një natë përpara se Iduna të arrinte tek shatërvani i famshëm, ushtria e krishterë kishte marrë pozicion disa kilometra larg prej shatorreve turke. Luftëtarët me çallma dëshironin ta shtynin përplasjen deri sa të dilte Hëna e re, vigjilja e së cilës nuk ishte larg. Iskanderi po kujtonte kontratën që kishte bërë me Princin turk në bahçenë e Sarajit të Adrianopojës. Ai besonte në karakterin supersticioz të Mahomedit i cili nuk do të humbiste shansin që të ishte në vendin e caktuar, siç kishte ndodhur tashmë që u gjet tek Shatërvani i Kallishtës.

Përpara se të zbardhte agimi, forcat e Krishtera ishin nisur. Iskanderi komandonte në qendër, ndërsa Huniadi në anën e djathtë. Ana e majtë iu besua me kërkesën e tij këmbëngulëse, Princit të Athinës. Një mjegull që ra përmbi fushë e lejoi Nikeas-in të sulmonte krahun e djathtë të turqve thuajse pa u vënë re. Ai u lëshua me furi të papërmbajtshme dhe shpejt i ç'rregulloi rradhët e muslimanëve. Mahomedi me rezervat e tij nxitoi tu vintë në ndihmë. Një forcë shumëpalëshë jeniçerësh, duke bërtitur në kupë të qiellit në emër të Allahut dhe Profetit të tij në tokë, penetruan në qendër të të krishterëve. Huniadi ia doli t'i godiste ata në krah, por për vete u sulmua nga kavaleria turke. Beteja tani i kishte përfshi të gjitha palët dhe zhvillohej me furi të tmerrshme. Iskanderi ishte mbyllur në qendër. Një bateri e re dhe e fuqishme topash, që sapo kishin ardhur nga Vatikani, dhuratë e Papës, villnin zjarr pandërprerë kundër turqve. Kjo bateri u lëshua mbi jeniçerët duke iu shkaktuar dëme të mëdha. Ai vetë i kositi ata me shpatën që askush nuk i bënte dot ballë. Vrasjet ishin të panumërta, të tmerrshme dhe të zhurmshme! Por prej tërë kalorësve të krishterë të asaj dite, askush nuk luftoi me aq forcë sesa Princi i Athinës. Me një dëshpërim të shprehur në betejë, ai ulurinte nëpër

fushë dhe gjithçka dukej sikur zhvillohej nën impulsin e tij frymëzues. Shembulli i tij i trimëroi luftëtarët epirotë deri në atë shkallë saqë divizioni kundër të cilit ai luftonte, megjithëse i inkurajuar nga prania e vetë Mahomedit nuk mundi t'i qëndronte guximit rrënues të të Krishterëve. Dhe ja ku erdhi një moment që ata ia mbathën në drejtime të ndryshme.

Atëherë në përpjekje për t'i ardhur në ndihmë Iskanderit, Nikeas-i, në krye të një grupi burrash të zgjedhur, shpërtheu në prapavijën e jeniçerëve dhe gati sa nuk i dërmoi të gjithë. Huniadi menjëherë bëri një sulm të ri nga ana e majtë e turqve. Paniku i kapi muslimanët të cilët dukej se nuk ishin të përgatitur mirë për këtë lloj demonstrimi të forcës nga ana e armikut të tyre. Në pak minuta, dukej se ata u ç'organizuan fare dhe komandantët e tyre më kot përpiqeshin t'i mblidhin ushtarët e tyre për t'i futur përsëri në betejë. Iskanderi vringëlloi shpatën e përgjakur rrethuar me kordon të zi dhe iu bëri thirrje luftëtarëve të shpallnin triumfin e Kryqit dhe çlirimin e Epirit. Tani duhej vetëm t'i zhduknin turqit deri tek ushtari i fundit.

Kapitulli 21
Rënia e dëshpëruar e Nikeas në fushën e betejës.

Me mijëra turq u masakruan atë ditë. Mahomedi kur e pa se kishte humbur gjithçka, ia mbathi me të katra nëpër male me një grup rojesh dhe eunukësh duke e lënë pas një pasha që të kujdesej për mbeturinat e ushtrisë së tij të shpartalluar. Kodrat ishin mbushur me turq që iknin dhe epirotë që i ndiqnin. Disa ikën drejt bregdetit atje ku duhej të ankorohej flota turke. Fusha ishte shtruar me trupa të vdekur dhe me armë pa zot, me çadra dhe flamuj. Dielli ishte ngjitur në majë të qiellit. Mjegulla ishte larguar ndonëse disa re tymi ende bënin hije mbi ta.

Një kalorës i krishterë, i veçuar nga skena makabër e betejes, kalëroi nëpër një shteg gjarpërues drejt kodrave të gjelbërta. Hapi i ngadalshëm dhe i drithëruar i gjogut të tij të lodhur nuk të jepte përshtypjen se ai ishte një prej fitimtarëve të asaj beteje. Ai dukej fizikisht i drobitur. Kalorësi ishte i zhytur në gjak por jo vetëm me atë të armikut me të cilin kishte luftuar. Ai kishte marrë plagë të rënda dhe me vështirësi po mbahej pa i rënë të fikët.

Kalorësi kaloi në rrugën me kthesa dhe ashtu siç ishte në vetmi, në vend që të kthehej tek çadra e ngritur për ndihmë mjekësore e drejtoi kalin tek një luginë e vogël e gjelbërt, e mbuluar me barishte plot erëza dhe tërësisht e rrethuar prej degësh të varura të drunjëve. Në qendër ngriheshin rrënojat e tempujve dorikë. Aty gjëndeshin tre katër kolona madhështore, ngjyrë gri. Tani gjithçka kishte rënë në heshtjen e mortjes. Vetëm fluturimi i një shqiponje që rrotullohej rreth e rreth tempullit e prishte atë qetësi vdekje.

Kalorësi arriti tek rrënojat e tempullit dorik dhe me vështirësi zbriti nga kali i tij, ra mbi një lëndinë të mbushur me lule dhe për disa çaste ndejti pa lëvizur fare. Kali i tij qëndronte disa metra larg tij dhe, edhe pse edhe ai ishte i plagosur, ndonëse më pak, filloi menjëherë të kulloste. Më në fund kalorësi i krishterë ngriti kokën ngadalë dhe duke u mbështetur në krahun e tij shmoi thellë. Fytyra e tij ishte e zbehtë tej mase, por sapo pa përpjetë dhe e shquajti shqiponjën në qiell, një qeshje i përshkroi krejt fytyrën dhe sytë e tij të bukur shkëlqyen me një dritë vezulluese.

"Shpend i lavdishëm!" përshpëriti luftëtari i krishterë, "njëherë e një kohë mendoja se karriera ime do t'i ngjante tëndes! Tani mbaroi edhe Greqia, për të cilën unë do të kisha bërë aq shumë. Shpejt do të harrohet edhe emri im i lashtë. Zgjodha të vdes këtu, në mes të heshtjes dhe bukurisë. Ky qiell i kaltër, këto pemë të gjelbërta dhe kollona të vetmuara të cilat shpeshherë kanë qenë ngushëllimi im, ku i gëzohesha leximit të poezive më të bukura, tani janë vendi ku unë zgjodha të mbyll sytë përgjithmonë.

Këto ishin fjalët e fundit të Princit të Athinës.

Kapitulli 22
Triumfi i Iskanderit dhe Huniadit dhe festa në Kalanë e Krujës.

Ndërsa i dashuruari fatkeq pas vajzës së Huniadit po jepte frymën e fundit, i vetmuar, miku i tij më fatlum festoi në qendër të skenës së triumfit dhe mori përgëzimet e lavdisë për çlirimin e vendit të tij. Tani turqit ishin mposhtur dhe ky triumf mbi ta i bashkohej edhe një fitorje tjetër ndaj tyre në Bullgari. Këto u bënë frymëzimi për të mbrojur Krishtërimin nga tëra sulmet që u ndërmorën gjatë sundimit të Sulltan Muratit të Dytë.

I rrethuar prej aleatëve princërorë dhe prijësve të Epirit, flamurëve fitimtarë të Krishtërimit dhe trofeve të marra prej muslimanëve, Iskanderit iu ofrua edhe dora e vjazës së Huniadit të Madh nga vetë ai.

"Fale këtyre luftëtarëve guximtarë," tha heroi. "Unë mund t'i ofroj vajzës tuaj një shtëpi të sigurtë dhe të nderuar kristiane."

"Je ti zotëri i lartë arësyeja përse Epiri e fitoi lirinë," tha një prijës i vjetër, duke iu drejtuar Iskanderit. "Është ndjenja e ekzistencës tënde kombëtare dhe përkatësia jote e shenjtë fetare që e solli këtë ditë. Krejt çfarë na duhet të bëjmë tani, është t'i ruajmë këto vlera. Në të vërtetë nuk shoh mënyrë tjetër për t'i ruajtur ato dhe këtë vend të bekuar veçse duke ju rivendour ju në fronin e stërgjyshërve tuaj. Prandaj unë brohoras:

Zot, ruaje Iskanderin, Mbretin e Epirit!"
Dhe të gjithë njerëzit brohoritën me një zë:
"Zot, ruaje Mbretin tonë!
Zot, ruaje Iskanderin, Mbretin e Epirit!"

FUND

Mal Berisha është një njeri i kulturës, studiues dhe diplomat i cili ka botuar shkrime, libra dhe përkthime rreth perceptimit të të huajve ndaj popullit shqiptar. Ndër to spikatin librat "*Shqiptarët, Lisa mbi Truallin Ilir"* një studim i plotë rreth shkrimeve të revistës më prestigjioze amerikane *"The National Georgraphic Magazine"*, "*Shqiptarët, europianët më të lashtë dhe më të rinj"*, "*Charles Telford Erickson – Amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë"*, "*Realitete shqiptaro britanike"*, *"Herman Bernstein, Ambasadori Amerikan në Mbretërinë Shqiptare, 1930-1933"* në gjuhën angleze dhe shqipe. Libri që po paraqesim, *"Naltësimi i Iskanderit,"* kushtuar heroit tonë kombëtar, Skënderbeu është punuar në vijim të përpjekjeve të tij për ndriçimin e shkrimeve për kombin tonë. Si diplomat ai ka zhvilluar teorinë e *Soft Power* në dobi të njohjes së vlerave të kombit shqiptar nëpër botë dhe ka ligjëruar në universitete e forume të rëndësishme perëndimore si në Kennedy School of Government, Cambridge Massachusetts, London School of Economics, Institutin e Kërkimeve Hebraike YIVO dhe Federatën Pan – Shqiptare VATRA, në New York, në Geneva School of Diplomacy në Zvicër, në Ambasadën Amerikane në Londër dhe atë Britanike në Tiranë si dhe në Akademinë Diplomatike në Prishtinë. Ai ka shërbyer si Konsull i Përgjithshëm i Shqipërisë në Stamboll (1992-1997) dhe Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandë (2012-2015) dhe mban titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.
Malberisha.com